3. Statutet e shoqerive "SIGAL" sh.a. dhe "SIGAL LIFE" sh.a. nuk parashikojne qe te jepet pelqimi i shoqerise per transferim pronesie mbi aksionet kur transferim kryhet ndermjet dy aksionereve aktual te shoqerise. Pavaresisht ketij fakti kjo shitje, per sa i perket aksionerit AAEF gezon pelqimin me shkrim konform mardhenieve kontraktore midis aksionereve te shoqerive objekt i kesaj Kontrate.
4. Per cdo gje jo te parashikuar shprehimisht ne kete Kontrate do te zbatohen dispozitat ligjore te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Kjo Kontrate u perpilua nga une noteri ne 4(kater) origjinale me te njejten vlere, dhe pasi lexohet nga palet e gjendet konform vullnetit tyre te lire e te plote nenshkruhet rregullisht.

SHITESI | **BLERESI**

SHYQYRI DURAKU | **NOTER** Robert KOLI | **AVNI PONARI**

Shyqyri Duraku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QENDRA E REGJISTRIMIT TE AKSIONEVE SH.A.
TIRANE

EKSTRAKTI I REGJISTRIT TE AKSIONEVE

SH.A. SIGAL - TIRANE

Gjëndja më datë **10.27.2006**

Kapitali themeltar ..... **400,000,000 leke**

Vlera nominale / aksion ..... **3,300 Leke**

Totali i Aksioneve **121,212**

Numri i Aksionerëve **5**

Numri i Aksioneve të mbetura ..**0**

Për QRA

Adresa: Rr. "Puntorët e Rilindjes" Nr.13
Kutia Postare: 7424 - Tiranë
Tel: ++355 / 4 / 233425
Fax / Modem: ++355 / 4 / 233442

Vendimi i Gjykatës: Nr.14253 Dt. 21/03/96
Kodi Fiskal: K314 22103G
Nr. Llogarisë: 0200 355
BKT Dega Nr.2 Tiranë

Numri i Aksionerëve 5

Numri i faqeve: 2

SIGAL - TIRANE

NR.	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	LINDUR ME	VENDLINDJA	AKSIONE	%	ADRESA	QYTETI	RRETHI
1	AVNI	REXHEP	PONARI	07.28.1957	TROPOJE	35,200	29.040%	Rruga "Irfan Tomini", Pallati C - 4/7	TIRANE	TR
2	EDVIN	SKENDER	HOXHAJ	04.30.1966	LUSHNJE	7,467	6.160%	Rruga"Dervish Hima", P 112, Shk 2	TIRANE	TR
3	FONDI SHQIP.	AMERIKAN	NDERMAR.	03.17.2006	TIRANE	14,545	12.000%	Green Tower Complex, Kulla 2, Kati 11	TIRANE	TR
4	LLAZAR	SOTIR	ANGJELI	02.05.1940	TIRANE	32,000	26.400%	Rruga e Durresit, Pallati 124/2 - 15	TIRANE	TR
5	SHYQYRI	ALUSH	DURAKU	12.08.1954	KUKES	32,000	26.400%	Rruga e Kavajes Nr. 58	TIRANE	TR
					TOTALI =	121,212	100.000%			

REPUBLIKA E SHQIPERISE
QENDRA E REGJISTRIMIT TE AKSIONEVE SH.A.
TIRANE

EKSTRAKTI I REGJISTRIT TE AKSIONEVE

SH.A. SIGAL LIFE - TIRANE

Gjëndja më datë **10.27.2006**

Kapitali themeltar ..... **125,000,000 Leke**

Vlera nominale / aksion ..... **1,000 Leke**

Totali i Aksioneve **125,000**

Numri i Aksionerëve **5**

Numri i Aksioneve të mbetura ..**0**

Për QRA

Adresa: Rr. "Puntorët e Rilindjes" Nr.13
Kutia Postare: 7424 - Tiranë
Tel: ++355 / 4 / 233425
Fax / Modem: ++355 / 4 / 233442

Vendimi i Gjykatës: Nr.14253 Dt. 21/03/96
Kodi Fiskal: K314 22103G
Nr. Llogarisë: 0200 355
BKT Dega Nr.2 Tiranë

SIGAL LIFE - TIRANE

Numri i Aksionerëve 5

Numri i faqeve: 2

NR.	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	LINDUR ME	VENDLINDJA	AKSIONE	%	ADRESA	QYTETI	RRETHI
1	ALNI	REXHEP	PONARI	07.28.1957	TROPOJE	36,300	29.040%	Rruga "Nikolla Tupe", P 13	TIRANE	TR
2	EDVIN	SKENDER	HOXHAJ	04.30.1966	LUSHNJE	7,700	6.160%	Rr. "Dervish Hima", P.114, Shk 2	TIRANE	TR
3	FONDI SHQIP.	AMERIKAN	NDERMAR.	03.17.2006	TIRANE	15,000	12.000%	Green Park Complex, Kulla 2, Kati 12	TIRANE	TR
4	LLAZAR	SOTIR	ANGJELI	02.05.1940	TIRANE	33,000	26.400%	Rruga e Durresit, P. 124/2-15	TIRANE	TR
5	SHYQYRI	ALUSH	DURAKU	12.08.1954	KUKES	33,000	26.400%	Rruga e Kavajes Nr.58	TIRANE	TR
					TOTALI =	125,000	100.000%			

REPUBLIKA E SHQUPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 20863/12 **Vendimit**

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 27.10. 2006, Une, _____ gjyqetare prane Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga kerkuesi **Avni PONARI**, per nje ndryshim ne kapitalin e shoqerise "SIGAL" sh.a.

KONSTATOVA

Me vendimin Nr. 20863 date 22.02.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte rregjistruar si person jiridik shoqeria anonime "SIGAL" sh.a. me seli ne
Bul. Zog I, Nr. 1 Tirane.
Shoqeria SIGAL sh.a. gjate ushtrimit te aktivitetit qe nga momenti i krijimit ka zmadhuar kapitalin e saj per shkak te zgjerimit te aktivitetit. Ne vijim te ecurise se metejshme te veprimtarise Asmableja e Jashtezakonshme e shoqerise "SIGAL" sh.a. ka vendosur per zmadhimin e kapitalit te shoqerise. Bazuar ne Vendimin nr.1 date 27.04.2006 te Asmablese se Jashtezakonshme te Shoqerise, Raportin e Drejtorise se shoqerise SIGAL sh.a., eshte vendosur:

- Zmadhimi i kapitalit te shoqerise qe sjell ndryshimet ne **Nenin 6 te Statutit** te shoqerise, i cili pas ndryshimeve eshte si me poshte:

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 400.000.000leke.
Ai eshte i ndare ne 121.212(njeqind e njezete e nje mije e dyqind e dymbedhjete) aksione nominative. Vlera e nje aksioni eshte 3.300Leke.
Perberja e kapitalit themeltar te shoqerise eshte si vijon:

1. **Shyqyri Duraku zoteron 32.000 aksione, me vlere 105.600.000leke ose 26.40% te kapitalit.**
2. **Llazar Angjeli zoteron 32.000 aksione, me vlere 105.600.000leke ose 26.40% te kapitalit.**
3. **Avni Ponari zoteron 35.200 aksione, me vlere 116.160.000leke ose 29.04% te kapitalit.**
4. **Edvin Hoxhaj zoteron 7.467 aksione, me vlere 24.640.000leke ose 6.16% te kapitalit.**
5. **Fondi Shqiptaro –Amerikan i Ndermarrjeve zoteron 14.545 aksione, me vlere 48.000.000leke ose 12.00% te kapitalit.**

- Depozitimin e dokumentacionit te nevojshem prane Rregjistrit Tregtar te Gjyaktes se Rrethit Gjyqesor Tirane per te bere ndryshimet e nevojshme ne Rregjistrin perkates.
Kerkesa eshte e drejte, e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqeri Tregtare" dhe ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin Tregtar"

VENDOSA

Pranimin e Kerkeses.
Depozitimin ne rregjistrin tregtar te Vendimit nr.1 date 27.04.2006 te Asmablese se Jashtezakonshme te Shoqerise dhe Raportit te Drejtorise se shoqerise SIGAL sh.a. per zmadhimin e kapitalit.
Shenimin ne fleten perkatese ne kolonen
Rregjistrimet te behen me Nr. ____ rendor, duke u ndare nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

PULLE TA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 3748 REP

STUDIO NOTERIALE
MALLKUCI & SADUSHAJ

VERTETIM

Sot ne daten 08/6/2007 perpara meje Noteres M. Sadushaj noteri prane Dhomes Noterise Tirane me adrese Rr. "Vaso Pasha", P.13/1, u paraqit personalisht;

ENIEL KOLANECI, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur personalisht prej meje, i cili me paraqiti origjinalin e
Kontratës së shitjes me Ankesë nr 17816 Rep dhe 3591 Kod bashkëngjitur me Vend njoftim. Lëneës nr 20863/12 dhe Ekstrakti i Regj. te Ankesës.
dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me origjinalin e paraqitur prej tij

NOTERE
M. Sadushaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTER
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
VENDIM NR. 20863/13

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

- Per depozitim aktesh te personit juridik, shoqeri tregtare -

Sot, me date 25/06/2007, une Teuta Hoxha, Gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentet provuese te paraqitura nga Z. Avni Ponari, aksioner i Shoqerise "SIGURACIONI SHQIPTAR" SH.A. (SIGAL), me objekt depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te Kontrates se Shitjes se Aksioneve, date 27.10.2006, lidhur midis Z. Shyqyri Duraku (Shites) dhe Z. Avni Ponari (Bleres), me objekt shit - blerjen e 19.878 (nentembedhjetemije e teteqindeshtatedhjeteetete) aksioneve te shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A. (SIGAL), si dhe ndryshimin ne efekt te transferimit te mesiperm te Nenit 6 te Statutit te Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A., nga te cilat

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "SIGURACIONI SHQIPTAR" SH.A. (SIGAL) eshte nje shoqeri anonime, rregjistruar me Vendimin No.20863, date 22.02.1999 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Z. Shyqyri Duraku (zoteron 32.000 aksione) dhe Z. Avni Ponari (zoteron 35.200 aksione) jane aksionere te Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A. Po ashtu, Z. Shyqyri Duraku, zoterues i 32.000 (tridhjeteedymije) aksioneve ne kete Shoqeri i ka shitur Z. Avni Ponari, 19.878 (nentembedhjetemije e teteqindeshtatedhjeteetete) aksione, nepermjet Kontrates Noteriale, date 27.10.2006, veprim ky i konfirmuar edhe nga Aksioneri Fondi Shqiptar Amerikan i Ndermarrjeve (AAEF) ne baze te Marreveshjes se Investimit, lidhur midis SIGAL, aksionereve te tij dhe AAEF.

Persa me siper, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, ne baze te kompetencave ligjore (Ligjit No.9572, "Per Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare" date 03.07.2006, Neni 14, pika 23, si dhe Ligjit No.9267, "Per veprimtarine e sigurimit, te ri-sigurimit dhe ndermjetesimit ne sigurime dhe ri-sigurime", Neneve 56 dhe 57) ka miratuar me Vendimin e tij No.2 date 10.05.2007 ndryshimin e pjesemarrjes se Z. Avni Ponari ne Shoqerine SIGURACIONI SHQIPTAR SIGAL SH.A. nga 29% ne 45%, duke e kushtezuar kete pjesemarrje ne kete raport edhe per Shoqerine SIGAL HOLDING SH.A.

Nga ana e Z. Avni Ponari eshte bere likujdimi financiar provuar kjo me dokumentat e pagesave te leshuara nga Banka Amerikane e Shqiperise (ABA)

Ne lidhje me veprimet e mesiperme dhe pasqyrimin e tyre ne Statutin e Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A. (SIGAL), Nenin 6 te tij, ky Nen duhet te ndryshohet ne lidhje me perfaqesimin e aksionereve dhe konkretisht Z. Shyqyri Duraku do te zoteroje 12.122 (dymbedhjetemije e

njeqindenjezetedy) aksione, ndersa Z. Avni Ponari 55.078 (pesedhjeteepesemije e shtatedhjeteetete) aksione.

Meqenese te gjitha keto veprime jane te provuara me dokumentacionin bashkengjitur.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te Kontrates se Shitjes se Aksioneve, date 27.10.2006, lidhur midis Z. Shyqyri Duraku (Shites) dhe Z. Avni Ponari (Bleres), me objekt shit - blerjen e 19.878 (nentembedhjetemije e teteqindeshtatedhjeteetete) aksioneve te shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A. (SIGAL).

Ndryshimin e Nenit 6 te Statutit te Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A. ne lidhje me perfaqesimin e aksionereve dhe konkretisht:

- Z. Shyqyri Duraku do te zoteroje 12.122 (dymbedhjetemije e njeqindenjezetedy) aksione;
- Z. Avni Ponari do te zoteroje 55.078 (pesedhjeteepesemije e shtatedhjeteetete) aksione.

Pranimin e dokumentacionit bashkengjitur.

Zyra e Rregjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkatese.

GJYQTARE

Teuta Hoxha

RAPORT
I DREJTORISE SE SHOQERISE SE SIGURIMEVE "SIGAL" sh.a.

"Mbi zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise"

SIGAL

Ne zbatim te pikes 4 te Vendimit nr. 1 date 27.04.2006 te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise SIGAL sh.a., sipas te cilit eshte vendosur rritja e kapitalit themeltar te shoqerise me perfshirje te fitimit ne masen prej 61 330 900 leke, ne mebeshtetje te Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" une Drejtor i Pergjithshem, hartoj kete raport per realizimin dhe dokumentimin e zmadhimit te kapitalit.

Ne permbushje te detyrave te deleguara paraqes si vijon:

1. Zmadhimi i kapitalit do te behet nepermjet emetimit te aksioneve te reja.
2. Sipas bilancit të datës 31.12.2005 të ekspertuar dhe nga eksperti kontabël i autorizuar rezulton:

- Fitimi i mbartur nga viti 2004 është	2.121	lekë
- Fitimi i vitit 2005 është	100.743.549	lekë
- Shuma	100.745.670	lekë
- Shpërndarë aksionerëve si dividend	39.414.770	lekë
- Fitimi që mbetet për zmadhim kapitali	**61.330.900**	**lekë**

3. Nga perfshirja e fitimit prej **61 330 900 leke** ne baze te bilancit te dates 31.12.2005 per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise, kapitali themeltar i shoqerise **nga 338 669 100 Leke do te behet 400 000 000 Leke**.
4. Duke marre parasysh zmadhimin e kapitalit themeltar shperndarja e aksioneve dhe kapitaleve sipas aksionereve paraqitet si meposhte:

Aksionerët	Numri i aksioneve		Kapitali në lekë		Përqindja në kapital
	Ishte	Bëhet	Ishte	Bëhet	
Shyqyri Duraku	27.904	32.000	89.408.642	105.600.000	26.40 %
Llazar Angjeli	27.094	32.000	89.408.642	105.600.000	26.40 %
Avni Ponari	29.803	35.200	98.349.507	116.160.000	29.04 %
Edvin Hoxhaj	6.322	7.467	20.862.017	24.640.000	6.16 %
Fondi Shqiptaro Amerikan	12.305	14.545	40.640.292	48.000.000	12 %
Totali	**102.627**	**121.212**	**338,669,100**	**400.000.000**	**100 %**

Adresa: Bul. "Zog I", Nr.1, Tiranë, Kutia Postare 2387, Tel: 04 253407 / 04 253408; Tel.Fax: 04 250220 / 04 233308 , E-mail: info@sigal.com.al.

Sa siper justifikohet nepermjet bilancit të datës 31.12.2005 të ekspertuar nga eksperti kontabël i autorizuar Prof. Jorgji Bollana.

Shoqeria SIGAL duhet te kerkoje depozitimin e ndryshimeve te mesiperme qe reflektojne ne ndryshime te Nenit 6 – (Kapitali Themeltar) te Statutit te shoqerise prane Seksionit te Rregjistrit Tregtar Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

Tirane, me 01/06/2006

Avni PONARI

Drejtor i Pergjithshem

SIGAL

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter: Robert KOLI
Studio: Rr. "Urani Pano", Pallati 11/Katesh
Nr. 8875 Rep.

VERTETIM NOTERIAL

Sot, me daten 05.06.2006 (dymije e gjashte), diten e Hene, para meje Robert KOLI, noter ne qytetin e Tiranes, me Seli si me siper, u paraqiten personalisht:

Shoqeria "***SIGAL***" sh.a, Bulevardi "Zogu i Pare", Tirane, Nr. 1, regjistruar si person juridik me vendimin e gjykates Nr. 20863 date 22.02.1999, Kod Fiskal 3708093, perfaqesuar nga Drejtor i Pergjithshem, ***Z. Avni PONARI***, i biri Rexhepit, lindur me 28.07.1957 ne Tropoje dhe banues ne Tirane, Rr. "Nikolla Tupe", Pallati 11-katesh, identifikuar nga Pasaporta me Nr. 1996645, i cili me deklaroi se ***Raportin*** e bashkangjitur e ka hartuar dhe nenshxkruar me vullnet te lire para meje.
Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER
Robert KOLI

SHOQËRIA "SIGAL SH.A."
TIRANË

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TE AUTORIZUAR PËR PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2005

TIRANË MARS 2006

I. RAPORT I PËRGJITHSHËM I EKSPERTIT KONTABËL Të AUTORIZUAR PËR VITIN 2005

DREJTUAR: ASAMBLESË SË AKSIONERËVE Të SHOQËRISË SIGAL sh.a.

Në plotësimin e misionit që më është besuar, kam kryer auditimin e pasqyrave financiare vjetore, Bilanci Kontabël dhe Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, për periudhën ushtrimore që mbyllet me 31.12.2005 të shoqërisë "SIGAL" sh.a. Shipëri, Tiranë. Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare është përgjegjësi e drejtimit të shoqërisë. Përgjegjësia ime është që, bazuar në auditimin e kryer, të shpreh një opinion mbi këto pasqyra. Qëllimi i auditimit është dhënia e një opinioni mbi vërtetësinë dhe paraqitjen besnike e të sinqertë të pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë "SIGAL" sh.a. Tiranë, të kontrolloj që ato nuk përmbajnë gabime të rëndësishme (materiale) dhe hartimi në përfundim të këtij auditimi të raportit përkatës.

Unë kreva auditimin në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që të planifikohet dhe të kryhet auditimi për të marrë sigurinë e arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Gjatë realizimit të misionit kam bërë vlerësimin e sistemit kontabël që është përdorur për shoqërinë "SIGAL" sh.a. Tiranë, kam vlerësuar sistemin dhe procedurat e kontrollit të brendshëm, si edhe kam verifikuar me zgjedhje dokumentacionin kontabël të paraqitur nga drejtimi i shoqërisë.

Pas kryerjes së auditimit të pasqyrave financiare të paraqitura nga drejtimi i shoqërisë "SIGAL" sh.a. Tiranë, unë jap opinionin se duke marrë parasysh vërejtjet e shprehura në shënimet që i bashkëngjiten këtij raporti, këto pasqyra që i aneksohen këtij raporti, japin një pamje të vërtetë e të sinqertë të gjendjes financiare të shoqërisë në datën 31.12.2005, dhe rezultatet nga veprimtaria e ushtrimit, dhe në këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Planin Kontabël të Përgjithshëm.

Eksperti Kontabël i Autorizuar

Prof. Dr. Jorgji BOLLANO

II Të PËRGJITHSHME

Shoqëria "SIGAL" sh.a. Tiranë është shoqëri anonime dhe është krijuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr.20863, datë 22.02.1999. Aktivitetet e biznesit kryesor të saj përfshijnë dhënien e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorike pasuri, makina dhe tipe të tjera sigurimi. Në përputhje me ligjin Nr.9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit".
Zyrat qëndrore janë vendosur në Tiranë, Bulevardi "Zogu I".
Kapitali Themeltar i shoqërisë është 338.669.100 lekë. Shoqëria drejtohet nga Këshilli Mbikqyrës me kryetar z. Shyqyri Duraku dhe administrohet nga Drejtori i Përgjithshëm z. Avni Ponari.
Më dt.31.12.2005 struktura e aksionerëve është si më poshtë:

	ne	%
Avni Ponari		29.04
Shyqyri Duraku		26.40
Llazar Angjeli		26.40
Fondi Shqiptaro Amerikan		12.00
Edvin Hoxhaj		6.16

SIGAL sha

III BILANCI

AKTIVI	**v 2005**	**v 2004**	**ndryshim**
Aktive te Qendrueshme te patrup.	19,701,958	19,701,958	0
Amortizimi i AQ te patrupezuara	-6,154,836	-4,184,640	-1,970,196
Aktive te Qendrueshme te Trupezuara	536,369,863	448,657,235	87,712,628
Amortizimi i A.Q. te Trupezuara	-85,652,959	-71,441,689	-14,211,270
Aktive Financiare	234,833,300	126,350,000	108,483,300
Gjendjet e Inventarit	3,322,141	1,403,463	1,918,678
Kerkesa per arketim mbi debitoret	158,478,047	196,631,195	-38,153,148
Likujditete dhe vlera te tjera	748,356,799	609,310,261	139,046,538
Diferenca konvert. Aktive	796,565		796,565
TOTALI i Aktivit	**1,610,050,878**	**1,326,427,783**	**283,623,095**
			0
			0
PASIVI			0
Kapitali i neneshkuar	338,669,100	274,645,005	64,024,095
Fitimi i mbartur	2,121	4,762,946	-4,760,825
Fitimi i ushtrimit	100,743,549	111,263,673	-10,520,124
Provizione (Rezerva)	998,941,990	859,281,056	139,660,934
Detyrime	171,384,939	71,233,296	100,151,643
Diferenca konvertimi pasivi	309,179	524,807	-215,628
Totali i Pasivit	**1,610,050,878**	**1,326,427,783**	**283,623,095**

PËRMBAJTJA

I. Raport i Ekspertit Kontabël të Autorizuar

II. Hyrje

III. Bilanci i shoqërisë 21.12.2005, 31.12.1004

IV. Pasqyra e shpenzimeve dhe të ardhurave

V. Mbi kontabilitetin

VI. Sqarime e shënime për pasqyrat financiare

SIGAL sh.a.

IV PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

ne leke

	v.2005	v.2004	Ndryshime
TE ARDHURAT			
Nga kryerja e sherbimeve	1,125,456,323	1,250,337,349	-124,881,026
Te ardhura te tjera	5,039,133	2,513,395	2,525,738
Interesa te fituara	13,165,448	4,673,019	8,492,429
Diferenca pozitive nga kembimi	55,936,234		55,936,234
Te tjera te ardhura financiare	8,319,646		8,319,646
Totali i te ardhurave	**1,207,916,784**	**1,257,523,763**	**-49,606,979**
SHPENZIME			
Furnitura e sherbime	780,294,536	799,446,640	-19,152,104
Shpenzime per personelin	76,436,394	82,424,738	-5,988,344
Tatime e taksa	3,065,261	938,090	2,127,171
Shpenzime te tjera	30,129,338	15,113,123	15,016,215
Amortizimi	29,049,134	22,030,089	7,019,045
Provizione (Rezerva)	139,660,934	104,082,027	35,578,907
Interesa te paguara	4,847,256	957,068	3,890,188
Diferenca negative nga kembimi	7,597,873	80,399,237	-72,801,364
Totali i shpenzimeve	**1,071,080,726**	**1,105,391,012**	**-34,310,286**

V. MBI KONTABILITETIN

Të përgjithshme

1. Kontabiliteti mbahet në përputhje me Planin Kontabël të Përgjithshëm, ligjin "Mbi Kontabilitetin" dhe udhëzimeve përkatëse lidhur me veçoritë që kanë shoqëritë e sigurimeve. Pasqyra financiare janë përpiluar në bazë të kostos historike, të parimeve të Planit Kontabël të Përgjithshëm dhe ligjit "Mbi kontabilitetin".
2. Monedha raportuese është monedha kombëtare LEK-u.
3. Hartimi i pasqyrave financiare nuk merr parasysh efektin e inflacionit, pasi ekonomia e Shqipërisë nuk ka karakteristika hiperinflacioniste sipas Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.
4. Parimi bazë i përcaktimit të madhësisë së të ardhurave është parimi i konstatimit i kombinuar me atë të realizimit faktik të të ardhurave.
5. Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara janë të vlerësuara me koston historike dhe në bilanc janë paqyruar me vleftën e mbetur (minus amortizimin e llogaritur).
6. Amortizimi është llogaritur brenda normave të miratuara nga ligji për Tatimin mbi të Ardhurat sipas tarifave të mëposhtme:

Ndërtesa 5%
Pajisje informatike 25%
Makineri e pajisje 20%
Të tjera 20%

7. Inventaret janë vlerësuar me çmimin e blerjes.
8. Shoqëria paguan tatimin mbi fitimin për aktivitetin që ushtron sipas legjislacionit fiskal në fuqi.
9. Shoqëria gjatë vitit nuk ka ndryshuar metodat e vlerësimit të aktiveve dhe pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve duke ruajtur parimin e vijimësisë.
10. Provizionet (Rezervat) për vitin 2005 janë kontabilizuar dhe pasqyruar në pasqyrat financiare si në vitin 2004 për shumën e ndryshimit nga viti i kaluar.
Për vitin 2005 kontabiliteti është mbajtur në mënyrë të informatizuar, çka ka sjellë një azhornim më të shpejtë të tij duke siguruar një informacion jo vetëm në kohë por edhe më të plotë për një menaxhim më të suksesshëm të fondeve.

VI. SHPJEGIME TW PASQYRAVE FINANCIARE TW SHOQËRISË PËR VITIN 2005

AKTIVI

Kontrolli i aktivit pati si qëllim marrjen e informacionit në lidhje me ekzistencën, saktësinë, plotësinë, pronësinë si dhe me paraqitjen e aktiveve në mënyrë të përshtatshme në bilanc. Nga kontrollet me zgjedhje të përdorura rezultoi se në aktivet e qëndrueshme të bilancit të shoqërisë për vitin që mbyllet më 31.12.2005 janë pasqyruar hyrjet në shoqëri sipas vlerës së tyre të marrjes, paraqitja dhe klasifikimi i tyre në elemente të veçantë bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Plani Kontabël i Përgjithshëm dhe ligji "Për Kontabilitetin".

a) Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara

	VITI 2005
Gjendja 01.01.05	19701957
Shtesa gjatë vitit	-
Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara me koston historike 31.12.05	19701957
Zbritet amortizimi	6154836
Aktive të Qëndrueshme të Patrupëzuara me vleftën neto 31.12.05	13547121

b Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara

	Viti 2005
Gjendja 01.01.05	448607234
Shtesa gjatë vitit	105303741
Pakësime gjatë vitit	-17591114
Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara me koston historike	536369861
Zbritet amortizimi	- 85652959
Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara me vleftën neto 31.12.05	450716902

Në grupin "Ndërtesa ka pasë shtesa 79.888.882 lekë dhe konkretisht.
- Pjesa prej 63.800.000 lekë e lënë vitin e kaluar si kërkesë debitore për "VEVE" e paguar por e pa hipotekuar, këtë vit është hipotekuar dhe ka kaluar në Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara në grupin ndërtesa.
- Parkingu i blerë nga Euro-oil për 3.033.600 lekë
- Rikonstruksion ndërtese në Elbasan 2.116.400 lekë
- Rikonstruksion ndërtese në Tiranë 1.500.000 lekë
- Rikonstruksion në Zyrat Qendrore 6.220.000 lekë
- Rikonstruksion në Zyrat Fier 1.666.882
- Rikonstruksion ndërtesa Tiranë 1.552.000

Po në grupin "Ndërtesa" ka pas pakësime 4.050.040 lekë për shitjen e një zyre.
Lëvizjet e mësipërme janë të dokumentuara dhe të pasqyruara drejt në kontabilitet.

Në grupin "Mjete Transporti" janë pasqyruar lëvizjet për blerjen e 6 autoveturave për 10.631580 lekë dhe riparim të madh të një automjeti për 311.280 lekë dhe janë bërë dalje 4 automjete në vleftë fillestare 4.080.000 lekë prej të cilëve një është shitur dhe 3 janë nxjerrë jashtëpërdorimit.
Në grupin "Pajisje zyre e informatike, janë pasqyruar lëvizja për blerje 14.471.999 lekë dhe dalje (nxjerrje jashtë përdorimit) 9461074 lekë.
Evidenca e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara mbahet si sintetike dhe analitike dhe ka rarodrim midis tyre
Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe të llogaritura brenda normave fiskale të përcaktuara në ligjin Nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".
Aktive Financiare
Në këtë rubrikë të bilancit pasqyrohet investimet e bëra nga shoëria SIGAL në Shqipëri, në filialin e saj në Maqedoni 126350000 lekë dhe kredidhënie DRINSIGAL Kosovë 108483300 lekë

AKTIVET QARKULLUESE

Aktivet qarkulluese përbëhen prej grupeve të tjera si, grupi *gjendje të inventarit* 3.322.141 lekë ku përfshihen gjendjet e shtypshkrimeve (policat e sigurimit) të vlerësuara me koston e blerjes, grupi *kërkesa të tjera mbi debitoret* 158478047 lekë të cilat do të analizohen më poshtë si dhe likujditete dhe vlera arke të tjera, të cilat dhe këto do të analizohen më poshtë.

Kërkesa për Arkëtim mbi debitorë

	Viti 2005	Viti 2004	ndryshimi	%
- Kliente	116236397	174266511	-58030114	66.6
- Ortakë kapitali i paderdhur	7682891	-	+7682891	
- Personeli dhe persona	6934725	3473154	+3461571	202
- Të tjera kërkesa	27.624034	18891.529	+8732505	150
TOTALI	158478047	196631195	+38153148	80,6

Shifrat e mësipërme për vitin 2005 rakordojnë me analizat përkatëse.
Klientët: për policat e sigurimit në vitin 2005 në krahasim me vitin 2004 janë ulur për 58030114 lekë ose 33,5%. Faktorët që mund të kenë ndikuar në këtë ulje janë:
a) Ulja e shitjeve në vitin 2005 në krahasim me 2004 prej 10% ka ndikuar në uljen e detyrimit të klientëve 17.426.000 lekë.
b) Parashikimi i klientëve të këqinj 12.089.444 lekë si DARFO 1.980.000 lekë, FALCIONE 4.5610212 lekë, P&I 1.691.450 lekë EUROFISH 784.820 lekë, BASHKIA TIRANË 684709 lekë SILO shpk 387478 lekë. LORI 290545 lekë të tjerë 15750 lekë.Parashkrimi i mesiperm I klienteve kam mendimin qe te behet me vendim te keshillit mbikeqyres te shoqerise.
c) Puna e mirë e bërë nga shoqëria për arkëtimin në kohë 28423260 lekë.
Në këtë rubrikë të bilancit përfshihet dhe Ministria e Rendit si kliente e vjetër që është në proces gjykimi për 21159675 lekë. Është zhvilluar faza e parë, e ka fituar shoqëria SIGAL sha dhe është në apel.

Ortakë kapital i paderdhur 7682891 lekë përfaqëson të drejtën që ka shoqëria ndaj Aksionarit Fondi shqiptar Amerikan për rritjen e kapitalit gjatë vitit 2005 dhe që u përballua nga katër aksionerët e tjerë, ndaj të cilëve shoqëria u detyrohet, detyrimi i secilit pasqyrohet në pasiv të bilancit në rubrikën Nr.88 me të njëjtin emërtim (ortakë). Sistemimet do të bëhet me rastin e miratimit të Bilancit dhe ndarjes së dividendit.
Personeli dhe persona 6934725 lekë përfaqëson detyrimet e agjentëve për licensën 5900000 lekë, sigurimeve të agjentëve 250.000 lekë, paradhënie punonjësve 2293970 lekë divident vitit 2004 për 467086. E.Hoxhaj dhe 88.269 lekë rimbursim nga sig.shoqërore për persona të paguar nga Shoqëria SIGAL sha
Të tjera kërkesa 27624034 lekë përfaqëson paradhënie dividenti 18905746 dhënë aksionerëve, furnitore debitore 3785343, kërkesë për rimbursim tvsh 1834426 lekë ngurtësim dëmi që nuk pranohet llogaritja nga të dëmtuari 1803969 lekë, zyra e përmbarimit Korçë 874500 lekë.

LIKUJDITETE DHE VLERA Të TJERA ARKA: paraqiten në bilanc për shumën 748356799 lekë në llogaritë që vijojnë

Mjetet monetare në Bankë 745.888308 lekë
Të ndara:
Në llogaritë rrjedhëse në Bankë 68723110 lekë
Në llogaritë depozita në Bankë 676.235.412 lekë
Në llogaritë garanci për tender në Bankë 929711 lekë

Shumat e pasqyruara në bilanc janë të rakorduara me konfermat bankare të datës 31.12.05. Mjetet monetare në bankë janë në lekë, në Euro dhe në U.S.D. Gjendjet në monedhë të huaj më 31.12.05 janë konvertuar në lekë me kursin e Bankës së Shqipërisë në këtë datë, diferenca e konvertimit është kaluar në llogarinë e rezultatit të ushtrimit.

Mjetet monetare në arkë paraqiten në bilanc 2468492 lekë, kuadron me llogarinë sintetike dhe librin e arkës. Mjetet monetare në arkë janë në lekë, në Euro dhe U.S.D. Gjendja në monedha të huaja më 31.12.05 janë konvertuar në lekë me kursin e Bankës së Shqipërisë në këtë datë.
U krye verifikimi i dokumentimit, regjistrimit dhe evidentimit në kontabilitet të transaksioneve të kryera nëpërmjet llogarive bankare dhe të arkës për muajt shkurt, gusht dhe Dhjetor 2005 sipas konfermave bankare, si dhe dokumenteve të arkës, gjendjes dhe rivlerësimit i valutës më 31.12.05 dhe u konstatua se janë kryer në rregull.
Diferenca konvertimit AKTIVE 756,565 lekë e pasqyruar në bilanc është llogaritur për kërkesat debitore dhe detyrimet kreditore në monedhë të huaj duke i vlerësuar me kursin e këmbimit të datës 31.12.05.

PASIVI

Kapitali themeltar në fund të vitit 2005 është 338669100 lekë. Në krahasim me vitin 2004 kapitali themeltar është rritur për 64.024.095 lekë. Kjo rritje është bërë sipas vendimit të Asamblesë së Zakonshme të Aksionerve të Shoqërisë SIGAL të datës 08.06.2005 dhe e vendimit të Gjykatës.

Fitimi i vitit të kaluar 116.026.619 lekë është shpërndarë për rritjen e kapitalit 64024095 lekë, divident për aksionerët 52000403 lekë dhe 2121 lekë kanë ngjelur për shpërndarje.

Fitimi i ushtrimit 100743549 lekë rakordon me rezultatin e pasqyrimit në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Provizione për rreziqe 998941990 lekë janë llogaritur nga shoqëria dhe miratuar nga Autoriteti mbikqyrës duke patur një rritje në krahasim me vitin e kaluar prej 139660934 lekë.

Detyrimet

Huara nga Banka 108.483300 lekë është overdrafti nga Banka Amerikane në Shqipëri dhe që i korespondon kreditimit Sigal Drini Kosovë.

Detyrime të tjera janë

= Shuma të arkëtuara me porosi 8885551 lekë

- Furnitore 16239676 lekë janë kryesisht media televizive për reklama. Këto shuma janë të dokumentuara dhe të pagushme.

Personeli 1041460 janë pagat e këshillit mbikqyrës.

Sigurime shoqërore 1676230 lekë të cilat janë paguar në janar 2006

- *Shteti tatime taksa* 26655496 lekë përbëhet tatim mbi të ardhurat 11940540 lekë, tvsh 10.079448 lekë të cilat janë paguar në janar 2006 dhe tatim fitimi 4635508 lekë.

Ortakë 7682891 lekë ka të bëjë me këtë emërtim në Aktiv të Bilancit në rubrikën 31 të cilën e trajtuam më sipër.

Të tjera detyrime 720355 lekë kanë të bëjnë me tatimin e llogaritur për dividentin paradhënie.

Diferenca konvertimi pasive 309179 lekë është llogaritur per mardheniet me te trete te mbajtura ne monedhe te huaj.

REZULTATI FINANCIAR

Të ARDHURAT

Mbështetur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kemi:

	V 2005	V 2004	Ndryshimi	%
Të ardhura	1207916784	1257523763	-49606979	96
Shpenzime	1071080726	1105391012	-34310286	96.9
Rezultati para tatimit	136836058	152132751	-15296693	89.9
Zbritet tatimi fitimi	36092508	4086077	-4776569	88,3
Fitimi neto	100743550	111263674	-10520124	90.5

Ndërsa fitimi tatimor paraqitet si më poshtë

Fitimi para tatimit 136836058 lekë
Shpenzime të pazbritshme 20087890 lekë
Nga të cilat
- Shpenzime pritje tej kufirit 4283435 lekë
- Gjoba e penalitete 2544913 lekë
- Parashkrim debitore 12089444 lekë

Fitimi tatimor 156923947 lekë
Përqindja e tatimfitimit 23%
Shuma e tatimfitimit 36092508 lekë

Nga verifikimet e bëra rezultoi që të te ardhurat janë dokumentuar dhe regjistruar në rregull. Për shpenzimet u bënë verifikime nëpërmjet verifikimit të transaksioneve të kryera nëpërmjet bankës dhe Arkës dhe rezultat që ato ishin dokumentuar dhe regjistuar në rregull. Me shpenzimet e shoqërisë janë përfshirë dhe humbjet nga parashkrimi i klientëve pa shpresë arkëtimi te cilet u trajtuan ne aktivet qarkulluese. Duke qenë se parashkrimi është bërë pa vendim gjyqi shuma përkatëse prej 12089444 lekë për ofertë tatimore është konsideruar si shpenzim i panjohur.
Përsa i përket shpenzimeve për dëmet përveç verifikimit të bërë nëpërmjet dokumenteve të pagesave nëpërmjet bankës dhe arkës, u bë dhe verifikimi i disa dosjeve por nga plotësimi i dokumentacionit dhe rezultoi që ishin në rregull.
Shpenzimet e raportuara i përkasin të ardhurave të raportuara dhe ushtrimit përkatës.

KONTROLLI I BRENDSHËM

Kontrolli i brendshëm realizohet nga mënyra e funksionimit të aparatit të drejtimit sipas organigramës që për mendimin tim është organizuar mire.
Për vitin 2005 shumë mirë ka funksionuar dhe seksioni i revizionimit të brendshëm. Ka punuar me një program pune dhe kontrollet e ushtruara i ka dokumentuar, i ka diskutuar dhe evaduar rregullisht.

PULLE TAKSE

100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter: Robert Koli
Studio: Rr.Uranj Pano, P 11.Katesh
Nr. 17781 Rep.

VERTETIM NOTERIAL

Sot me daten 26/10/2006 (dymije e gjashte), para meje Robert KOLI noter ne qytetin e Tiranes, me Seli si me siper, u paraqiten personalisht:

Z. jorgji BOLLANO, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me liçence Profesionale per Ekspert kontabel te Autorizuar, i njohur personalisht prej meje, i cili me deklaroi se ***Raportin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar per Pasqyrat Financiare te vitit 2005 per Shoqerine "SIGAL" SHA***, te bashkangjitur e ka hartuar dhe nenshkruar me vullnet te lire.

Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER
Robert KOLI

20363/3 A Caro
08 SHKURT 2005

KERKESE

KERKUESI: Shoqeria SIGAL sh.a

OBJEKTI: Depozitimi i akteve te shoqerise ne rregjistrin tregtar.

SIGAL
ALBANIAN INSURANCE C.O.

Adresa: Bul. "Zog. I"
Nr. 1, Tirane
Kutia Postare 2387
Tel / Fax: 04 250220 / 04 233308
Tel: 04 253407 / 04 253408
E-mail: info@sigal.com.al

Perpara: GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
(Seksionit Tregetar)

TIRANE

Z. Gjyqetar;

Shoqeria SIGAL sh.a e rregjistruar si person juridik me vendimin Nr 20863 date 22.02.1999 te Gjykates se Shkalles se pare Tirane ne vijim te funksionimit te saj si shoqeri tregtare me vendimin date 26.01.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te saj ka vendosur te beje disa ndryshime ne statutin e shoqerise, si dhe me vendimin Nr 02 date 26.01.2005 Keshilli Mbikqyres i shoqerise ka vendosur te emroje z. Avni Ponari ne detyren e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise me afat 5 viet, pasi mandati i meparshem eshte ne skadim.
Nisur nga fakti se keto akte jane ne pajtim te ligjes "Per Shoqerite tregtare" dhe te dokumentave te tjera te shoqerise ju paraqesim kete kerkese qe urdheroni depozitimin e ketyre akteve ne rregjistrin tregtar.
Bashkelidhur me kerkesen ju vemi ne dispozicion keto akte:
-Vendimi i Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve date 26.01.2005.
-Vendimi Nr 02.date 26.01.2005 te Keshillit Mbikqyres te SIGAL sh.a

Tirane, me 07/02/2005

KERKUESI

SIGAL sh.a
Avni PONARI
Drejtor I Pergjithshem

SIGAL SHQIPTAR SIGURANCE
DREJTORIA E PERGJITHSHME
HEAD OFFICE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter Robert Koli
Selia:Rr."Urani Pano" Pa.11/katesh
Nr. 823 Rep.

PULLE TAKSE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE TIRANE

VERTETIM NOTERIAL

Sot, me daten 07.02.2005 (dymijepese), diten e Hene, para meje Robert KOLI, noter ne qytetin e Tiranes me Seli si me siper, u paraqiten personalisht:

Shoqeria "SIGAL" sh.a, me adrese ne Bulevardi "Zog I", Nr.1, Tirane, regjistruar si person juridik me vendimin e gjykates Nr.20863, dt. 22.02.1999, perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem i "SIGAL" **Z.Avni PONARI**, i biri i Rexhepit, lindur me 28.07.1957 dhe banues ne Tirane, Rr. "Nikolla Tupe", Pall.10-katesh, Kati i 4, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga Pasaporta Nr.1996645, i cili me deklaroi se ***Kerkesen*** e bashkengjitur e ka hartuar dhe nenshkruar me vullnet te lire. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER
Robert KOLI

KESHILLI MBIKQYRES
Shoqeria e Sigurimeve
"SIGAL" Sh.a

VENDIM
Nr. 02, date 26.01.2005

PER EMERIMIN E DREJTORIT TE PERGJITHSHEM TE SHOQERISE

Ne perputhje me kompetencat e percaktuara ne statutin e shoqerise SIGAL sha dhe te ligjit " Per shoqerite tregtare", pasi mori ne shqyrtim rendin e dites ne perfundim Keshilli Mbikqyres i shoqerise:

VENDOSI

a- Emerimin e Z. Avni Ponari, ne detyren e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise Siguracioni Shqipetar, SIGAL sh.a me mandat pese vjet.

b- Mandat i cili fillon me date 22.02.2005.

KRYETARI

Shyqyri DURAKU

SEKRETARI

Av. Gjelosh QOKAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter Robert Koli
Selia:Rr."Urani Pano" Pa.11/katesh
Nr. 822 Rep.

PULLE TAKSE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE TIRANE

VERTETIM NOTERIAL

Sot, me daten 07.02.2005 (dymijepese), diten e Hene, para meje Robert KOLI, noter ne qytetin e Tiranes me Seli si me siper, u paraqiten personalisht:

Shyqyri DURAKU, i biri i Alushit, lindur me 08.10.1954 dhe banues ne Tirane, Rr. "Kavajes", Nr.58, identifikuar nga Pasaporta Nr.06087763, ne cilesine e Kryetarit te Keshillit Mbikeqyres te ***"SIGAL"*** sha, dhe
Gjelosh QOKAJ, i njohur personalisht prej meje, ne cilesine e Sekretarit te Keshillit Mbikeqyres te ***"SIGAL"*** sha,
te dy madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me deklaruan se ***Vendimin Nr. 02, date 26.01.2005*** te bashkengjitur e kane hartuar dhe nenshkruar me vullnet te lire. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER
Robert KOLI

V E N D I M

I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONESHME
TE AKSIONERVE TE
SHOQERISE SIGAL, SIGURACIONI SHQIPETAR SH.A

Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerve te shoqerise SIGAL sh.a SIGURACIONI SHQIPETAR Sh.a u mblodh sot me date 26.01.2005, ne selin e shoqerise, Bulevardi "Zog i I" Nr.1 Tirane.

Ne mbledhje moren pjese te gjithe aksioneret, qe perfaqesojne te gjithe vleren e kapitalit te Shoqerise si vijon:

- Z. Shyqyri Duraku, qe zoteron 24.168 aksione ose 26,40% te kapitalit te shoqerise.
- Z. Llazar Angjeli, qe zoteron 24.168 aksione ose 26.40 % te kapitalit te shoqerise
- Z. Avni Ponari, qe zoteron 26.586 aksione ose 29.04% te kapitalit te shoqerise.
- Z. Edvin Hoxhaj, qe zoteron 5.639 aksione ose 6.16% te kapitalit te shoqerise.
- Z. Jeffrey T. Griffin, perfaqesues I aksionerit Fondi Shqipetaro-Amerikan I ndermarrjeve, qe zoteron 10.987 aksione ose 12% te kapitalit te shoqerise.

Asambleja eshte thirrur rregullishte per te marre ne shqyrtim dhe vendosur mbi ceshtjet e meposhtme te rendit te dites:

1. Ndryshime ne Statutin e Shoqerise.

2. Te ndryshme.

Meqenese ne mbledhje eshte arritur kuorumi i kerkuar nga ligji, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerve pasi shqyrtoje ceshtjet ne rendite, mori me unanimitet vendimet e meposhtme.

<u>Pika e pare e rendit te dites</u>
Ndryshimet ne statutin e Shoqerise;

Asambleja pasi degjoj relacionin e pregatitur me kete raste vendosi qe ne statutin e shoqerise te beje ndryshimet e meposhteme:

Permbajtja e nenit 21 behet si vijon:

Keshilli Mbikqyres i shoqerise SIGAL sh.a ka ne kompetece te krijoje Komitetin e Kortrollit te Brendshem si strukture organike e kompanise, te percaktoje numerin e anetarve te ketij Komiteti, te percaktoje kompetencat e tij, te miratoje rregulloren per funksionimin e tij. Ne fillim te cdo viti te ri brenda muajt Janar, K.Mbikqyres do te percaktoje progarimin vjetor te punes se Komitet te Kontrollit te Brendshem
Eshte kompetence e Keshillit Mbikqyres te shoqerise te beje emrimet e anetareve te Komitetit te kontrollit te Brendshem.

Ne nenin 25 te statutit behet ky ndryshim

Mandati i Drejtorit te Pergjithshem nga tre vjet qe ishte do te behet pese vjet.

Neni 30 i statutit ndryshon si me poshte.

Asambleja e pergjithshme e aksionereve ne cdo vit financiar cakton nje Shoqeri ekspertesh kontabel te autorizuar si ekspert kontabel te autorizuar per vitin financiar, mandati i te cilit perfundon me paraqitjen e raportit nga ky i fundit ne mbledhjen e pergjithshme te aksionereve qe miraton bilancin vjetor te Shoqerise,pasi te jete marre me perpara miratimi i Autoritetit per kete emerim, kjo ne perputhje me ligjin 9267 date 29.07.2004 "Per veprimtarine e sigurimit, te risigurimit dhe ndermjetesimit ne sigurime dhe risigurime".

Pika e dyte e rendit te dites.

Asambleja e Jashtezakoneshme e Aksionerve vendosi me unanimitet qe te ngarkoje Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise qe ndryshimet e mesiperme te statutit te depozitohen ne Rregjistrin Tregtare prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

AKSIONERET

Z. Shyqyri Duraku

Z. Llazar Angjeli

Z. Avni Ponari

Z. Edvin Hoxhaj

Z. Jeffery T. Griffin
Perfaqesues i Fondit Shqipetaro-Amerikan te Ndermarrjeve

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter Robert Koli
Selia:Rr."Urani Pano" Pa.11/katesh
Nr. 821 Rep.

PULLE TAKSE

100 LEKE

VERTETIM NOTERIAL

Sot, me daten 07.02.2005 (dymijepese), diten e Hene, para meje Robert KOLI, noter ne qytetin e Tiranes me Seli si me siper, u paraqiten personalisht:

Shyqyri DURAKU, i biri i Alushit, lindur me 08.10.1954 dhe banues ne Tirane, Rr. "Kavajes", Nr.58, identifikuar nga Pasaporta Nr.06087763,
Avni PONARI, i biri i Rexhepit, lindur me 28.07.1957 ne Tropoje dhe banues ne Tirane, Rr. "Nikolla Tupe" Pall. 10-katesh, mbajtes i passaportes me Nr.1996645
Llazar ANGJELI, i biri i Sotirit, lindur me 05.02.1940 dhe banues ne Tirane, Rr. "Durresit", Pall.124/2-15, identifikuar nga Pasaporta Nr.09401407,
Edvin HOXHAJ, i biri i Skenderit, lindur me 30.04.1966 dhe banues ne Tirane, Rr. "Irfan Tomini", identifikuar nga Pasaporta Nr. 1247470,
Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve, me seli ne SHBA, me zyre perfaqesimi ne Green Tower Complex, Kulla 2, Kati 12, Tirane, Shqiperi, perfaqesuar nga ***Jeffrey T. GRIFFIN***, me cilesine e presidentit, lindur me 14.06.1944 dhe banues ne Tirane, identifikuar nga Pasaporta Nr. Z8236285,
te gjithe madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me deklaruan se ***Vendimin e Asamblese se Jashtezakoneshme te Aksionereve te Shoqerise "SIGAL" sha*** te bashkengjitur e kane hartuar dhe nenshkruar me vullnet te lire. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER
Robert KOLI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr 20863/8

VENDIM
I GJYQTARES SE VETME

Sot, me date 08.02.05 une A. Caco gjyqtare ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane, pasi mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Avni Ponari, Drejtor i Pergjithshem i shoqerise "SIGAL" sh.a i cili kerkon te depozitoj Vendimet date 26.01.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise SIGAL sh.a, dhe vendimit Nr 2 date 26.01.2005 te Keshillit Mbikqyres te kesaj shoqerie.

K O N S T A T O V A :

Se; Shoqeria "SIGAL" sha e rregjistruar si person juridik me vendimin Nr 20863 date 22.02.1999 te Gjykates se Shkalles se pare Tirane, me seli Bul "Zog I" Nr.1 Tirane.

Me vendimin date 26.01.2005 asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerve te shoqerise SIGAL sh.a ka vendosur te beje ndryshime ne statutin e shoqerise qe kane te bejne me krijimin e Komitetit te Kontrollit te Brendshem te shoqerise, me ndryshimin e mandatit te Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise duke e bere afatin 5 vjet, si dhe me lejimin si ekspert kontabel te autorizuar te shoqerise vetem shoqeri te ekspertit Kontabel.

Gjithashtu me vendimin nr 02 date 26.01.2005 Keshilli Mbikqyres i shoqerise SIGAL sh.a ka emruar z.Avni Ponari ne detyren e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise me mandat 5 vjecar.

Kerkesa e tij per depozitimin e vendimit date 26.01.2005 te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionerve dhe vendimit nr 02. date 26.01.2005 te Keshillit Mbikqyres prane skedines perkatese te SIGAL sh.a eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 per shoqerite tregtare si dhe te ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar";

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin e vendimit date 26.01.2005te Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve te shoqerise SIGAL sh.a dhe te vendimit nr 02 date 26.01.2005 te Keshillit Mbikqyres te kesaj shoqerie.

Te behen ndryshimet ne Skedinen Perkatese te shoqerise "SIGAL"sh.a ne kollonen 4, germa ç, germa é duke u ndare rregjistrimet nga njera tjetra me vije te kuqe.

GJYQTARE

Ariane Ceco

MARREVESHJE PER SHIT-BLERJEN E AKSIONEVE

MIDIS

FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TE NDERMARRJEVE
Organizate Pa-Qellim-Fitimi, e krijuar sipas Legjislacionit te Shtetit Delaware, U.S.A.

dhe

Z. SHYQYRI DURAKU

dhe

Z. LLAZAR ANGJELI

dhe

Z. AVNI PONARI

dhe

Z. EDVIN HOXHAJ

Date 9 Tetor 2003

MARREVESHJE PER SHIT-BLERJEN E AKSIONEVE

KJO MARREVESHJE, lidhet sot me date 9 Tetor 2003, midis:

- **FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TE NDERMARRJEVE**, organizate pa-qellim-fitimi, krijuar sipas legjislacionit te Shtetit Delaware, U.S.A, me seli ne USA dhe me zyre perfaqesimi ne, "Green Park" Complex, Kulla 2, Kati XII, Tirane, Shqiperi, perfaqesuar nga Z. Jeffrey T. Griffin, ne cilesine e Presidentit & CEO te AAEF (me poshte i quajtur "Fondi");

Dhe

- **Z. SHYQYRI DURAKU**, shtetas shqiptar, lindur ne Kukes me 08.12.1954, mbajtes i pasaportes nr. 0608763, banues ne Rr.e Kavajes, No.58, Tirane;
- **Z. LLAZAR ANGJELI**, shtetas shqiptar, lindur ne Sarande, me 05.02.1940, mbajtes i pasaportes nr. 0085140, banues ne Rr. e Kavajes, No.24, H2/15, Tirane;
- **Z. AVNI PONARI**, shtetas shqiptar, lindur ne Tropoje, me 28/04/1954, mbajtes i pasaportes nr. [illegible] banues ne TIRANE;
- **Z. EDVIN HOXHAJ**, shtetas shqiptar, lindur ne Lushnje, me 30.04.1966, mbajtes i pasaportes nr. 1247470, banues ne Rr. Irfan Tomini, Pallati No.4, Hyrja C/4, Tirane; (me poshte te quajtur "Aksionaret Ekzistues");

MEQENESE

(A) Aksionaret Ekzistues zoterojne te gjitha aksionet e kapitalit te shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SHA. (SIGAL SHA.) (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e cila eshte nje shoqeri anonime sigurimesh, e krijuar dhe qe zhvillon aktivitetin e liçensuar rregullisht sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, me kapital te nenshkruar dhe te shlyer teresisht nga Aksionaret Ekzistues ne shumen Leke 100.000.000 (njeqind million Leke), i ndare ne 33.333 aksione nga Leke 3.000 (tre mije Leke) secili (me poshte i quajtur "Kapitali"), me seli ne adresen: Bulevardi "Zogu I", Pallati i Diplomateve, No.57, Tirane.

(B) Aksionaret Ekzistues zoterojne te gjitha aksionet e Kapitalit e Shoqerise ne raportet e meposhtme:

AKSIONARET EKZISTUES	AKSIONET
Z. Shyqyri Duraku	10.000 (30%)
Z. Llazar Angjeli	10.000 (30%)
Z. Avni Ponari	11.000 (33%)
Z. Edvin Hoxhaj	2.333 (7%)
TOTAL	33.333 (100%)

(C) Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise e mbajtur ne date 9 Tetor, 2003, ka vendosur te zmadhoje Kapitalin e Shoqerise duke emetuar aksione te reja ne dy faza: (i) Ne Fazen e Pare Shoqeria do te emetoje 4.546 (kater mije e peseqind e dyzet e gjashte) aksione te reja me vlere nominale Leke 3.000 (tre mije) secili. Te gjitha aksionet e emetuara ne Fazen e Pare do te nenshkruhen dhe shlyhen

me te holla ne dore nga Fondi, kundrejt shumes US$ 1.500.000 (nje milione e peseqind mije dollare US), duke u bere aksionar i ri i Shoqerise. Kapitali i Shoqerise pas zmadhimit te Fazes se Pare do te jete Leke 113.636.363 (njeqind e trembedhjete million e gjashteqind e tridhjete e gjashte mije e treqind e gjashtedhjete e tre). Numri i aksioneve qe do te zoteroje Fondi (4.546 aksione) ("Aksionet e Fondit te Fazes se Pare") do te perbeje 12% te te gjithe Kapitalit te Shoqerise pas zmadhimit te kesaj faze. Numri i aksioneve qe do te zoterojne Aksionaret Ekzistues ne fund te Fazes se Pare do te mbetet i njejte me ate qe zoteronin perpara zmadhimit te Kapitalit; (ii) Ne Fazen e Dyte Shoqeria do te emetoje 53.670 (pesedhjete e tre mije e gjashteqind e shtatedhjete) aksione te reja me vlere nominale Leke 3.000 (tre mije) secili, qe do te nenshkruhen nga Aksionaret Ekzistues dhe Fondi ne raport me numrin e aksioneve qe do te zoterojne ne Kapitalin e Shoqerise ne fund te Fazes se Pare. Zmadhimi i Kapitalit dhe shlyerja e aksioneve te reja te emetuara nga Shoqeria ne Fazen e Dyte do te behet nepermjet perfshirjes se primit te emetimit te aksioneve te Fazes se Pare (diferenca midis shumes US$ 1.500.000 qe Fondi do t'i paguaje Shoqerise ne Fazen e Pare dhe vleres se pergjithshme nominale te aksioneve te emetuara nga Shoqeria ne Fazen e Pare). Kapitali i Shoqerise pas zmadhimit te Fazes se Dyte do te jete Leke 274.645.000 (dyqind e shtatedhjete e kater million e gjashteqind e dyzet e pese mije). Numri i aksioneve qe do te zoteroje Fondi ne fund te Fazes se Dyte do te jete 10.987 aksione ("Aksionet e Fondit te Fazes se Dyte") dhe do te perbejne perseri 12% te te gjithe Kapitalit te Shoqerise pas zmadhimit te kesaj faze. Kurse Aksionaret Ekzistues do te zoterojne repsektivisht: Shyqyri Duraku, 24.168 aksione ose 26.40% te Kapitalit; Llazar Angjeli, 24.168 aksione ose 26.40% te Kapitalit; Avni Ponari, 26.586 aksione ose 29.04% te Kapitalit; dhe Edvin Hoxhaj, 5.639 aksione ose 6.16% te Kapitalit. Marredheniet midis Fondit, Aksionareve Ekzistues dhe Shoqerise ne lidhje me zoterimin e aksioneve nga ana e Fondit jane rregulluar nepermjet Marreveshjes se Investimit te lidhur midis Fondit, Aksionareve Ekzistues dhe Shoqerise me date 9 Tetor 2003 ("Marreveshja e Investimit"), e cila, se bashku me Vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve te Shoqerise, date 9 Tetor 2003, i bashkengjitet kesaj Marreveshje si pjese perberese e saj.

(D) Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise, mbledhur ne daten 9 Tetor 2003, ka vendosur ndryshimet e neneve perkatese te statutit te Shoqerise sipas kerkesave te Fondit, si dhe ka vendosur te emeroje ne cilesine e Anetarit te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise Z. Jeffrey T. Griffin, shtetas amerikan, lindur ne USA, me 14 Qershor 1944, mbajtes i pasaportes nr. 710333338, banues ne Shqiperi, Tirane, me kerkese te Fondit.

(E) Aksionaret Ekzistues marrin persiper qe te blejne nga Fondi dhe Fondi merr persiper qe tu shese Aksionareve Ekzistues, te gjitha aksionet qe zoteron Fondi ne Kapitalin e Shoqerise, sipas kushteve dhe afateve te parashikuara me poshte.

DUKE PATUR PARASYSH KUSHTET E SIPERPERMENDUR, PALET BIEN DAKORT SI VIJON:

NENI 1
PERKUFIZIME

Termat e perdorura ne kete Marreveshje do te kene kuptimin e pershkruar me poshte nese nuk eshte parashikuar ndryshe apo nese nuk kane kuptim tjeter sipas kontekstit te perdorimit:

"Aksionet e Fondit"	do te thote çdo dhe te gjitha aksionet e reja te emetuara nga Shoqeria sipas Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve te Shoqerise date 9 Tetor 2003, ose ato te leshuara si rrjedhim i çdo pershtatjeje te mundshme te vleres se Kompanise per vitin 2002, qe mund te behet ne te ardhmen, te nenshkruara dhe shlyera nga Fondi sipas Marreveshjes se Investimit, date 9 Tetor 2003.
"Data e Dorezimit"	do te thote data ne te cilen Njoftimi i Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes ose te Blerjes se Aksioneve i dorezohet respektivisht Aksionareve Ekzitues nga Fondi ose Fondit nga Aksionaret Ekzistues.
"Njoftimi i Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes"	do te thote njoftimi i dorezuar Aksionareve Ekzistues nga Fondi sipas parashikimeve te Nenit 2.3, ne te cilin duhet te caktohen te pakten: (i) Numrin e Aksioneve te Fondit qe do t'i shiten Aksionareve Ekzistues nga Fondi; (ii) Çmimin e Shitjes, i cili do te caktohet ne Daten e Zbatimit ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje; (iii) Daten e Zbatimit; dhe (iv) Vendin e Zbatimit.
"Afati i Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes"	do te thote periudha prej 3 (tre) vjetesh, e cila fillon nga viti 2006 dhe perfundon ne vitin 2008.
"Çmimi i Shitjes"	ka kuptimin e percaktuar ne Nenin 3.1, i cili do te llogaritet dhe do te paguhet ne dollare amerikane.
"Njoftimi i Ushtrimit te se Drejtes se Blerjes"	do te thote njoftimi i dorezuar Fondit nga Aksionaret Ekzistues sipas parashikimeve te Nenit 2.3, ne te cilin duhet te caktohen te pakten: (i) Numrin e Aksioneve te Fondit qe Aksionaret Ekzistues do te blejne nga Fondi;

	(ii) Çmimin e Blerjes i cili do te caktohet ne Daten e Zbatimit ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje; (iii) Daten e Zbatimit; dhe (iv) Vendin e Zbatimit.
"Afati i Ushtrimit te se Drejtes se Blerjes"	do te thote periudha prej 2 (dy) vjetesh, e cila fillon nga viti 2007 dhe perfundon ne vitin 2008.
"Çmimi i Blerjes"	ka kuptimin e percaktuar ne Nenin 3.2, e cila do te llogaritet dhe paguhet ne dollare amerikane.
"Data e Pare e Zbatimit"	do te thote 30 dite pas dates se Dorezimit.
"Data e Dyte e Zbatimit"	do te thote 90 dite pas mbylljes se vitit financiar, ne te cilin u vendos per daten e Dorezimit
"Vendi i Zbatimit"	do te thote vendi ne Tirane, Shqiperi, siç percaktohet ne Njoftimin e Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes ose te Blerjes qe do te jete vendi ne te cilin Aksionaret Ekzitues do t'i paguajne Fondit Çmimin e Shitjes ose te Blerjes se Aksioneve te Fondit.
"Aksionet"	do te thote aksionet e Kapitalit te Shoqerise.
"PBT"	do te thote fitimi perpara takses dhe shpenzimeve te jashtezakonshme

NENI 2
E DREJTA E SHITJES DHE E DREJTA E BLERJES SE AKSIONEVE

2.1 Fondi ka te drejte qe, ne çdo moment dhe here pas here, gjate Afatit te Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes, nepermjet dorezimit te Njoftimit te Ushtrimit te Drejtes se Shitjes ne adrese te Aksionareve Ekzistues t'u shese atyre te gjitha ose nje pjese te Aksioneve te Fondit, qe zoterohen prej tij ne Kapitalin e Shoqerise ne Daten e Dorezimit te Njoftimit te Ushtrimit te Drejtes se Shitjes, kundrejt Çmimit te Shitjes te caktuar ne Daten e Zbatimit. E drejta e Fondit per te kerkuar nga Aksionaret Ekzistues qe te blejne Aksionet e Fondit me poshte do te quhet "E Drejta e Shitjes". Me ushtrimin nga Fondi te kesaj te drejte, Aksionaret Ekzistues jane te detyruar, qe bashkerisht apo individualisht, te blejne te gjitha ose pjesen e Aksioneve te Fondit kundrejt Çmimit te Shitjes.

2.2 Aksionaret Ekzistues kane te drejte qe, ne çdo moment dhe here pas here gjate Afatit te Ushtrimit te se Drejtes se Blerjes, nepermjet dorezimit te Njoftimit te Ushtrimit te Drejtes se Blerjes ne adrese te Fondit te blejne nga Fondi te gjitha Aksionet qe Fondi zoteron ne Kapitalin e Shoqerise ne Daten e Dorezimit te Njoftimit te Ushtrimit te Drejtes se Blerjes, kundrejt Çmimit te Blerjes te caktuar ne Daten e Zbatimit. E drejta e Aksionareve

Ekzistues per te kerkuar nga Fondi qe t'u shese Aksionet e Fondit me poshte do te quhet "E Drejta e Blerjes". Me ushtrimin nga Aksionaret Ekzistues te kesaj te drejte, Fondi eshte i detyruar qe t'u shese Aksionareve Ekzistues te gjitha Aksionet e Fondit kundrejt Çmimit te Blerjes.

2.3 Njoftimi i Ushtrimit te se Drejtes se Blerjes dhe Pjeset perkatese te Fondit ("Pjeset Objekt Shitje") do t'i ofrohen secilit Aksionar ne proporcion me numrin e pjeseve qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise. Ne rast se njeri nga Aksionaret Ekzistues, per çfaredo arsye, nuk blen pjeset korresponduese te Pjeseve Objekt Shitje ne ose para Dates se Zbatimit, ne Vendin e Zbatimit, atehere sipas rastit aksioneret e tjere jane te detyruar te blejne edhe Pjeset e mbetura te Fondit.

NENI 3
ÇMIMI I SHITJES DHE ÇMIMI I BLERJES

3.1 Çmimi i Shitjes per Aksion, per te cilin Fondi dhe Aksionaret Ekzistues palet bien dakort nepermjet nenshkrimit te kesaj Marreveshje, do te jete i barabarte me shumen e percaktuar sipas formules se meposhtme dhe do te konsiderohet si çmim i drejte i caktuar midis shitesit dhe bleresit ne nje kontrate te zakonshme shitje, dhe do te llogaritet sipas bazes se meposhtme:

7.3 here PBT-ne e vitit, ne te cilin ekzekutohet e Drejta e Shitjes

3.2 Çmimi i Blerjes per Aksion, per te cilin Fondi dhe Aksionaret Ekzistues bien dakort nepermjet nenshkrimit te kesaj Marreveshje, do te jete i barabarte me shumen e percaktuar sipas formules se meposhtme dhe do te konsiderohet si çmim i drejte i caktuar midis shitesit dhe bleresit ne nje kontrate te zakonshme shitje, dhe do te llogaritet sipas bazes se meposhtme:

9.3 here PBT-ne e vitit, ne te cilin ekzekutohet e Drejta e Blerjes

3.3 (A) Ekzekutimi i pageses se Shitjes do te behet ne dy faza: 1) Fondi do te marre aksionet e tij proporcionalisht (llogaritur sipas aksioneve te tij ne Shoqeri si nje perqindje e shumes se pergjithshme te aksioneve te Shoqerise) me 7.3 here PBT-ne e vitit te meparshem fiskal deri ne Daten e Pare te Zbatimit dhe 2) Fondi do te marre diferencen e pageses sikunder eshte parashikuar ne Daten e Dyte te Zbatimit.

(B) Ekzekutimi i pageses se Blerjes do te behet ne dy faza: 1) Fondi do te marre aksionet e tij proporcionalisht (llogaritur sipas aksioneve te tij ne Shoqeri si nje perqindje e shumes se pergjithshme te aksioneve te Shoqerise) me 9.3 here PBT-ne e vitit te meparshem fiskal deri ne Daten e Pare te Zbatimit dhe 2) Fondi do te marre diferencen e pageses sikunder eshte parashikuar ne Daten e Dyte te Zbatimit.

NENI 4
TRANSFERIMI I AKSIONEVE

4.1 Aksionaret Ekzistues ne Daten dhe Vendin perkates te Zbatimit, do te blejne numrin e Aksioneve te Fondit te percaktuar ne Njoftimin e Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes ose te Blerjes dhe do te paguajne Çmimin e Shitjes ose te Blerjes, sipas rastit, ne fonde

menjehere te perdoreshme ne dollare US dhe Fondi do t'u dorezoje dokumentet e nenshkruara rregullisht te cilat jane te nevojshme per te transferuar Aksionet e Fondit te lira nga çdo barre apo e drejte e te treteve.

4.2 Nese te gjithe apo ndonje nga Aksionaret Ekzistues nuk i paguajne Fondit Çmimin e Shitjes apo te Blerjes, sipas rastit, ne nje shume te vetme branda Dates se Zbatimit, me kusht qe te njoftojne me shkrim Fonditn per pamundesine e tyre te pakten 10 dite nga Data e Zbatimit. Aksionari apo Aksionaret Ekzistues te cilet jane ne vonese do t'i paguajne Fondit Çmimin e Shitjes apo te Blejres, sipas rastit, brenda nje afati 3 (tre) vjetesh dhe mbi shumen e papaguar te çmimit do te aplikohet nje interes 12% ne vit.

4.3 Çmimi i Blerjes nuk mund te financohet. Nese ndonje nga Aksionerat Ekzistues nuk mund te paguaje shumen perkatese brenda Datave te Zbatimit, atehere e Drejta e Blerjes do te konsiderohet absolutisht e pavlefshme.

4.4 Anetari i Keshillit Mbikqyres te Shoqerise, i caktuar nga Fondi, do te qendroje si i tille me te drejte vote ne Keshillin Mbikqyres, duke gezuar gjithe te drejtat, deri ne momentin qe Aksionaret Ekzistues t'i kene paguar Fondit te gjithe çmimin e Shitjes ose Blerjes sipas rastit, si dhe per çdo shume tjeter te pagueshme qe aplikohet sipas kushteve te kesaj Marreveshjeje ose Marreveshjes se Investimit.

NENI 5
TRANSFERIMI I TE DREJTAVE

5.1 Kjo Marreveshje do te jete detyruese dhe do te sjelle te drejta ne favor te pasuesve te paleve te kesaj Merreveshjeje ose personave, te cileve palet e kesaj Marreveshjeje u kane transferuar te drejta. Palet mund te transferojne keto te drejta plotesisht ose pjeserisht vetem me pelqimin paraprak me shkrim te Fondit.

5.2 Nese ndonje nga Aksionaret Ekzistues deshiron te shese apo te transferoje pjeserisht apo teresisht Aksionet e tij ne Kapitalin e Shoqerise tek te trete, ky Aksionar Ekzistues duhet te njoftoje me shkrim Fondin. Njoftimi duhet te permbaje te dhena ne lidhje me kushtet dhe afate e propozuara te shitjes, transferimit apo çdo forme tjeter disponimi te Aksioneve, personin e propozuar qe do t'i transferohen Aksionet, si dhe çdo te dhene tjeter qe mund te kerkoje Fondi me shkrim. Transferimi Aksioneve mund te behet dhe do te jete i vlefshem vetem me pelqimin paraprak me shkrim te Fondit.

5.3 Nese Aksionaret Ekzistues vendosin te shesin nje pjese ose te gjitha aksionet e tyre nje pale te trete, atehere Aksionaret Ekzistues nuk mund t'i shesin keto aksione pa ofruar te perfshijne ne kete shitje dhe me te njejtat kushte, te njejten shume ne perqindje te aksioneve te Fondit. Fondi nuk ka asnje detyrim per te pranuar oferten e bere nga Bleresi per te blere aksionet e Fondit.

5.4 Aksionari shites dhe Bleresi i propozuar, qe nuk eshte pale e kesaj Marreveshjeje, jane te detyruar te garantojne Fondin se kusht per transferimin e te drejtave dhe detyrimeve te

Aksionarit shites, sipas kesaj Marreveshjeje, i transferohen Bleresit se bashku me Aksionet perkatese dhe do te kene fuqi detyruese edhe per te.

5.5 Pavaresisht nga sa parashikohet ne kete Marreveshje, Fondi, sipas zgjedhjes te tij dhe ne çdo kohe, mund te dale nga Shoqeria dhe t'u shese ose te disponoje ne favor te personave te trete aksionet e tij, pa pasur nevoje per miratimin e Aksionareve Ekzistues. Fondi bie dakord qe ne rast te daljes se tij nga Kompania sikurse permendur me siper, atehere kjo blerje do tu ofrohet Aksionereve Ekzistues, ne menyre proporcionale, me te njejtat terma dhe kushte.

NENI 6
TE NDRYSHME

6.1 Pa paragjykuar mjetet e tjera ne favor te Fondit sipas kesaj Marreveshje ose ndryshe, nese Aksionaret Ekzistues nuk kryejne pagesat perkatese perpara apo ne daten e percaktuar ne kete Marreveshje, do te paguajne 12% interes vonese ne dollare US, te caktuar ne menyre te arsyeshme nga Fondi te llogaritur nga Data e Zbatimit.

6.2 Me perjashtim te taksave dhe/ose tatimieve (nese ka te tille) qe zbatohet mbi fitimin qe do te realizoje Fondi (nese realizon nje te tille) per shkak te shitjes se Aksioneve te Fondit sipas kesaj Marreveshje, i cili duhet te paguhet nga Fondi, Aksionaret Ekzistues marrin persiper qe te paguajne çdo takse dhe/ose tatim (perfshire edhe taksen e pulles), detyrime apo shuma te tjera te pagueshme ne lidhje me nenshkrimin, dorezimin, zbatimin, regjistrimin apo noterizimin e kesaj Marreveshje ose shitjen ose transferimin e Aksioneve te Fondit ne favor te Aksionareve Ekzistues, ose ne lidhje me çdo dokument tjeter ne lidhje me te; dhe do te rimbursojne Fondin ne lidhje me keto shpenzime.

6.3 Aksionaret Ekzistues nuk do te ndermarrin e as do te mbeshtesin veprime (si aksionare te Shoqerise), objekt i te cileve eshte pengimi apo ndalimi i shitjes, transferimit, apo disponimit te Aksioneve nga ana e Fondit.

6.4 Çdo njoftim apo komunikim sipas kesaj Marreveshje duhet te behet me shkirm dhe te dergohet nepermjet (i) postes rekomande me pergjigje te marresit ne adresen te pales se ciles i behet njoftimi, (ii) postes ekspres, ose (iii) duke ia dorezuar pdorazi personit. Njoftimi do te konsiderohet i marre ne daten ne te cilen eshte dorezuar dorazi ose diten e dyte te punes pas dites se nisjes me poste ekspres. Nese njoftimi dergohet me poste rekomande, ai do te konsiderohet se eshte marre diten e trete te punes nga data ne te cilen eshte postuar. Per qellim njoftimi, adresat e paleve do te jene ato qe tregohen ne fillimin e kesaj Marreveshje.

6.5 Kjo Marreveshje ka fuqi ligjore per palet dhe pasuesit e tyre. Asnje nga palet e kesaj Marreveshje nuk ka te drejte qe t'i kaloje apo transferoje ne çfaredo menyre te gjitha apo nje pjese te te drejtave dhe detyrimeve qe rrjedhin per to sipas kesaj Marreveshje, pa miratimin paraprak te paleve te tjera.

6.6 Kjo Marreveshje dhe te drejtat e detyrimet e paleve do te rregullohen, interpretohen dhe ekzekutohen ne perputhje me legjismacionin e Republikes se Shqiperise dhe te gjitha konfliktet do t'i paraqiten per zgjidhje Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

NE PRANI TE NJERI TJETRIT, palet nenshkruajne kete Marreveshje ne pese origjinale ne gjuhen angleze e pese ne gjuhen shqipe me vlere te njejte seciła, sot me date 9 Tetor 2003.

FONDI SHQIPTARO-AMERIKAN I NDERMARRJEVE

FONDI SHQIPTARO AMERIKAN I NDERMARJEVE TIRANE ALBANIA

Nga: _____

Emri: Jeffrey T. Griffin

Titulli: President dhe CEO

Z. SHYQYRI DURAKU

Shyqyri Duraku

_____

Z. LLAZAR ANGJELI

Llazar Angjeli

_____

Z. AVNI PONARI

SIGURACIONI SHQIPTAR
DREJTORIA QENDRORE
HEAD OFFICE

AVNI SIGAN

_____

Z. EDVIN HOXHAJ

Edvin Hoxhaj

_____

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr.Rep. 5873
Nr. Kol. 1873

VERTETIM

Une, MIMOZA I. SADUSHAJ, Anetare e Dhomes se Notereve te Tiranes, me zyre Rruga Durresi, Pal.11, vertetoj se sot me date 10 Dec 3 u paraqiten para meje personat e mesiperm, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, te njohur prej meje nga dokumenti I identifikimit, te cilet nenshkruan dokumentin sa me siper ne pranine time dhe Une, Noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

51

BULETIN I NENSHKRIMIT TE AKSIONEVE TE REJA TE EMETETUARA NGA SHOQERIA SIGURACIONI SHQIPTAR SHA. (SIGAL SHA.) PER FAZEN E DYTE TE ZMADHIMIT E KAPITALIT

Emertimi i shoqerise:	SIGURACIONI SHQIPTAR SHA. (SIGAL SHA.)
Vendimi i Regjistrimit ne Regjistrin Tregtar:	Vendimi nr. 20863, date 22.02.1999 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane
Adresa e Selise:	Bulevardi Zogu I, Pallati i Diplomateve, nr. 57, Tirane
Kapitali i Shoqerise ne fund te Fazes se Pare te Zmadhimit:	Leke **113.636.363** (nje qind e trembedhjete milion e gjashteqind e tridhjete e gjashte mije e treqind gjashtedhjete e tre).
Shuma e Zmadhimit te Kapitalit:	Leke **161.008.637** (njeqind e gjashtedhjete e nje milione e tetemije e gjashteqind e tridhjete e shtate)
Kapitali pas Zmadhimit te Fzes se Dyte:	Leke **274.645.000** (dyqind e shtatedhjete e kater milion e gjashteqind e dyzet e pese mije)
Menyra e Zmadhimit te Kapitalit:	Zmadhimi realizohet nepermjet emetimt te **53.670** (pesedhjete e tre mije e gjashteqind e shtatedhjete) aksioneve te reja me vlere nominale Leke **3.000** (tre mije) secili, Aksionet do te shlyhen nepermjet perfshirjes se primit te emetimit te aksioneve te emetuara nga Shoqeria ne Fazen e Pare te zmadhimit te kapitalit, sipas vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve te Shoqerise e mbajtur ne date 9 Tetor 2003

Ky dokument evidenton dhe verteton numrin e aksioneve te emetuara nga Shoqeria per zmadhimin e kapitalit dhe te nenshkruara nga secili aksionar e shoqerise si vijon:

AKSIONARET NENSHKRUES DHE NUMRI I AKSIONEVE QE NENSHKRUAN SECILI:

SHYQYRI DURAKU, shtetas shqiptar, lindur ne Kukes me 08.12.1954, mbajtes i pasaportes nr. 0608763, banues ne Rrugen Kavajes, nr. 58, Tirane, nenshkruan **14.168 (katermbedhjete mije e njeqind e gjashtedhjete e tete)** aksione te reja:

Nenshkrimi: Shyqyri Duraku
Data e nenshkrimit: 9 Tetor 2003

1) LLAZAR ANGJELI, shtetas shqiptar, lindur ne Sarande me 05.02.1940, mbajtes i pasaportes nr. 0085140, banues ne Rrugen e Kavajes, nr. 24, hyrja 2/15, Tirane, nenshkruan **14.168 (katermbedhjete mije e njeqind e gjashtedhjete e tete)** aksione te reja:

Nenshkrimi: Llazar Angjeli
Data e nenshkrimit: 9 Tetor 2003

2) AVNI PONARI, shtetas shqiptar, lindur ne Kukes me 28/04/1955, mbajtes i pasaportes nr. 1556645 banues ne TIRANE, nenshkruan **15.586 (pesembedhjete mije e peseqind e tetedhjete e gjashte)** aksione te reja.

Nenshkrimi: Avni Ponari
Data e nenshkrimit: 9 Tetor 2003

3) EDVIN HOXHAJ, shtetas shqiptar, lindur ne Lushje me 30.04.1966, mbajtes i pasaportes nr. 1247470, banues ne Rrugen Irfan Tomini, P. 4, hyrja C/4, Tirane, nenshkruan **3.306 (tremije e treqind e gjashte)** aksione te reja.

Nenshkrimi:
Data e nenshkrimit: 9 Tetor 2003

4) FONDI SHQIPTARO - AMERIKAN I NDERMARRJEVE, organizate pa-qellim-fitimi e krijuar sipas legjislacionit te Shtetit Delaware, U.S.A, me seli U.S.A., me zyre perfaqesimi ne Green Tower Complex, Kulla II, Kati XII, Tirane, Shqiperi, e perfaqesuar nga Z. Jeffrey T. Griffin ne cilesine e Presidentit & CEO i AAEF, shtetas amerikan, lindur ne Georgia (USA) me 14.06.1944, mbajtes i pasaportes nr. Z8236285, banues ne Tirane, nenshkruan **6.442 (gjashte mije e katerqind e dyzete e dy)** aksione te reja:

FONDI SHQIPTARO AMERIKAN I NDERMARRJEVE TIRANE ALBANIA

Nenshkrimi: _____

Data e nenshkrimit: 9 Tetor 2003

Ky dokument nenshkruhet ne çdo faqe nga Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise

Tirane, me 9 Tetor 2003

Avni Ponari
Drejtor i Pergjithshem
SIGAL SHA.

SIGURACIONI SHQIPTAR
ALBANIAN INSURANCE
DREJTORIA E PERGJITHSHME
HEAD OFFICE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr.Rep. 5870
Nr. Kol. 1770

VERTETIM

Une, MIMOZA I. SADUSHAJ, Anetare e Dhomes se Notereve te Tiranes, me zyre Rruga Durresi, Pal.11, vertetoj se sot me date 09.10.2003 u paraqiten para meje personat e mesiperm, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, te njohur prej meje nga dokumenti I identifikimit, te cilet nenshkruan dokumentin sa me siper ne pranine time dhe Une, Noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ
NOTER
TEL 236 058

SIGAL
ALBANIAN INSURANCE C.O.
Adresa: Bul. "Zog I,
Pall. Diplomatëve, nr. 57, Tiranë
Kutia Postare 2387,
Tel/Fax: 04 250220/ 04 233308
Tel: 04 253407 / 042 253408
E-mail: info@sigal.com.al.

VENDIM

I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME
TE AKSIONAREVE TE
SHOQERISE SIGAL ,SIGURACIONI SHQIPTAR SHA

SIGURACIONI SHQIPTAR
ALBANIAN INSURANCE
E PERGJITHSHME
HEAD OFFICE

Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SHA (SIGAL SHA.) ("Shoqeria"), u mblodh ne date 30 Shtator 2003 ne seline e Shoqerise.

Ne mbledhje ishin te pranishem aksionaret, ne perfaqesimi te gjithe kapitalin e Shoqerise si vijon:

- Z. Shyqyri Duraku, qe zoteron 10,000 aksione ose 30% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Llazar Angjeli, qe zoteron 10,000 ose 30% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Avni Ponari, qe zoteron 11,000 ose 33% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Edvin Hoxhaj, qe zoteron 2,333 ose 7% te kapitalit te Shoqerise.

Asambleja eshte thirrur rregullisht per te marre ne shqyrtim dhe vendosur mbi çeshtjet e meposhtme te rendit te dites:

1. Miratimit i vleresimit te Shoqerise me koeficentin 6.3 here PBT per vitin 2002.

2. Zmadhimi i kapitalit te Shoqerise ne dy faza dhe pranimi i ofertes se Fondit Shqiptaro-Amerikan te Ndermarrjeve per nenshkrimin dhe shlyerjen e aksioneve te kapitalit te Shoqerise te cilat do te perbejne 12% te kapitalit pas zmadhimit, kundrejt vleres US$ 1.500.000 (nje milion e peseqind mije dollare US).

3. Ndryshime ne Statutin e Shoqerise.

4. Te ndryshme.

REPUBLIKA E SHQIPERISE NOTERI NR. 6982 VERTETIM NENSHKRIMI NOTER KOLI

PULLE TAKSE

Meqenese ne mbledhje eshte arritur kuorumi i kerkuar nga ligji, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve, mori ne shqyrtim çeshtjet ne rend dite dhe mori me unanimitet vendimet e meposhtme.

Pika e pare e rendit te dites

Pasi degjoi raportin e ekspertit kontabel te autorizuar te Shoqerise, Asambleja vendosi te miratoje raportin e vleresimin e Shoqerise me koeficentin 6,3 here PBT per vitin 2002.
Fondi do te marre mbeshtet fillimisht ne raportin e siperpermendur te vleresimit, per te vleresuar hyrjen e tij ne Shoqeri duke nenshkruar dhe shlyer aksionet e reja qe do te emetohen nga Shoqeria sipas kritereve te pikes se dyte te rendit te dites.
Nese nga shqyrtimi i mevonshem nga nje shoqeri nderkombetare auditimi, e cila do te caktohet nga Fondi, do te rezultoje ndonje ndryshim i ketij rezultati financiar per vitin 2002, aksionaret marrin persiper qe te reflektojne çdo ndryshim ne perqindjen e aksioneve qe do te zoteroje Fondi ne kapitalin e Shoqerise.

Pika e dyte e rendit te dites

Ne lidhje me piken e dyte te rendit te dites, Asambleja vendosi te pranoje oferten e Fondit Shqiptaro-Emerikan te Ndermarrjeve e te zmadhoje kapitalin e Shoqerise ne dy faza si me poshte:

Faza e Pare e Zmadhimit te Kapitalit

Ne fazen e pare, Shoqeria do te emetoje nje numer te caktuar aksionesh te reja me vlere nominale Leke 3.000 (tre mije) secili. Numri i aksioneve te reja do te perbeje 12% te kapitalit te Shoqerise pas zmadhimit.
Aksionaret heqin dore nga nenshkrimi i aksioneve te reja qe do te emetohen nga Shoqeria. Keto aksione do te nenshkruhen dhe shlyhen ne te holla nga Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve ("Fondi"), nje organizate pa-qellim-fitimi e krijuar sipas legjislacionit te Delaware, U.S.A, me seli ne Tirane. Fondi do t'i paguaje Shoqerise shumen US$ 1.500.000 (nje milion e peseqind mije dollare US) si vlere per shlyerjen e ketyre aksioneve.
Fondi do te nenshkruaje dhe shlyeje aksionet e reja sipas Marreveshjes se Investimit, qe do te lidhet midis aksionareve e Shoqerise nga njera ane dhe Fondit nga ana tjeter ("Marreveshja e Investimit").

Faza e Dyte e Zmadhimit te Kapitalit

Ne fazen e dyte, Shoqeria do te zmadhoje kapitalin e saj nepermjet emetimit te aksioneve te reja te cilat do te nenshkruhen nga aksionaret (perfshire dhe Fondin) ne raport me numrin e aksioneve qe zoteron secili prej tyre ne kapitalin e Shoqerise. Aksionet e reja te fazes se dyte te zmadhimit te kapitalit do te shlyhen nepermjet perfshirjes se primit te emetimit te aksioneve te fazes se pare te zmadhimit te kapitalit (vlera qe del nga diferenca e midis shumes US$ 1.500.000 qe Fondi i ka paguar

Shoqerise ne fazen e pare dhe vleres nominale te aksioneve te nenshkruara nga Fondi ne fazen e pare te zmadhimit te kapitalit).

Nga ana tjeter aksionaret jane dakort dhe pranojne kushtet e Fondit per shit-blerjen nga ana e aksionareve te aksioneve qe do te zoteroje Fondit ne kapitalin e Shoqerise.
Konkretisht, aksionaret marrin persiper te bleje nga Fondi ne proporcion me aksionet qe ata zoterojne, dhe Fondi merr persiper t'ju shese aksionareve aksionet e nenshkruara dhe te shlyera nga Fondi, brenda pese viteve nga data e nenshkrimit te aksioneve, sipas kushteve te meposhtme:

A. Fondi ka te drejte qe, brenda pese vjeteve nga data e nenshkrimit te aksioneve nga ana e tij, por gjithnje jo perpara se te kene kaluar 2 dy vjet nga kjo date, te kerkoje nga aksionaret qe te blejne aksionet e Fondit kundrejt çmimit te caktuar sipas formules 7,3 here PBT e fundit te vitit fiskal kur vendoset ky ekzekutim, ne kushtet normale te zhvillimit te biznesit. Te drejtes se Fondit per te kerkuar nga aksionaret qe te blejne aksionet e zoteruara nga Fondi i pergjigjet detyrimi i aksionareve per te blere aksionet e Fondit te ofruara per shitje kundrejt çmimit te caktuar si me siper.

B. Aksionaret kane te drejte qe, brenda pese vjete nga data e nenshkrimit te aksioneve nga ana e Fondit, por gjithethsesi jo perpara se te kene kaluar tre vjete nga kjo date, te kerkojne qe te blejne nga Fondi aksionet e Fondit kundrejt çmimit te caktuar sipas formules 9,3 here PBT e fundit te vitit fiskal kur vendoset ky ekzekutim.

Marredhenjet midis Fondit dhe aksionareve te tjere, ne lidhje me shit-blerjen e aksioneve si me siper do te rregullohen nga Marreveshja per Shitjen-Blerjen e Aksioneve, qe do te nenshkruhet midis aksionareve dhe Fondit ("Marreveshja per Shit-Blerjen e Aksioneve").

Gjithashtu, Asambleja vendosi qe Shoqeria paguajne t'i paguaje Fondit per dy vitet e para pas hyrjes se Fondit si aksionar ne Shoqeri, nje shume te barabarte me 9% ne vit mbi shumen US$ 1.500.000 (nje milion e peseqind mije dollare US) ose dividentin qe i takon Fondit sipas numrit te aksioneve qe zoteron nese dividenti eshte me i madh se shuma e mesiperme. Shuma prej 9% do te paguhet ne muajin Janar te viti 2004 dhe do te rillogaritet, nese do jete e nevojshme ne mbyllje te vitit financiar.

Pika e trete e rendit te dites

Asambleja e Aksionareve vendosi te pranoje kushtet e Fondit per pjesemarrjen e tij ne kapitalin e Shoqerise, ne lidhje me ndryshimet qe duhet te behen ne statutin aktual te Shoqerise per sa me poshte:

1. Ndryshime ku te reflektohet perqindja e pjesemarrjes se Fondit ne kapitalin e Shoqerise, numri i aksioneve qe do te zoteroje Fondi dhe menyra e transferimit te tyre sipas Marreveshjes se Shit-Blerjes se Aksioneve.
2. Ndryshime ne dispozitat e statutit, qe rregullojne perberjen e Keshillit Drejtues, ku te parashikohet (i) emerimi i te pakten nje anetari te caktuar nga Fondi; (ii) emerimi dhe shkarkimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres te behet me vendim unanim te Asamblese se Aksionareve, ne te cilen jane te pranishem ose te perfaqesuar

aksionaret qe se bashku zoterojne te gjithe kapitalin e Shoqerise; (iii) marrja me unanimitetin e te gjithe anetareve te Keshillit Mbikqyres e vendimeve ne lidhje me: (a) percaktimin e politikave te investimeve te Shoqerise; (b) emerimin dhe shkarkimin e Drejtorit te Pergjithshem apo stafit tjeter drejtues te Shoqerise; dhe (c) rritjen e fondit te pagave mbi 1% nga ai ekzistues.

3. Ndryshime te dispozitave perkatese te statutit te Shoqerise, ku te parashikohet marrja me unanimitet te Asamblese se Aksionareve te Shoqerise, ne te cilen jane te pranishem apo te perfaqesuar aksionare, qe zoterojne te gjithe kapitalin e Shoqerise, e vendimeve per (i) miratimin e strategjive te zhvillimit afatgjate te Shoqerise, (ii) miratimin e plan-biznesit dhe planit financiar vjetor, (iii) per shperndarjen dhe destinimin e me shume se 30% te dividentit vjetor.

Pika e katert e rendit te dites

Asambleja e Aksionareve vendosi te ngarkoje Ekspertin Kontabel te Autorizuar te Shoqerise, me detyren qe te percaktoje numrin e aksioneve qe duhet te emetoje Shoqeria per te realizuar zmadhimin e kapitalit ne te dyja fazat sipas menyrave te vendosura ne piken e dyte te rendit te dites, si dhe vleren e primit te emetimit qe do te perfshihet per te zmadhuar kapitalin e Shoqerise ne fazen e dyte. Te dhenat e percaktuara nga Eksperti Kontabel i Autorizuar i Shoqerise do te perbejne bazen e transaksionit qe do te realizohet nepermjet Marreveshjes se Investimit dhe Marreveshjes se Shit-Blerjes se Aksioneve, si dhe per realizimin e zmadhimit te kapitalit te Shoqerise ne fazen e dyte.

Asambleja e Aksionareve vendosi te autorizoje Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise dhe i jep atij kompetenca te plota per te nenshkruar Marreveshjen e Investimit ne emer te Shoqerise.

AKSIONARET

Z. Avni Pohari

Z. Llazar Angjeli

Z. Shyqyri Duraku

Z. Edvin Hoxhaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter:Robert Koli
Studio:Rr.Urani Pano,Pallati 11.Katesh
Nr. 6248 Rep
Nr 1091 Kol

Vertetim Noterial

Sot, me daten 01.10.2003(dymijè e tre), diten e Merkure, para meje Robert Koli, noter ne qytetin e Tiranes, me Seli si me siper, u paraqiten personalisht: Z. Shyqyri Duraku, Llazar Angjeli, Avni Ponari, Edvin Hoxhaj, te gjithe madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te njohur personalisht prej meje, te cilet me deklaruan se Vendimine e Asamblese te Jashtezakonshme te Aksionereve te Shoqerise SIGAL, Siguracioni Shqipetar ShA te bashkangjitur e kane marre me vullnet te lire dhe neneshkruan regullisht para meje. Edhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

Noter
Robert Koli

SIGAL
ALBANIAN INSURANCE C.O.
Adresa: Bul. "Zog I,
Pall. Diplomateve, nr. 57, Tirane
Kutia Postare 2387,
Tel./Fax: 04 250220/ 04 233308
Tel: 04 253407 / 042 253408
E-mail: info@sigal.com.al.

VENDIM

I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME
TE AKSIONAREVE TE
SHOQERISE SIGAL ,SIGURACIONI SHQIPTAR SHA

SIGURACIONI SHQIPTAR
ALBANIAN INSURANCE
E PERGJITHSHME
HEAD OFFICE
SIGAL

Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SHA (SIGAL SHA.) ("Shoqeria"), u mblodh ne date 30 [illegible] ne seline e Shoqerise.

Ne mbledhje ishin te pranishem aksionaret, ne perfaqesonin te gjithe kapitalin e Shoqerise si vijon:

- Z. Shyqyri Duraku, qe zoteron 10,000 aksione ose 30% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Llazar Angjeli, qe zoteron 10,000 ose 30% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Avni Ponari, qe zoteron 11,000 ose 33% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Edvin Hoxhaj, qe zoteron 2,333 ose 7% te kapitalit te Shoqerise.

Asambleja eshte thirrur rregullisht per te marre ne shqyrtim dhe vendosur mbi çeshtjet e meposhtme te rendit te dites:

1. Miratimit i vleresimit te Shoqerise me koeficentin 6.3 here PBT per vitin 2002.

2. Zmadhimi i kapitalit te Shoqerise ne dy faza dhe pranimi i ofertes se Fondit Shqiptaro-Amerikan te Ndermarrjeve per nenshkrimin dhe shlyerjen e aksioneve te kapitalit te Shoqerise te cilat do te perbejne 12% te kapitalit pas zmadhimit, kundrejt vleres US$ 1.500.000 (nje milion e peseqind mije dollare US).

3. Ndryshime ne Statutin e Shoqerise.

4. Te ndryshme.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERI
NR. 982
VERTETOHET NENSHKRIMI I
OJ. ALIN
NOTER ROBERT KOLI

PULLA E SHTETIT
100 LEKE
REPUBLIKA E SHQIPERISE

Meqenese ne mbledhje eshte arritur kuorumi i kerkuar nga ligji, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve, mori ne shqyrtim çeshtjet ne rend dite dhe mori me unanimitet vendimet e meposhtme.

Pika e pare e rendit te dites

Pasi degjoi raportin e ekspertit kontabel te autorizuar te Shoqerise, Asambleja vendosi te miratoje raportin e vleresimin e Shoqerise me koeficentin 6,3 here PBT per vitin 2002.
Fondi do te marre mbeshtet fillimisht ne raportin e siperpermendur te vleresimit, per te vleresuar hyrjen e tij ne Shoqeri duke nenshkruar dhe shlyer aksionet e reja qe do te emetohen nga Shoqeria sipas kritereve te pikes se dyte te rendit te dites.
Nese nga shqyrtimi i mevonshem nga nje shoqeri nderkombetare auditimi, e cila do te caktohet nga Fondi, do te rezultoje ndonje ndryshim i ketij rezultati financiar per vitin 2002, aksionaret marrin persiper qe te reflektojne çdo ndryshim ne perqindjen e aksioneve qe do te zoteroje Fondi ne kapitalin e Shoqerise.

Pika e dyte e rendit te dites

Ne lidhje me piken e dyte te rendit te dites, Asambleja vendosi te pranoje oferten e Fondit Shqiptaro-Emerikan te Ndermarrjeve e te zmadhoje kapitalin e Shoqerise ne dy faza si me poshte:

Faza e Pare e Zmadhimit te Kapitalit

Ne fazen e pare, Shoqeria do te emetoje nje numer te caktuar aksionesh te reja me vlere nominale Leke 3.000 (tre mije) secili. Numri i aksioneve te reja do te perbeje 12% te kapitalit te Shoqerise pas zmadhimit.
Aksionaret heqin dore nga nenshkrimi i aksioneve te reja qe do te emetohen nga Shoqeria. Keto aksione do te nenshkruhen dhe shlyhen ne te holla nga Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve ("Fondi"), nje organizate pa-qellim-fitimi e krijuar sipas legjislacionit te Delaware, U.S.A, me seli ne Tirane. Fondi do t'i paguaje Shoqerise shumen US$ 1.500.000 (nje milion e peseqind mije dollare US) si vlere per shlyerjen e ketyre aksioneve.
Fondi do te nenshkruaje dhe shlyeje aksionet e reja sipas Marreveshjes se Investimit, qe do te lidhet midis aksionareve e Shoqerise nga njera ane dhe Fondit nga ana tjeter ("Marreveshja e Investimit").

Faza e Dyte e Zmadhimit te Kapitalit

Ne fazen e dyte, Shoqeria do te zmadhoje kapitalin e saj nepermjet emetimit te aksioneve te reja te cilat do te nenshkruhen nga aksionaret (perfshire dhe Fondin) ne raport me numrin e aksioneve qe zoteron secili prej tyre ne kapitalin e Shoqerise. Aksionet e reja te fazes se dyte te zmadhimit te kapitalit do te shlyhen nepermjet perfshirjes se primit te emetimit te aksioneve te fazes se pare te zmadhimit te kapitalit (vlera qe del nga diferenca e midis shumes US$ 1.500.000 qe Fondi i ka paguar

Shoqerise ne fazen e pare dhe vleres nominale te aksioneve te nenshkruara nga Fondi ne fazen e pare te zmadhimit te kapitalit).

Nga ana tjeter aksionaret jane dakort dhe pranojne kushtet e Fondit per shit-blerjen nga ana e aksionareve te aksioneve qe do te zoteroje Fondit ne kapitalin e Shoqerise.
Konkretisht, aksionaret marrin persiper te bleje nga Fondi ne proporcion me aksionet qe ata zoterojne, dhe Fondi merr persiper t'ju shese aksionareve aksionet e nenshkruara dhe te shlyera nga Fondi, brenda pese viteve nga data e nenshkrimit te aksioneve, sipas kushteve te meposhtme:

A. Fondi ka te drejte qe, brenda pese vjeteve nga data e nenshkrimit te aksioneve nga ana e tij, por gjithnje jo perpara se te kene kaluar 2 dy vjet nga kjo date, te kerkoje nga aksionaret qe te blejne aksionet e Fondit kundrejt çmimit te caktuar sipas formules 7,3 here PBT e fundit te vitit fiskal kur vendoset ky ekzekutim, ne kushtet normale te zhvillimit te biznesit. Te drejtes se Fondit per te kerkuar nga aksionaret qe te blejne aksionet e zoteruara nga Fondi i pergjigjet detyrimi i aksionareve per te blere aksionet e Fondit te ofruara per shitje kundrejt çmimit te caktuar si me siper.

B. Aksionaret kane te drejte qe, brenda pese vjete nga data e nenshkrimit te aksioneve nga ana e Fondit, por gjithethsesi jo perpara se te kene kaluar tre vjete nga kjo date, te kerkojne qe te blejne nga Fondi aksionet e Fondit kundrejt çmimit te caktuar sipas formules 9,3 here PBT e fundit te vitit fiskal kur vendoset ky ekzekutim.

Marredhenjet midis Fondit dhe aksionareve te tjere, ne lidhje me shit-blerjen e aksioneve si me siper do te rregullohen nga Marreveshja per Shitjen-Blerjen e Aksioneve, qe do te nenshkruhet midis aksionareve dhe Fondit ("Marreveshja per Shit-Blerjen e Aksioneve").

Gjithashtu, Asambleja vendosi qe Shoqeria paguajne t'i paguaje Fondit per dy vitet e para pas hyrjes se Fondit si aksionar ne Shoqeri, nje shume te barabarte me 9% ne vit mbi shumen US$ 1.500.000 (nje milion e peseqind mije dollare US) ose dividentin qe i takon Fondit sipas numrit te aksioneve qe zoteron nese dividenti eshte me i madh se shuma e mesiperme. Shuma prej 9% do te paguhet ne muajin Janar te viti 2004 dhe do te rillogaritet, nese do jete e nevojshme ne mbyllje te vitit financiar.

Pika e trete e rendit te dites

Asambleja e Aksionareve vendosi te pranoje kushtet e Fondit per pjesemarrjen e tij ne kapitalin e Shoqerise, ne lidhje me ndryshimet qe duhet te behen ne statutin aktual te Shoqerise per sa me poshte:

1. Ndryshime ku te reflektohet perqindja e pjesemarrjes se Fondit ne kapitalin e Shoqerise, numri i aksioneve qe do te zoteroje Fondi dhe menyra e transferimit te tyre sipas Marreveshjes se Shit-Blerjes se Aksioneve.
2. Ndryshime ne dispozitat e statutit, qe rregullojne perberjen e Keshillit Drejtues, ku te parashikohet (i) emerimi i te pakten nje anetari te caktuar nga Fondi; (ii) emerimi dhe shkarkimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres te behet me vendim unanim te Asamblese se Aksionareve, ne te cilen jane te pranishem ose te perfaqesuar

aksionaret qe se bashku zoterojne te gjithe kapitalin e Shoqerise; (iii) marrja me unanimitetin e te gjithe anetareve te Keshillit Mbikqyres e vendimeve ne lidhje me: (a) percaktimin e politikave te investimeve te Shoqerise; (b) emerimin dhe shkarkimin e Drejtorit te Pergjithshem apo stafit tjeter drejtues te Shoqerise; dhe (c) rritjen e fondit te pagave mbi 1% nga ai ekzistues.

3. Ndryshime te dispozitave perkatese te statutit te Shoqerise, ku te parashikohet marrja me unanimitet te Asamblese se Aksionareve te Shoqerise, ne te cilen jane te pranishem apo te perfaqesuar aksionare, qe zoterojne te gjithe kapitalin e Shoqerise, e vendimeve per (i) miratimin e strategjive te zhvillimit afatgjate te Shoqerise, (ii) miratimin e plan-biznesit dhe planit financiar vjetor, (iii) per shperndarjen dhe destinimin e me shume se 30% te dividentit vjetor.

Pika e katert e rendit te dites

Asambleja e Aksionareve vendosi te ngarkoje Ekspertin Kontabel te Autorizuar te Shoqerise, me detyren qe te percaktoje numrin e aksioneve qe duhet te emetoje Shoqeria per te realizuar zmadhimin e kapitalit ne te dyja fazat sipas menyrave te vendosura ne piken e dyte te rendit te dites, si dhe vleren e primit te emetimit qe do te perfshihet per te zmadhuar kapitalin e Shoqerise ne fazen e dyte. Te dhenat e percaktuara nga Eksperti Kontabel i Autorizuar i Shoqerise do te perbejne bazen e transaksionit qe do te realizohet nepermjet Marreveshjes se Investimit dhe Marreveshjes se Shit-Blerjes se Aksioneve, si dhe per realizimin e zmadhimit te kapitalit te Shoqerise ne fazen e dyte.

Asambleja e Aksionareve vendosi te autorizoje Drejtorin e Pergjithshem te Shoqerise dhe i jep atij kompetenca te plota per te nenshkruar Marreveshjen e Investimit ne emer te Shoqerise.

AKSIONARET

Z. Avni Ponari

Z. Llazar Angjeli

Z. Shyqyri Duraku

Z. Edvin Hoxhaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter:Robert Koli
Studio:Rr.Urani Pano,Pallati 11.Katesh
Nr. 6248 Rep
Nr 1091 Kol

Vertetim Noterial

Sot, me daten 01.10.2003(dymijè e tre), diten e Merkure, para meje Robert Koli, noter ne qytetin e Tiranes, me Seli si me siper, u paraqiten personalisht: Z. Shyqyri Duraku, Llazar Angjeli, Avni Ponari, Edvin Hoxhaj, te gjithe madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te njohur personalisht prej meje, te cilet me deklaruan se Vendimine e Asamblese te Jashtezakonshme te Aksionereve te Shoqerise SIGAL, Siguracioni Shqipetar ShA te bashkangjitur e kane marre me vullnet te lire dhe neneshkruan regullisht para meje. Edhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

Noter
Robert Koli

VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE AKSIONAREVE TE SHOQERISE SIGURACIONI SHQIPTAR SHA (SIGAL SHA.)

Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR, SHA (SIGAL SHA.) ("Shoqeria"), u mblodh ne date 9 Tetor 2003, ne adresen: "Green Park Complex", Kulla 2, Kati i XII, Tirane, Shqiperi .

Ne mbledhje ishin te pranishem aksioneret qe perfaqesonin te gjithe kapitalin e Shoqerise si vijon:

- Z. Shyqyri Duraku, qe zoteron 10.000 aksione ose 30% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Llazar Angjeli, qe zoteron 10.000 aksione ose 30% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Avni Ponari, qe zoteron 11.000 aksione ose 33% te kapitalit te Shoqerise;
- Z. Edvin Hoxhaj, qe zoteron 2.333 aksione ose 7% te kapitalit te Shoqerise.

Asambleja eshte thirrur rregullisht per te marre ne shqyrtim dhe vendosur mbi çeshtjet e meposhtme te rendit te dites:

1. Zmadhimi i kapitalit te Shoqerise ne dy faza:
   a) Ne Fazen e Pare, nepermjet emetimit te 4.546 aksioneve te reja me vlere nominale Leke 3.000 (tre mije) secili, te cilat do te nenshkruhen te gjitha nga Fondi Shqiptaro -Amerikan i Ndermarrjeve dhe do te shlyhen prej tij duke i paguar shoqerise shumen US$ 1.500.000 (nje milion e peseqind mije dollare US).
   b) Ne Fazen e Dyte, nepermjet emetimit te 53.670 aksioneve te reja me vlere nominale Leke 3.000 (tre mije) secili, te cilat do te nenshkruhen nga aksionaret e Shoqerise, duke perfshire edhe Fondin, ne raport me numrin e aksioneve qe zoteron secili pas zmadhimit te kapitalit ne fazen e pare. Aksionet e reja te emetuara nga Shoqeria ne Fazen e Dyte do te shlyhen nepermjet perfshirjes se primit te emetimit te aksioneve te reja te Fazes se Pare.

2. Ndryshime ne Statutin e Shoqerise.

3. Miratimi i doreheqjes se nje anetari te Keshillit Mbikqyres dhe emerimi i nje anetari te ri.

4. Te ndryshme.

Meqenese ne mbledhje eshte arritur kuorumi i kerkuar nga ligji, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve, mori ne shqyrtim çeshtjet ne rend dite dhe mori me unanimitet vendimet e meposhtme.

Pika e pare e rendit te dites

Ne vijim te mbledhjes se Asamblese se Aksionareve te dates 30 shtator 2003, dhe pasi shqyrtoi raportet e pergatitura dhe te paraqitura ne mbledhje respektivisht nga Drejtori i Shoqerise dhe Eksperti Kontabel i Autorizuar i Shoqerise, Asambleja vendosi te zmadhoje kapitalin e Shoqerise ne dy faza si meposhte:

Shyqyri Duraku

Llazar Angjeli

Bdi. Hoxhaj

(A) Faza e Pare

Ne Fazen e Pare, Shoqeria do te emetoje 4,546 (kater mije e peseqind e dyzet e gjashte) aksione te reja me vlere nominale Leke 3.000 (tremije) secili. Aksionaret ekzistues te Shoqerise heqin dore shprehimisht nepermjet nenshkrimit te ketij vendimi, nga e drejta e perparesise ne nenshkrimin e ketyre aksioneve te reja.
Aksionaret jane unanimisht dakort dhe i njohin Fondit Shqiptaro-Amerikan te Ndermarrjeve, organizate pa-qellim-fitimi, e krijuar sipas legjislacionit te Shtetit Delaware, U.S.A. me seli ne USA, dhe me perfaqesi ne Tirane, Shqiperi (me poshte i quajtur "Fondi"), te drejten per te nenshkruar dhe shlyer te gjitha aksionet e reja te emetuara nga Shoqeria ne Fazen e Pare.

Fondi do te shlyeje me te holla ne dore aksionet e reja e te nenshkruara prej tij, duke i paguar Shoqerise çmimin e pergjithshem ne shumen US$ 1.500.000 (nje milione e peseqind mije dollare US).

Nenshkrimi i aksioneve te reja nga ana e Fondit do te realizohet nepermjet nenshkrimit te Marreveshjes se Investimit dhe Marreveshjes se Shit-Blerjes se Aksioneve, qe do te lidhen midis Fondit, te gjithe aksionareve ekzistues te Shoqerise dhe vete Shoqerise. Shlyerja e aksioneve te Faze se Pare do te evidentohet nepermjet dokumentit bankar qe verteton transferimin e shumen US$ 1.500.000 (nje milione e peseqind mije dollare US) ne llogarine bankare te Shoqerise nga ana e Shoqerise.

Me pagimin nga Fondi ne favor te Shoqerise te çmimit te siperpermendur qe i korrespondon shumes Leke 174.645.000 (trembedhjete milion e gjashteqind e tridhjete e gjashte mije e gjashteqind e tridhjete e gjashte), sipas kursit te kembimit te dates 03 Tetor 2003 te marre nga Alfa Bank, kapitali i Shoqerise behet nga Leke 100.000.000 (njeqind million leke) ne Leke 113.636.363 (nje qind e trembedhjete milion e gjashteqind e tridhjete e gjashte mije e treqind e gjashtedhjete e tre) i ndare ne 37,879 (tridhjete e shtate mije e tetqind e shtatedhjete e tete) aksione me vlere nominale Leke 3.000 (tremije) secili. Kapitali i Shoqerise pas zmadhimit do te zoterohet nga aksionaret ne raportet e meposhte:

- Avni Ponari, 11,000 ose 29.04 % te kapitalit
- Shyqyri Duraku, 10,000 aksione ose 26.40% te kapitalit
- Llazar Angjeli, 10,000 ose 26.40% te kapitalit
- Edvin Hoxhaj, 2,333 ose 6.16% te kapitalit
- Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve, 4546 aksione ose 12% te kapitalit.

(B) Faza e Dyte

Ne Fazen e Dyte, menjehere pas shlyerjes se aksioneve te Fazes se Pare nga Fondi, Shoqeria do te emetoje 53,670 (pesedhjete e tremije e gjashteqind e shtatedhjete) aksione te reja me vlere nominale Leke 3.000 (tremije) secili. Aksionet e reja te emetuara nga Shoqeria ne Fazen e Dyte do te nenshkruhen nga te gjitha aksionaret e Shoqerise, duke perfshire edhe Fondin, ne raport me numrin e aksioneve qe zoteron secili pas zmadhimit te kapitalit ne Fazen e Pare.

Shyqyri Duraku Llazar Angjeli Edvin Hoxhaj

Asambleja vendosi qe aksionet e reja te emetuara nga Shoqeria ne Fazen e Dyte do te shlyhen nepermjet perfshirjes se primit te emetimit te aksioneve te reja te Fazes se Pare. Sipas raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar te Shoqerise vlera e primit te emetimit te aksioneve te emetuara nga Shoqeria ne Fazen e Pare eshte Leke 161,008,636.36 (Njeqindegjashtedhjeteenje mije e tetemije e gjashteqindetridhjeteegjashte pike tridhjete e gjashte).

Si rrjedhoje, emetimit te aksioneve te reja ne Fazen e Dyte dhe shlyerjes se tyre nepermjet perfshirjes se primit te emetimit te aksioneve te emetuara nga Shoqeria ne Fazen se Pare, kapitali i Shoqerise zmadhohet nga Leke 113.636.363.64 (njeqind e trembedhjete million e gjashteqind e tridhjete e gjashte mije e gjashteqind e tridhjete e gjashte) ne Leke 274.645.000 (dyqind e shtatedhjete e kater milion e gjashteqind e dyzet e pese mije), dhe ndahet ne 53,670 aksione me vlere nominale Leke 3.000 (tremije) secili. Kapitali i Shoqerise pas zmadhimit ne Fazen e Dyte do te zoterohet nga aksionaret ne raportet e meposhte:

- Avni Ponari, 26,586 ose 29.04% te kapitalit
- Shyqyri Duraku, 24,168 aksione ose 26.40% te kapitalit
- Llazar Angjeli, 24,168 ose 26.40% te kapitalit
- Edvin Hoxhaj, 5,639 ose 6.16% te kapitalit
- Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve, 10,987 aksione ose 12% te kapitalit.

Nenshkrimi i aksioneve te reja te Fazes se Dyte do te evidentohet nepermjet nenshkrimit nga çdo aksionar, perfshire edhe Fondin, te buletinit te nenshkrimit te aksioneve, kurse shlyerja e aksioneve te reja te Fazes se Dyte, do te evidentohet nga akti pergatitur nga Ekspertit Kontabel te Autorizuar i Shoqerise qe i bashkengjitet ketij vendimi.

Gjithashtu, te gjithe aksionaret e Shoqerise jane dakort e per rrjedhoje Asambleja vendos te pranoje kushtet e propozuara nga Fondi si me poshte:

(i) Aksionaret marrin persiper te blejne nga Fondi ne proporcion me aksionet qe ata do te zoterojne ne kapitalin e Shoqerise ne fund te Fazes se Dyte te zmadhimit te kapitalit, dhe Fondi merr persiper t'u shese aksionareve aksionet qe Fondi do te zoteroje ne kapitalin e Shoqerise ne fund te Fazes se Dyte te Zmadhimit te Kapitalit, brenda pese viteve nga data e nenshkrimit te aksioneve, sipas kushteve te meposhtme:

a. Fondi ka te drejte qe, brenda pese vjeteve nga data e nenshkrimit te marreveshjes se investimit, por gjithnje jo perpara se te kene kaluar 2 dy vjet nga kjo date, te kerkoje nga aksionaret qe te blejne aksionet e Fondit kundrejt çmimit te caktuar sipas formules 7,3 here PBT dhe shpenzimeve te jashtezakonshme te fundit te vitit fiskal kur vendoset ky ekzekutim, ne kushtet normale te zhvillimit te biznesit. Te drejtes se Fondit per te kerkuar nga aksionaret qe te blejne aksionet e zoteruara nga Fondi i pergjigjet detyrimi i aksionareve per te blere aksionet e Fondit te ofruara per shitje kundrejt çmimit te caktuar si me siper.

Shyqyri Duraku Llazar Angjeli Edvin Hoxhaj

b. Aksionaret kane te drejte qe, brenda pese vjete nga data e nenshkrimit te aksioneve nga ana e Fondit, por gjithethsesi jo perpara se te kene kaluar tre vjete nga kjo date, te kerkojne qe te blejne nga Fondi aksionet e Fondit kundrejt çmimit te caktuar sipas formules 9,3 here PBT dhe shpenzimeve te jashtezakonshme te fundit te vitit fiskal kur vendoset ky ekzekutim.

(ii) Shoqeria do t'i paguaje Fondit qe nga momenti i nenshkrimit te marreveshjes se investimit deri ne Dhjetor te 2005, nje shume te barabarte me 9% ne vit mbi shumen US$ 1.500.000 (nje milion e peseqind mije dollare US) ose dividentin qe i takon Fondit sipas numrit te aksioneve qe zoteron nese dividenti eshte me i madh se shuma e mesiperme. Shuma prej 9% do te paguhet ne muajin Janar te viti 2004 dhe 2005 ,dhe do te rillogaritet, nese do jete e nevojshme ne mbyllje te vitit financiar.

(iii) Aksionaret nuk do te terheqin 70 % nga shuma e dividentit vjetor qe do te pranohet nga FSHAN-i, qe u takon sipas numrit te aksioneve qe zoterojne dhe do te zoterojne ne kapitalin e Shoqerise. Kjo shume do te depozitohet me qellim qe te krijojne garanci te mjaftueshme per t'i paguar Fondit çmimin e shitjes ose te blerjes se aksioneve te tij sipas nenparagrafeve a. dhe b. te paragrafit (i) me siper.

(iv) Te ndryshoje Statutin e Shoqerise dhe te beje emerimet e kerkuara respektivisht sipas pikes se dyte, te trete te rendit te dites.

(v) Emerimi i nje shoqerie nderkombetare te njohur auditimi pas perfundimit te mandatit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar te Shoqerise.

Pika e dyte e rendit te dites

Ne lidhje me piken e dyte te rendit te dites, Asambleja e Aksionareve vendosi me unanimitet te beje ndryshimet e meposhtme te neneve perkatese te Statutit te Shoqerise.

Neni 6 ndryshohet si vijon:
"Neni 6
Kapitali themeltar i shoqerise eshte Leke 274.645.000 (dyqind e shtatedhjete e kater milion e gjashteqind e dyzet e pese mije).
Kapitali eshte i ndare ne 91.548 (nentedhjete e nje mije e peseqind e dyzet e tete) aksione me vlere nominale Leke 3.000 (tre mije) secili, te nenshkruara dhe shlyera teresisht nga aksionaret.
Aksionaret zoterojne kapitalin themeltar si me poshte:

- Shyqyri Duraku, 24.168 aksione ose 26.40% te kapitalit
- Llazar Angjeli, 24.168 ose 26.40% te kapitalit
- Avni Ponari, 26.586 ose 29.04% te kapitalit
- Edvin Hoxhaj, 5639 ose 6.16% te kapitalit
- Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve, 10.987 aksione ose 12% te kapitalit."

Permbajtja e paragrafi te pare te nenit 11 ndryshohet si me poshte:

Shyqyri Duraku

"Neni 11
Aksionet jane lirisht te transferueshme sipas menyres se parashikuar ne ligj me perjashtim te rasteve te parashikuara ne Marreveshjen per Shit-Blerjen e Aksioneve e lidhur midis Fondit shqiptaro-Amerikan te Ndermarrjeve dhe aksionareve te tjere, me date 9 Tetor 2003, e cila i bashkengjitet statutit si pjese perberese e tij."

Permbajtja e nenit 14 ndryshohet si vijon:

"Neni 14
Shoqeria drejtohet nga Keshilli Mbikqyres i cili perbehet nga 6 [*jo me pak se 3 e jo me shume se 21, me kusht qe numri i anetareve te jete i plotepjestueshem me tre*] anetare.
Dy te tretat e anetareve te Keshillit Mbikqyres emerohen me vendim unanim te Asamblese se Aksionareve ne te cilen jane te pranishem ose te perfaqesuar aksionare qe se bashku zoterojne te gjithe kapitalin e shoqerise.
Kurse, nje e treta e anetareve te Keshillit Mbikqyres zgjidhen nga rradhet e punemarresve te shoqerise sipas dispozitave te parashikuara ne ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".
Te pakten njeri nga anetaret e emeruar nga Asambleja e Aksionareve duhet te percaktohet nga aksionari Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve.

Anetaret e emeruar nga Asambleja e Aksionareve do te qendrojne ne detyre per nje periudhe prej tre vjetesh. Kurse anetaret e zgjedhur do te qendrojne ne detyre per nje periudhe prej ____ [*jo me shume se 6 vjete*].

Anetaret zgjedhin midis tyre Kryetarin dhe Zevendes Kryetartin e Keshillit Mbikqyres.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te riemerohen dhe/ose te rizgjidhen. Anetaret e Keshillit Mbikqyres te emeruar nga Asambleja e Aksionareve mund te shkarkohen ne çdo kohe me vendim unanim te Asamblese se Aksionareve ne te cilen jane te pranishem ose te perfaqesuar aksionare qe se bashku zoterojne te gjithe kapitalin e shoqerise. Kurse anetaret e zgjedhur te Keshillit Mbikqyres mund te shkarkohen sipas menyrave te parashikuara ne ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"."

Pas paragrafit te trete te nenit 18 te Statutit shtohet nje tjeter paragraf me kete permbajtje:
"Keshilli Mbikqyres do te mblidhet çdo muaj

Pas paragrafit te fundit te nenit 19 shtohet nje tjeter paragraf me kete permbajtje:
"Perjashtimisht, Keshilli Mbikqyres do te marre me unanimitet te anetareve te pranishem me kusht qe ne mbledhje jene te pranishen ose te perfaqesuar te gjithe anetaret e Keshillit Mbikqyres, vendimet e meposhme:

a. vendime ne lidhje me investimet e shoqerise.
b. vendime per emerimin dhe shkarkimin e Drejtorit te Pergjithshem apo stafit tjeter drejtues te shoqerise.
c. vendime per rritjen e fondit te pagave mbi 10% nga ai ekzistues."
d. shitjen e aseteve te Shoqerise apo blerjen e aseteve nga shoqeri te tjera

Llazar Angeli

Ne nenin 38 hiqet pika e pare, e dyte, e katert dhe e peste e paragrafit te dyte dhe pas paragrafit te fundit te ketij neni shtohet nje tjeter paragraf me kete permbajtje:
"Perjashtimisht, vendimet (i) per miratimin e strategjive te zhvillimit afatgjete te shoqerise, (ii) per miratimin e plan-biznesit dhe planit financiar vjetor te shoqerise, (iii) per percaktimin e shumes se dividentit dhe shperndarjen dhe destinimin e me shume se 30% te dividentit vjetor dhe (iv) per emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres; merren me unanimitet ne mbledhje ne te cilen jane te pranishem ose te perfaqesuar aksionare qe se bashku zoterojne te gjithe kapitalin e shoqerise."

Ne fund te nenit 39 shtohet nje tjeter paragraf me kete permbajtje:
"Perjashtimitsht vendimet per prishjen, likujdimin, bashkimin apo ndarjen e shoqerise merren me unanimitet ne mbledhje ne te cilen jane te pranishem ose te perfaqesuar aksionare qe se bashku zoterojne te gjithe kapitalin e shoqerise."

Pika e trete rendit te dites

Ne lidhje me piken e trete te rendit te dites, Asambleja e Aksionareve vendosi te miratoje doreheqjen e Z. [illegible] nga datyra e anetarit te Keshillit Mbikqyres dhe emeron ne kete detyre:
- Z. Jeffrey T. Griffin, shtetas amerikan, lindur ne Georgia (USA) me 14.06.1944, mbajtes i pasaportes nr. 710333338, banues ne Tirane (anetar i percaktuar nga Fondi);

Pika e katert e rendit te dites

Asambleja e Aksionareve vendosi me unanimitet qe te ngarkoje Drejtorin e Shoqerise dhe t'i jape kompetenca te plota per te pergatitur, nenshkruar dhe zbatuar, Marreveshjen e Investimit dhe çdo dokument tjeter qe nevojitet per te realizuar zmadhimin e kapitalit te shoqerise ne te dyja fazat, si dhe per te regjistruar sa me siper ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

AKSIONARET

SIGURACIONI SHQIPTAR

Z. Arvi Ponari

Z. Llazar Angjeli

Z. Shyqyri Duraku

Z. Edvin Hoxhaj

NOTERI
TEL. 236-958

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr.Rep. 581
Nr. Kol. 1231

VERTETIM

Une, MIMOZA I. SADUSHAJ, Anetare e Dhomes se Notereve te Tiranes, me zyre Rruga Durresi, Pal.11, vertetoj se sot me date 08.10.2022 u paraqiten para meje personat e mesiperm, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, te njohur prej meje nga dokumenti I identifikimit, te cilet nenshkruan dokumentin sa me siper ne pranine time dhe Une, Noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ
NOTER
TEL 234-959

RAPORT

DEKLARATE E DREJTORIT TE PERGJITHSHEM

Te nderuar Zoterinj:

Une i nenshkruari, Avni Ponari, ne cilesine e Drejtorit te Pergjitshem te shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SHA. (SIGAL SHA.), shoqeri anonime e krijuar dhe qe ekziston sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, ne lidhje me Marreveshjen e Investimit ("Marreveshje e Investimit") qe lidhet midis:

FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TE NDERMARRJEVE ("Fondi"), organizate jofitimprurese e themeluar sipas legjjislacionit te shtetit te Delaware, SHBA, shoqerise SIGAL SHA. dhe aksionareve te saj Z. Avni Ponari , Z. Llazar Angjeli, Z. Shyqyri Duraku dhe Z. Edvin Hoxhaj, per shumen ne US$ 1.500.000 (nje milion e peseqind mije dollare US), me date 9 Tetor 2003.

Deklaroj dhe konfirmoj sa me poshte:

SIGAL SHA. eshte nje shoqeri anonime e krijuar rregullisht dhe qe ekziston ne perputhje te plote me legjislacionin e Republikes se Shqiperise dhe eshte licencuar rregullisht per te zhvilluar aktivitetin e saj ne fushen e sigurimeve dhe risigurimeve ne menyren qe ajo e zhvillon aktualisht kete aktivitet.

SIGAL SHA. gezon zotesi te plote juridike per te vepruar mbi pronat e saj dhe te zhvilloje aktivitetin e saj ekonomik ashtu si e zhvillon ate aktualisht. SIGAL SHA. eshte autorizuar rregullisht nga Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te dates 9 Tetor 2003, qe te nenshkruaje, zbatoje dhe permbushe Marreveshjen e Investimit.

Nenshkrimi nga SIGAL SHA. i Marreveshjes se Investimit dhe permbushja nga SIGAL SHA. e detyrimeve qe rrjedhin per te direkt dhe/ose indirekt nga Marreveshja e Investmit, eshte autorizuar rregullisht sipas te gjitha kerkesave ligjore dhe nuk vjen ne kundershtim me ndonje dispozite ligjore ose nenligjore ne Republiken e Shqiperise, me Dokumentet Ligjore te SIGAL SHA., ose me ndonje marreveshje detyruese, marreveshjeje apo çdo lloj instrumenti tjeter ne te cilen SIGAL SHA. apo ndonje nga aksionaret e saj eshte pale, si dhe nuk perben mospermbushje ne ndonje menyre ne lidhje me ndonje dispozite te ketyre marreveshjeve.

Aksionet e reja qe jane emetuar dhe/ose qe do te emetohen ne favor te Fondit nga SIGAL SHA. ne perputhje me kushtet dhe afatet e kesaj Marreveshje, jane dhe/ose do te jene rregullisht dhe vlefshmerisht te emetuara dhe nuk jane dhe/ose nuk do te jene objekt i te drejtes se perparesise se nenshkrimit ose i ndonje te drejte tjeter te aksionareve te SIGAL SHA., e cila rrjedh nga ligji apo Statuti i Shoqerise, si dhe jane dhe/ose do te jene te lira nga çdo barre siguruese, peng, barre tjeter kufizuese, apo çdo e drejte tjeter ne favor te aksionareve apo ndonje te treti.

Nuk ka asnje person fizik ose juridik qe posedon, ose te cileve tu njihet nga aksionaret e SIGAL SHA., e drejta per te poseduar aksione te Kapitalit te SIGAL SHA. dhe nuk eshte e autorizuar e nuk ekziston aktualisht asnje marreveshje, garanci, premtim per shit-blerje te

aksioneve te kapitalit te SIGAL SHA., marreveshje per konvertimin e borxheve ne aksione ose ne ndonje te drejte tjeter (indirekt ose ndryshe). Perveç rasteve te percaktuara ne kete Marreveshje, aksionaret dhe/ose SIGAL SHA. nuk kane detyrime (indirekte ose ndryshe) per te emetuar, blere, shitur, apo te disponojne ne çdo menyre tjeter aksione apo te drejtave mbi to ose te paguaje divident ose ta shperndaje ne ndonje menyre tjeter.

Nuk ekziston asnje marreveshje tjeter ne te cilen SIGAL SHA. apo ndonjeri nga aksioaret e saj te jete pale, e cila vjen ne kundershtim me Marreveshjen e Investimit.

Marreveshja e Investimit e nenshkruar perben per SIGAL SHA. dhe aksionaret e saj, nje detyrim ligjor, te vlefshem dhe te ekzekutueshem ne perputhje me kushtet e saj.

Date 9 Tetor 2003

Me respekt,

Z. Avni Ponari
Drejtor i Pergjithshem
SIGAL SHA.

NOTERI
TEL • 234-959

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 1874 Rep.
Nr 1274 kol.

VERTETIM

Sot me date 09.10.2003 (dymije e tre) para meje noteres MIMOZA SADUSHAJ, notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " DURRESIT ", u paraqit personalisht deklaruesi i mesiperm, per identitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti i tij, me zotesi te plote per te vepruar, i cili nenshkroi rregullisht para meje deklaraten e mesiperme te perpiluar jashte kesaj zyre dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ
NOTER
TEL 234-959

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 5876 **Rep.**
Nr. 1276 **Kol.**

DEKLARATE

- Per Doreheqje nga Detyra e Anetarit te Keshillit Mbikqyres -

Ne Tirane, sot, me 9 Tetor 2003, perpara meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqit personalisht Z. Dashamir Kore, shtetas shqiptar, lindur ne Gjirokaster me 17/10/53, mbajtes i pasaportes me nr. 055 4643, person madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili me vullnetin e tij te lire e te plote deklaroi sa me poshte:

"Une i nenshkruari Dashamir Kore deklaroj se, jap dorehqjen nga detyra e anetarit te Keshillit Mbikqyres te shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SHA. (SIGAL) SHA., shoqeri anonime e krijuar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 20863, date 22.02.1999 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, me seli ne Blv.Zogu I, Pallati i Diplomateve.
Gjithashtu deklaroj se shoqeria SIGAL SHA. nuk ka asnje detyrim apo pergjegjes financiare apo e çfaredo lloji kundrejt meje, qe rrjedh direkt apo indirekt per shkak te ushtrimit te funksionit tim ne detyren e anetarit te Keshillit Mbikqyres."

Une Noteri redaktoj kete deklarate te cilen Z. Dashamir Kore e nenshkruan rregullisht pasi bindet qe teksti i saj eshte ne perputhje te plote me theniet e tij, dhe une Noteri vertetoj kete deklarate sipas ligjit shqiptar, nepermjet vules dhe nenshkrimit tim.

DEKLARUESI **NOTERI**

Dashamir Kore
Z.

Mimoza Sadushi

Eksperti Kontabël i Autorizuar
Jorgji BOLLANO Nr.License 2 Dt.10.02.2000

RAPORT

Për përcaktimin e numrit të aksioneve që duhet të emetojë SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A (SIGAL) në të dyja fazat e zmadhimit të kapitalit si dhe vlerën e primit të emetimit, që do të përfshihet për të zmadhuar kapitalin e shoqërisë në fazën e dytë.

Mbështetur në Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë SIGAL, SIGURACIONI SHQIPTAR Sh.a. të datës 30 Shtator 2003 pika e katërt e rendit të ditës mora përsipër detyrën që të përcaktoj numrin e aksioneve që duhet të emetojë shoqëria për të realizuar zmadhimin e kapitalit në të dyja fazat sipas mënyrave të vendosura në pikën e dytë të rendit të ditës si dhe vlerën e primit të emetimit që do të përfshihet për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë në fazën e dytë.

Mbështetur në Ligjin Nr.7638, datë 19.11.1992 " Për Shoqëritë Tregtare ", në Ligjin Nr.7661, datë 19.01.1993 " Për Kontabilitetin" dhe në standartet e auditimit po paraqes fillimisht llogaritjet e bëra për përcaktimin e objektivave të mësipërme dhe pastaj përfundimet përkatëse.

Aktualisht Shoqëria ka një kapital themeltar 100.000.000 lekë të ndarë në 33.333 aksione.

Për pjesëmarrje në Shoqëri të Fondit Shqiptaro - Amerikan në masën 12% të kapitalit pas zmadhimit të kapitalit në fazën e parë duhet të bëhet :

88 %	100.000.000,00 lekë
100%	113.636.363,64 lekë

Rritja e kapitalit në fazën e parë do të bëhet për 13.636.364 lekë. Numri i aksioneve gjithsej pas zmadhimit të kapitalit duke e marrë vlerën e një aksioni 3.000 (tremijë) lekë është :

113.636.363,64 lekë / 3.000 lekë = 37.879 aksione

Aksionet e reja
37.879 - 33.333 = 4.546 njësi

Kapitali i zmadhuar në fazën e parë prej 113.636.363,64 lekë ndahet :

Avni PONARI	zotëron	11.000 aksione ose	29.04% të kapitalit të shoqërisë
Shyqyri DURAKU	zotëron	10.000 aksione ose	26.40% të kapitalit të shoqërisë
Llazar ANGJELI	zotëron	10.000 aksione ose	26.40% të kapitalit të shoqërisë
Edvin HOXHAJ	zotëron	2.333 aksione ose	6.16% të kapitalit të shoqërisë
F SH A N	zotëron	4.546 aksione ose	12.00% të kapitalit të shoqërisë
		37.879	100.00 %

Rritja e kapitalit në fazën e pare është :

113.636.363,64 - 100.000.000 = 13.636.363.64 lekë

E llogaritur në dollarë

Ex rate 116.43 (usd / lekë)

13.636.363,64 lekë / 116.43 (usd/lekë) = 117.120,70 USD

Primi i mbetur për fazën e dytë:

1.500.000,00 – 117.120,70 = 1.382.879,30 USD

1.382.879,30 x 116.43(lekë/usd) = 161.008.636.36 lekë

për aksionet e reja të fazës së dytë :

161.008.636.36 / 3000 = 53.670 aksione të reja

që duhet të emetohen në fazën e dytë.

Kapitali i zmadhuar në fazën e dytë do të jetë:

Kapitali i zmadhuar në fazën e parë 113.636.363.64 lekë

Shtesa në fazën e dytë	161.008.636.36 lekë
Totali	274.645.000 lekë

Aksionet në fazën e dytë pas zmadhimit të kapitalit do të jenë:

Aksionet e fazës së parë	37.879 njësi
Aksionet shtesë të fazës së dytë	53.670 njësi
Totali	91.548 njësi

ose për efekt kontrolli

Kapitali i zmadhuar	274.645.000,00
Vlera e një aksioni	3.000
Numri i aksioneve	91.548

Struktura do të jetë si më poshtë:

Avni PONARI	zotëron	26.586 aksione ose	29.04% të kapitalit të shoqërisë
Shyqyri DURAKU	zotëron	24.168 aksione ose	26.40% të kapitalit të shoqërisë
Llazar ANGJELI	zotëron	24.168 aksione ose	26.40% të kapitalit të shoqërisë
Edvin HOXHAJ	zotëron	5.639 aksione ose	6.16% të kapitalit të shoqërisë
F SH A N	zotëron	10.987 aksione ose	12.00% të kapitalit të shoqërisë
Totali		91.548	100,00 %

Përfundimisht shprehemi se:

-Shoqëria duhet të emetojë 58.215 aksione të reja për të dy fazat të ndara

- për fazën e parë 4.545 aksione
- për fazën e dytë 53.670 aksione

-Primi që do të përfshihet për të zmadhuar kapitalin e shoqërisë në fazën e dytë

- Primi në usd 1.382.879,30
- Primi në lekë 161.008.636,36.

Eksperti Kontabël i Autorizuar
Prof.Dr. Jorgji BOLLANO

Shënim:
-Llogaritjet për vlerësimin e Shoqërisë me koeficientin 6.3 herë PBT për vitin 2002 nuk janë bërë nga ana ime.
-Kursi i këmbimit të dollarit me 116.43 lekë është marre nga Alpha Bank me kursin e blerjes në datë 03 Tetor 2003

Tiranë, më 30 Tetor 2003

STATUT
I SHOQERISE ANONIME

"SIGURACIONI SHQIPETAR" sh.a
"***SIGAL***" *sh.a.*

NENI 1
FORMA E SHOQERISE

Shoqeria themelohet ne formen e shoqerise anonime pa oferte publike dhe do te funksionoje ne perputhje me dispozitat e ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjes 8081 dt 7.3.1996 "Per veprimtarite e sigurimit dhe te risigurimit ",sipas aktit te themelimit dhe ketij statuti.

NENI 2
EMERTIMI

Emertimi I plote I shoqerise eshte "SIGURACIONI SHQIPETAR" sh.a. dhe emertimi I shkurtuar I saj do te jete
"***SIGAL***" sh.a.

Shoqeria ka stemen dhe vulen e saj zyrtare.

Ne te gjitha aktet e dala nga shoqeria te distinuara per te tretet tregohet emertimi I plote I shoqerise si dhe adresa e selise se saje.

NENEI 3
SELIA DHE RRJETI

Selia e shoqerise eshte ne Qendren "VEVE", Tirane.
Shoqeria ka rrjetin e saje ne territorin e Republikes se Shqiperise, qe do te perbehet nga dege dhe zyra te sherbimeve qe do te ofroje shoqeria ne perputhje me objektin e veprimtarise se saje.

NENI 4
KOHEZGJATJA

Shoqeria themelohet per te ushtruar veprimtari ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me kete statut per nje afat kohore te pacaktuar.

NENI 5

OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saje sigurimin ndaj demeve dhe risigurimet , ne perputhje me ligjen nr 8081 dt 7.3.1996 " Per veprimtarite e sigurimit dhe te risigurimit" si dhe cdo objekt tjeter te lejuar nga legjislacioni dhe qe nuk vjen ne kundershtim me aktet ligjore dhe nenligjore ne fushen e sigurimeve.

Shoqeria nuk do te ushtroje veprimtari ne lidhje me sigurimin e jetes.

KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET

NENI 6

Kapitali themeltare

Kapitali themeltare I shoqerise eshte 30.000.000 (tridhjete milion) lek.

Ai eshte I ndare ne 30.000 (tridhjete mije) aksione nominative te themeluesve te shoqerise te cilet jane te se njejtes kategori me vlere nominale prej 1.000 (njemije) lek per cdo aksion.

Aksionet jane te numeruara nga nje deri ne 30.000 perfshire numerin e fundit te aksionit. Perberja e kapitalit themeltare te shoqerise eshte si me poshte:

Emri mbiemri	%	Nr I aksioneve.	Vlera ne leke
1.Shyqyri Duraku	26%	7800	7800000
2-Llazar Angjeli	26%	7800	7800000
3.Avni Ponari	33%	9900	9900000
4.Alessandro Shtylla	15%	4500	4500000

NENI 7

Zmadhimi I kapitalit

Kapitali themeltare I shoqerise mund te zmadhohet sipas modaliteteve dhe menyrave te parashikuara nga nenet 150-163 te ligjes per shoqerite tregtare.

Zmadhimi I kapitalit themeltare mund te kryhet vetem me vendim te Asamblese se jashtezakonshme te aksionerve , ne baze te raportit te Keshillit Mbikqyres, I cili permban treguesit e kerkuar nga ligji.

Aksioneret kane te drejten e perparsise ne nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimine kapitalit. Kjo e drejte eshte perpjestimore me shumen e aksioneve te zotruara nga sejcili aksioner perpara zmadhimit te kapitalit.

Aksioneret mund te heqin dore vetem individualishte nga e drejta per nenshkrimin e aksioneve te reja. Ata mundet gjithashtu te kerkojne nenshkrimin e nje numeri me te vogel aksionesh nga sa u takon sipas

parimit te papajtueshmerise, por me kushte qe asambleja te kete vendosur shprehimishte per kete.

NENI 8
Zvoglimi I kapitalit themeltare.

Zvoglimi I kapitalit themeltare te shoqerise kryhet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Jashtezakonshme te aksionereve dhe ne pajtim me dispozitat e ligjit tregtare.

Zvoglimi I kapitalit themeltare nepermjet riblerjes se aksioneve, ose te shperndarjes se mjeteve rezerve mund te vendoset vetem pasi te jete marre paraprakishte autorizimi I Komisionit Mbikqyres te Sigurimeve.

Shoqeria mund te beje shperndarje kapitali neqofte se sipas legjislacionit ne fuqi, pas shperndarjes se saj do tí mbetet me pak se kapitali minimum I detyrueshem.

NENI 9
Shlyerja e Aksioneve

Aksionet per kapitalin ne para te nenshkruara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit do te shlyhet te pakten 50 % te vleres se tyre qe ne momentin e nenshkrimit.

Pjesa tjeter e vleres do te shlyhet me nje ose disa keste ne baze te kerkimit per shlyerje nga Keshilli I drejtuesve ne nje afat kohor ne perputhje me rregullat e licensimit nga Komisioni I Mbikqyrjes se Sigurimeve.

Asambleja e Pergjithsheme e jashtezakonshme qe vendos zmadhimin e kapitalit, ka te drejte te marre nje vendim per shlyerjen tersore te aksioneve qysh ne momentin e nenshkrimit, ose brenda nje afati me te shkurter nga ai I permendur ne paragrafin e dyte te ketij neni.

Kerkimi I fondeve u njoftohet nenshkruesve te pakten 15 dite perpara dates se caktuar per cdo derdhje, me leter rekomande dhe me kethim pergjigje, drejtuar cdo titullari te aksioneve.

Cdo vonese ne derdhjen e shumave te kerkuara sjell pagimin e interesave perqindjeve ligjore duke filluar nga data e kerkimit te cdo derdhje pa qene nevoja per te proceduar ne formalitete te tjera te cfardoshme dhe pa hequr dore nga veprimet e shoqerise ndaj aksionerit detyrues dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuara nga ligji.

NENI 10
Forma e aksioneve

Aksionet e shoqerise jane te formes nominative.

Pronesia e aksioneve vertetohet nga rregjistrimi I tyre ne emer te pronarit ne rregjistrin e mbajtur per kete qellim nga shoqeria, ne kushtet dhe sipas menyrave te parashikuara nga ligji.Shoqeria I leshon atij nje vertetim te rregjistrimit te aksioneve ne pronsi te tij.

NENI 11
Shitja dhe transferimi I aksioneve

Transferimi I pronsise mbi aksionet nje personi jo aksioner, pavarsishte nga natyra juridike e ketij transferimi, duhet te miratohet nga Keshilli Mbikqyres, ne kushtet dhe sipas procedurave te percaktuara ne ligjen " Per shoqerite tregtare".

Shoqeria ne cdo raste duhet te zbatoje rregullat e percaktuara per kete qellim ne ligjen " Per veprimtarite e sigurimeve dhe risigurimeve" dhe aktet e tjra ligjore dhe nenligjore.

NENI 12
Pandashmeria e aksioneve

Aksionet jane te pandashme perkundrejte shoqerise.

Bashkepronaret e aksioneve jane te detyruar te paraqiten para shoqerise , nga njeri prej tyre, I konsideruar si pronar I vetem, ose nga nje perfaqsues I vetem I zgjedhur nga bashkpronaret. Ne rast mosmarrveshje perfaqsuesi mund te caktohet nga gjykata me kerkesen e bashkepronarit qe e merr I pari kete nisme.

NENI 13
Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet

Cdo aksion jep te drejten e pjesmarrjes ne fitimet e shperndashme vjetore te shoqerise dhe ne tepricen e aktivit te mbetur ne rastin e nje likujdimi, ne nje pjese perpjestimore me kuoten e kapitalit qe perfaqeson aksioni.

Pervec kesaj ai jep te drejten e votes dhe te perfaqsimit ne asamblete e pergjithshme ne kushtet ligjore dhe statutore.
Aksionet jane pergjegjes per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve dhe per humbjet e saj deri ne masen e shumes nominale te aksioneve qe zoterojne.

Cdo kerkim I fondeve pertej kesaj shume eshte I ndaluar.

Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionin e ndjekin kete aksion ne cfardo dore qe kalon.

Pronsia e nje aksioni permban automatikishte te drejten e aderimit ne statutin e shoqerise dhe ne vendimet e asamblese se pergjithshme.

DREJTIMI ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI
KESHILLI I MBIKQYRJES

NENI 14
Perberja dhe emerimi

Shoqeria drejtohet nga nje Keshill drejtuesish qe perbehet nga tre antare. Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane:

1.	Shyqyri Duraku	Kryetar
2.	Llazar Angjeli	antar
3.	Besnik Mustafaj	antar
4.	Besnik Shtylla	antar
5.	Spartak Gjini	antar

Antaret e Keshillit Mbikqyres emrohen nga mbledhja e pergjithshme e zakonshme e aksionereve per nje kohe prej dy vjet. Ne emerimin e anetareve te Keshillit Mbikqyres respektohen papajtueshmerit apo ndalesat ligjore.

Funksionet e anetareve te Keshillit mbikqyres perfundojne normalishte ne mbarim te mbledhjes se pergjithshme te aksionereve qe vendos per llogarit e ushtrimit te mbyllur e mbajtur ne vitin gjate te cilit mbaron mandati I tyre.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te rizgjedhshem.

Ata mund te shkarkohen ne cdo kohe nga mbledhja e pergjithshme e zakonshme e aksionereve.

NENI 15
Personi Juridik anetar I Keshillit te drejtueseve

Nje person juridik qe eshte aksioner I shoqerise mund te jete anetar I keshillit mbikqyres. Ne kete raste ky duhet te caktoje, qysh ne castin e zgjedhjes, nje perfaqsues te perhershem person fizik, I cili u nenshtrohet te njejtave kushte dhe detyrime dhe ka te njejtat pergjegjsi civile dhe penale sikur te ishte ai vete antar I keshilllit, duke mos perjashtuar nga pergjegjsia e perbashket personin juridik qe ai perfaqeson.

Neqofte se personi juridik ia heq mandatin peraqsuesit te tij duhet te njoftoj per kete shoqerinmenjehere dhe te beje njekohsishte zevendsimin e

tij.Ky rregull do te zbatohet edhe ne rastet e vdekjes, te doreheqjes ose te pengimeve te zgjatura te perfaqsuesit te perhershem.

NENI 16

Vendet bosh ne Keshillin e Mbikqyrjes

Neqofte se nje ose disa vende ne keshillin mbikqyres mbeten bosh midis dy mbledhjeve te perhershme te aksionerve, si rrjedhoje e vdekjes apo doreheqjes, keshilli mbikqyres mund te beje nje ose disa emerime te perkohshme.

Emerimi I anetarve nga vete keshilli duhet te ratifikohet nga mbledhja e pergjithshme me e afert e aksionerve.Ne rastin kur mbledhja e pergjithshme e aksionerve nuk ratifikon anetaret e emeruar nga keshilli vendimet e marra me pare nga keshilli mbeten gjithmone te vlefshme.

NENI 17

Kryetari I Keshillit

Kryetari I Keshillit Mbikqyres emerohet nga Asambleja e pergjithshme e aksionerve, midis antarve te tij dhe ngarkohet te mbledhe keshillin dhe te drejtoj debatet gjate seancave te tij.

Kryetari I keshillit mbikqyres eshte detyrimishte person fizik dhe nuk mund te zgjidhen ndermjet perfaqsuesve te personave juridik.

Ai I ushtron funksionet e tij gjate tere periudhes se mandatit si anetare te keshillit mbikqyres.

Keshilli mbikqyres mund te emroje gjithashtu nje sekretar qofte edhe jashte antareve te tij, duke caktuar edhe kohzgjatjen e funksioneve te ketij. Kryetari I keshillit dhe sekretari jane te rizgjedhshem.

NENI 18

Mbledhjet e Keshillit te Mbikqyrjs

Keshilli mbikqyres eshte organ kolegjial, pergjgjegjes dhe mbikqyres per shoqerine.Ai ben shqyrtim dhe merr vendime vetem nepermjet mbledhjeve te tij.

Keshilli mbikqyres mblidhet nje here ne tre muaj dhe sa here qe e kerkon interesi I shoqerise. Ai mblidhet gjithashtu ne fund te cdo tre mujori per te degjuar raportin e Drejtorit te Pergjithshem.

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres thirren nga Kryetari dhe ne munges te tij nga anetaret e tjere te keshillit.

Kryetari dhe ne munges te tij njeri nga anetaret, duhet te therras mbledhjen e keshillit brenda 15 diteve, kur nje e treta e anetarve te keshillit I paraqesin atij nje kerkese te arsyetuar per kete.Ne qofte se kerkese nuk I jepet rruge, autoret e saj mund te procedojne vete ne thirrjen e mbledhjes se keshillit mbikqyres duke treguar rendin e dites se mbledhjes.

Mbledhja e keshillit mbikqyres mbahet ne selin e shoqerise ose ne nje vend tjeter te treguar ne thirrje.

Si rregull thirrja e mbledhjes duhet tu dergohet anetarve te keshillit, tre dite perpara me leter, telegram, ose forme tjeter te shkruar komunikimi.

Cdo thirrje, duhet te permbaj ceshtjet kryesore te rendit te dites. Mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga kryetari dhe ne munges te tij nga anetari me moshe me te madhe.

NENI 19
Vendimet e Keshillit Mbikqyres

Keshilli merr vendime te vlefshme kur ne mbledhjen e tij jane te pranishem me shume se gjysma e anetarve ne funksion.

Cdo antar I keshillit, mund ti jap mandat nje antari tjeter per ta perfaqsuar ne mbledhjen e keshillit. Cdo anetar mund te jape vetem nje mandat per te njejten mbledhje. Anetari I perfaqsuar nuk merret parasyshe ne llogaritjen e quorumit te anetarve te pranishem, sic percaktohet ne paragrafin e pare.

Vendimet merren me shumicen e votave te anetarve te pranishem, ose te perfaqsuar.Cdo anetar I keshillit ka vetem nje vote dhe nuk mund te perfaqsoje me shume se nje anetar tjeter.

Megjithate kur keshilli mbikqyres eshte mbledhur per te vendosur mbi nje projekt te shitjes se aksioneve nje te treti jo aksionar, ne kushtet e parashikuara ne nenin 11 te ketij statuti, vendimi I miratimit merret me shumicen e nje te katerteve te votave te anetareve te pranishem, ose te perfaqsuar.Neqofte se shitesi I aksioneve eshte antare I keshillit te drejtuesve ai nuk merr pjese ne votim.

Ne rast votash te barabarta, vendos vota e kryetarit.

NENI 20
Dokumentimi I mbledhjeve dhe I vendimeve

Keshilli mbikqyres mban nje liber te pranise, I cili firmoset nga anetaret pjesmarres ne mbledhje.

Justifikimi I numerit te anetarve ne funksion dhe I emrimit te tyre provohet ne menyre te vlefshme ndaj te treteve, vetem nga tregimi ne procesverbalin e cdo mbledhje te emrave te anetareve te pranishem, te perfaqsuar, ose te munguar.

Shqyrtimet dhe vendimet e keshillit mbikqyres , evidentohen me ane te preocesverbaleve te mbajtura ne nje liber te posacem (protokoll) I numertuar dhe I vulosur, qe mbahet ne selin qendrore te shoqerise ne te cilen tregohen vec te tjerave, antaret e pranishem, te perfaqsuar dhe te munguar, si dhe cdo person tjeter qe ka asistuar ne mbledhjen e keshillit, teresisht ose pjeserisht.

Procesverbalet firmosen nga kryetari I seances dhe te pakten nga nje anetar I keshillit.

NENI 21

Kompetencat e Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres ushtron ato kompetenca te cilat jane te parashikuara ne ligjen 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe ky statut ia kane rezervuar asamblese se pergjithshme te aksionerve, ose drejtorit te pergjithshem.

Aktet dhe operacionet e renditura me poshte, jane ne kompetence vetem te Keshillit Mbikqyres:

1.Miratimi I rregulloreve te brendshme te shoqerise qe percaktojne:

a-Strukturen e organizimit dhe te administrimit te shoqerise, duke perfshire edhe njesite funksionale dhe administrative te saj, pozicionet mbikqyrse dhe mardhenjet raportuese.

b-Detyrat e cdo drejtori departamenti dhe te njesive qe ai drejton dhe mbikqyre.

c-Funksionet e komitetit te kontrollit te brendshem dhe te komiteteve te tjera te brendshme te ngritura nga keshilli I drejtuesve.

2. Miratimi dhe mbikqyrja e zbatimit te politikes se shoqerise per:

a- Llojet, kushtet dhe afatet e policave te sigurimit.

b- kushtet dhe kriteret sipas te cilave shoqeria mund te negocioje me institucione financiare te tjera, vendase apo te huaja, per te marre hua, si dhe kufijte e huamarrjes.

c- Zgjerimin e veprimtarise se shoqerise, produkte te reja brenda kufijve te caktuar ne licensen e leshuar nga Komisioni Mbikqyres I Sigurimeve.

3. Miratimi I numerit te pergjithshem te personelit te shoqerise, I kritereve te marrjes ne pune te personelit teknik, I tabelave te pagave dhe I kritereve per dhenien e shperblimeve suplementare.

4. Pregatitja dhe paraqitja per shqyrtim ne mbledhjen e pergjithshme te aksionereve te gjendjeve financiare vjetore dhe te raportit te veprimtarise.

5. Thirrja e asamblese se pergjithsheme sa here qe kjo eshte e nevojshme dhe ne mbyllje te cdo viti financiar per te miratuar gjendjen financiare vjetore.

NENI 22

Informimi I anetareve te keshillit.

Cdo anetar I Keshillit mbikqyres ka te drejte te kerkoje dhe te marre nga Drejtoria e Pergjithshme e shoqerise, informacion per ceshtje te natyres administrative, teknike dhe financiare, qe I mundesojne atij te verifokoje dhe te gjykoje per kushtet ne te cilat zhvillohet veprimtaria e shoqerise dhe te jete plotesishte I qarte per vendimet qe duhen marre, apo qe do te merren nga ana e keshillit.

Kryetari I keshillit ka pergjegjesine per ti vene anetaret e keshillit ne gjendje qe te marrin informacionet e kerkuara.

Cdo anetar I keshillit mbikqyres duhet te njoftohet personalishte per mbledhjet e keshillit dhe ti vihen ne dispozicion ne selin e shoqerise, apo ti dergohen bashke me thirrjen dokumentet dhe raportet qe do te shqyrtohen ne mbledhje.

shoqeria nuk eshte e detyruar ti jape anetareve te keshillit drejtues kopje te procesverbaleve te vendimeve te keshillit, por cdo anetar mund te kerkoje qe te njihet me to ne selin e saj.

Mosnjohja e te drejtave te cdo anetari te keshillit per informacionet e mesiperme dhe mosthirrja ne mbledhjen e keshillit sjell pavlefshmerin e vendimeve te kshillit.

NENI 23

Pergjegjesite e anetarve te Keshillit Mbikqyres

Anetaret e keshillit mbikqyrs mbajne pergjegjsi civile solidarishte dhe individualisht, sipas rastit ndaj te treteve dhe ndaj shoqerise, per shkeljet e dispozitave ligjore, ose te rregullave te zbatueshme per veprimtarin e shoqerise, per shkelje te statutit, si dhe per gabimet e bera ne administrimin e shoqerise per shkak te vendimeve te tyre.

Pergjegjsia penale e anetarve te keshillit te mbikqyrjes, percaktohet ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi.

NENI 24

Shperblimi I vecante per pjesmarrjen ne Keshill dhe shperblimet e jashtezakonshme.

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mund tu caktoje anetarve te keshillit te mbikqyrjes, si shperblim per pjesmarrjen ne keshill nje shume vjetore fikse e cila mbetet e pandryshuar deri ne nje vendim te kundert te asamblese.

Shuma e shperblimit te caktuar per keshillin shperndahet midis anetarve te tij, nga vete keshilli mbikqyres.

Keshilli mbikqyres mund te caktoje shperblime te jashtezakonshme per anetaret te cileve u ngarkohen misione, apo u jepen mandate per sherbime, apo detyra te caktuara. Shperblimet e vecanta dhe te jashtezakonshme, perballohen nga llogaria e shoqerise dhe kalohen ne shpenzimet e saje.

Drejtori I Pergjithshem dhe drejtuesit teknik.

NENI 25

Drejtori I Pergjithshem

Drejtori I pare I pergjithshem I shoqerise emerohet nga Keshilli Mbikqyres. Si Drejtor I pare emerohet z.Avni Ponari, mandati I funksionit te tije eshte tre vjet.

Drejtori I pergjithshem perfaqeson shoqerine ne mardhenjet me te tretet, me kompetenca te plota ne kufijte e objektit te saje, me perjashtim te kompetencave qe ligji i'a ka caktuar shprehimishte asamblese se pergjithshme te aksionereve dhe te kompetencave te specifikuara te keshillit mbikqyres.

Cdo kufizim I kompetencave te drejtorit te pergjithshem me vendim te keshillit mbikqyres eshte pa efekt ndaj te treteve.

Drejtori I pergjithshem mund ti delegoj nje pjese te kompetencave te tij tek persona te tjere. Ne kete rast, ai mban pergjegjesi vete perpara shoqerise per demet qe mund t'i kete sjelle asaj nga veprimi I personit te cilit I jane deleguar kompetencat sipas parashikimeve te ketij paragrafi.

Shoqeria duhet te njoftoje Komisionin e Mbikqyrjes se sigurimeve per cdo ndryshim te titullarit, qe I perket funksionit te drejtorit te pergjithshem, anetarve te keshillit mbikqyres, apo drejtoreve teknike.

NENI 26

Zevendsimi I perkohshem I Drejtorit te Pergjithshem

Keshilli mbikqyres mund te ngarkoj nje anetar, qe te zevendsoje perkohsishte ne te gjitha funksionet Drejtorin e Pergjithshem, ne rastet kur ky I fundit:

1. per arsye semundje te zgjatur, ose nje ngjarje tjeter te papritur pengohet per te ushtruar funksionet e tij.

2. jep doreheqjen, ose vdes dhe nuk eshte e mundur te behet menjehere emerimi I drejtorit te ri.

NENI 27

Drejtoret teknike

Drejtoret teknik jane te punesuar te shoqerise, emerohen nga drejtori I pergjithshem, I cili percakton edhe funksionet e tyre, ne pajtim me rregulloren e brendshme te shoqerise te miratuar nga Keshilli Mbikqyres.

Drejtoret teknike nuk kane asnje kompetence per te angazhuar ndaj te treteve, pervec rastit kur drejtori I pergjithshem u ka deleguar atyre me mandat nje pjese te kompetencave te tij.

NENI 28

Kompetencat e Drejtorit te Pergjithshem

Drejtori I Pergjithshem ushtron te gjitha kompetencat qe nuk I ka asambleja e pergjithshme e aksionereve, si dhe keshilli I mbikqyrjes, si dhe eshte I vetemi person qe perfaqeson personalitetin juridik te shoqerise.

NENI 29

Detyrimi per te ruajtur sekretin

Anetaret e Keshillit te Mbikqyrjes, Drejtori I Pergjithshem, si dhe te gjithe personat e punesuar ne shoqeri dhe agjentet e saj, jane te detyruar te ruajne fshehtesine e cdo informacioni qe marrin gjate kryerjes se detyrave ne shoqeri dhe te mos e perdorin ate per perfitime personale, apo per te tretet, si gjate kohes qe jane ne funksion, ashtu edhe pas largimit te tyre.

Keshilli Mbikqyres percakton rregulla e procedura me te hollsishme lidhur me ruajtjen e sekretit nga ana e personave te permendur me siper, si dhe per komunikimin e informacioneve autoriteteve, apo organeve te cileve kjo e drejte u eshte njohur me ligj.

SEKSIONI I III
Kontrolli I pavarur
Eksperti kontabel I autorizuar

NENI 30
Emerimi dhe Shperblimi

Asambleja e pergjithshme e aksionereve cakton nje kontrollor te pavarur dhe nje ndihmes te tij, te zgjedhur te dy nga lista e Institutit te eksperteve Kontabel te Autorizuar .Ne caktimin e kontrolloreve te pa varur,mbahen parasyshe perjashtimet dhe papajtueshmerite e percaktuara nga ligji "Per Shoqerite Tregtare".
Kontrolloret e pavarur caktohen per nje kohe qe I pergjigjet nje ushtrimi financiar.Shperblimi I kontrolloreve te pavarur caktohet nga asambleja e aksionereve dhe perballohet nga shoqeria.
Kontrollor I pavarur emrohet zoti Perparim Como.

NENI 31
Detyrat dhe te drejtat

Detyrat dhe te drejtat e kontrolloreve te pavarur te shoqerise, jane ato te parashikuara nga ligji "Per shoqerite tregtare" dhe nga aktet e tjera ne fuqi qe rregullojne kete profesion. Asambleja e aksionereve, mund tú kerkoje kontrolloreve te pavarur kryerjen e kontrolleve, apo verifikimeve te posacme per ceshtje ne interes te shoqerise.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE

NENI 32
Natyra e asambleve dhe karakteri detyrues I vendimeve.

Asamblete e pergjithshme te aksionereve cilesohen asamble te zakonshme, ose te jashtezakonshme, sipas natyres se vendimeve qe ato jane thirrur per te marre.

Cdo asamble e pergjithshme e mbledhur rregullisht perfaqeson tersine e aksionereve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se pergjithshme detyrojne te gjithe aksioneret, madje edhe ata qe mungojne ne mbledhje apo votojne kunder.

NENI 33
Thirrja dhe vendi I asamblese.

Asamblete e pergjithshme thirren nga Keshilli Mbikqyres. Ato mund te thirren gjithashtu nga kontrollori I pavarur ne rast urgjence, nga nje mandatmbajtes I caktuar nga gjykata dhe kur eshte rasti nga likujduesi.

Asamblete e pergjithshme mblidhen ne selin e shoqerise, ose ne cdo vend tjeter te treguar ne thirrje.

Thirrja e asamblese se aksionereve, behet me ane te njoftimit qe I dergohet cdo aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.

Njoftimi duhet te bjere ne doren e aksionereve, apo te njihet prej tyre te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asambese dhe duhet te permbaje diten,oren dhe vendin e mbledhjes, natyren e asamblese dhe rendin e dites.

Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur te marre vendim per shkak se nuk eshte siguruar quorumi I kerkuar, mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e thirrjes se pare ne te njejtat forma si e para. Njoftimi, ose letrat e thirrjes se mbledhjes se dyte rikujtojne daten dhe rendin e dites.

NENI 34
Rendi I dites

Rendi I dites se mbledhjes se asamblese percaktohet nga autori I thirrjes.

Nje, ose disa aksionere qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit themeltare te shoqerise, kane te drejte te kerkojne qe te huten ne rendin e dites nje apo disa projekt rezoluta. Keta projkt rezoluta dergohen ne seline e shoqerise, te shoqeruara me nje kerkese ne te cilen tregohen edhe arsyet, si dhe me nje dokument qe provon zoterimin e pjeses se kapitalit themeltar te kerkuar nga paragrafi I dyte I ketij neni.

Projekt rezoluta dhe dokumentat shoqeruese duhet te mberrijne ne seline e shoqerise, te pakten pese dite perpara dates se mbledhjes se asamblese.

Asambleja e aksionereve nuk mund te marre ne shqyrtim nje ceshjte qe nuk eshte perfshire ne rendin e dites. Megjithate, ajo mundet ne cdo rrethane te shkarkoje nje, ose disa anetare te keshillit mbikqyres, drejtorin e pergjithshem dhe te beje zevendsimin e tyre.

Rendi I dites se mbledhjes se asamblese nuk mund te ndryshohet me nje njoftim te dyte.

NENI 35
Hyrja ne asamble

Cdo aksioner pavarsishte nga numri I aksioneve qe zoteron, ka te drejte te asistoje ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme dhe te marre pjese ne vendimet e saj, personalishte apo nepermjet nje perfaqsuesi. Hyrja ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme behet ne baze te nje dokumenti qe provon identitetin e aksionerit, si dhe regjistrimit te tij ne regjistrin e aksioneve te shoqerise.

Cdo aksioner mund te perfaqesohet ne mbledhjet e asamblese, vetem nga bashkeshorti, ose nga nje aksioner tjeter. Per kete qellim, perfaqsuesi duhet te paiset nga aksioneri me nje mandat te posacem, ne kushtet e parashikuara nga ligji.

NENI 36
Evidenca e pjesmarrjes, drejtimi I mbledhjes dhe procesverbalet.

Per cdo mbledhje te asamblese, mbahet nje flete prani, e cila permban treguesit qe provojne identitetin e aksionerit dhe aksionet e zoteruara prej tij. Flete prania firmoset ne ane nga aksioneri, ose kur eshte rasti nga perfaqsuesi I tij dhe vertetohet per saktesine e saj nga komisioni vezhgues I mbledhjes.

Mbledhjet e asamblese drejtohen nga kryetari I saj, I cili eshte I zgjedhshem ne cdo mbledhje nga vete aksioneret me perqindjen e thjeshte te votave te aksionereve pjesmarres ne mbledhje.

Ne rastet kur thirrja e mbledhjes eshte bere nga kontrollori I pavarur, mandatmbajtesi I caktuar nga gjykata, apo likujduesi, mbledhja drejtohet nga autori I thirrjes.

Per cdo mbledhje te asamblese hartohet nje procesverbal I cili permban :

- daten dhe vendin e mbledhjes.
- menyren e thirrjes.
- rendin e dites.
- drejtuesi I mbledhjes dhe komisioni I vezhgimit.
- numeri I aksioneve qe marrin pjese ne votim.
- quorumi I arritur.
- permendjen e dokumentave dhe te raporteve qe jane shtruar ne mbledhje.
- nje permbledhje te debateve.

- tekstet e projktrezolutave te vena ne votim, ato te miratuara dhe ato te hedhura poshte nga aksioneret.

- rezultatet e votimeve.

Procesverbalet e mbledhjes se asamblese hartohen ne nje rregjister te posacem, I numeruar dhe I vulosur, I cili ruhet ne selin e shoqerise.

NENI 37

Quorumi, votimi, numeri I votave.

Ne asamblete e pergjithshme, te zakonshme dhe te jashtezakonshme, quorumi llogaritet per tersine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltare te shoqerise.

E drejta e votes qe u perket aksioneve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne.

Cdo aksion I kapitalit I jep zoteruesit te pakten te drejten e nje vote. Megjithate, kur aksionet e shoqerise zoterohen nga nje , ose disa persona juridikne te cilet shoqeria ka drejtperdrejte ose terthorazi kontrollin, e drejta e votes se aksioneve te personave juridik, nuk mund te jete me shume se 10 % te votave qe zoterojne aksioneret e pranishem, ose te perfaqsuar.

Votimi kryhet me doren ngritur, me thirrje emerore, ose te fshehte sipas vendimit te komisionit te vezhgimit dhe drejtuesit te mbledhjes se asamblese. Votimi kryhet I vecante per cdo ceshtje apo vendim.

NENI 38

Asamblete e pergjithshme te zakonshme

Asambleja e pergjithshme e zakonshme, mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muajve te vitit pasardhes, per te vendosur mbi llogarite e shoqerise per ushtrimin financiare te mbyllur.

Ajo ka midis te tjerash kompetencat qe vijojne:

- te miratoje strategjine e zhvillimit afatgjate te shoqerise.
- te miratoje plan biznesin dhe planin financiar vjetor.
- Te miratoje, ndryshoje, ose te hedhe poshte llogarite vjetore qe I jane shtruar per miratim.
- Te vendos per shperndarjen dhe destinimin e rezultatit ne pajtim me dispozitat ligjore dhe me statutin.
- Te emeroje dhe te shkarkoje anetaret e keshillit mbikqyres.
- Te emeroje kontrollorin, ose kontrolloret e pavarur te llogarive (ekspertet kontabel te autorizuar).

- Te miratoje, ose te mos miratoje emerimet e anetarve te keshillit mbikqyres te kryera nga vete keshilli si emerime te perkohshme.

- Te miratoje pagen e drejtorit te pergjithshem dhe raportet e pagave per kategorite e tjera te personelit te shoqerise, si dhe shperblimet sublementare qe mund te jepen per pune, ose rezultate te mira.

- Te caktoje shperblimin e vecante per shperblime te tjera te parashikuara ne kete statut per keshillin mbikqyres.

- Te vendose per raportin e kontrollorit te pavarur, lidhur me marrveshjet qe I nenshtrohen autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Asambleja e zakonshme merr cdo vendim qe nuk sjell ndryshime te statutit. Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare, vetem kur aksioneret e pranishem, ose te perfaqsuar zoterojne jo me pak se 50 % te aksioneve me te drejte vote. Ne raste se mbledhja e pare nuk realizohet, per mbledhjen e dyte nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim, me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem, apo te perfaqesuar.

NENI 39

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mblidhet sa here qe duhet te merret nje vendim qe sjell ndryshime te ketij statuti, por ne cdo raste duhet marre miratimin e Komisionit te Mbikqyrjes se Sigurimeve perpara se ti shtroje ne asamblene e pergjithshme ndryshimet e statutit.

Ajo nuk mund te shtoje detyrimet e aksionereve, pervec operacioneve qe rrjedhin nga rigrupimi I aksioneve I kryer rregullisht.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme, mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare, vetem kur aksioneret e pranishem, apo te perfaqsuar zoterojne te pakten 3/4 e aksioneve me te drejte vote. Per mbledhjen e dyte ky quorum, eshte jo me pak se 1/2 e aksioneve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se jashtezakonshme merren me shumicen prej 3/4 te votave qe u perkasin aksionereve te pranishem, apo te perfaqesuar.

NENI 40

Venja ne dispozicion te aksionereve te dokumentave dhe informacioneve.

Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentat dhe llogarite vjetore qe shqyrton asambleja. Me perjashtim te inventareve dhe te ndonje

dokumenti tjeter te caktuar nga asambleja, dokumentet qe duhet tu vihen ne dispozicion aksionereve, u dergohen ketyre bashke me njoftim thirrjen per mbledhje.

KONTABILITETI; GJENDJET FINANCIARE; CAKTIMI I REZULTATIT

NENI 41
Kontabiliteti, inventari,gjendjet financiare.

Shoqeria mban kontabilitetin e saj ne perputhje me kerkesat e ligjit "Per kontabilitetin" dhe me rregullat kontabel specifike te hartuara nga Komisioni I Mbikqyrjes se Sigurimeve.

Ajo kryhen nje here ne 12 muaj inventarizimin e aktiveve dhe te paisjeve te saje, perpara se te pregatit gjendjet financiare vjetore.

Ne mbyllje te cdo viti financiar, por jo me vone se tre muaj nga data e mbylljes se vitit, shoqeria pregatit gjendjet financiare vjetore sipas rregullave te caktuara per kete qellim.

Viti financiar per te cilin pregatiten dhe publikohen gjendjet financiare te shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor.

NENI 42
Rezultati Financiar

Rezultati financiar I shoqerise percaktohet ne mbyllje te te cdo viti,si diference te ardhurave dhe shpenzimeve, pasi te zbriten ,gjithashtu amortizimet dhe shumat e provizioneve per zhvleresime dhe per rreziqe e shpenzime , si dhe shumat e rezervave teknike te krijuara ne perputhje me rregullat per shoqerite e sigurimeve.
Fitimi neto I shoqerise , percaktohet pasi te zbritet tatimi mbi fitimin I llogaritur ne menyre te perqendruar per shoqerine ne teresi.

NENI 43
Ndarja e fitimit neto

Fitimi neto I shoqerise caktohet per qellimet qe vijojne :
- Per rezervat e detyrueshme te tjera te kapitaleve te veta.
- Per devidente.

Asambleja e pergjithshme mund te vendose heqjen e nje pjese te fitimeve per krijimin e rezervave te lira per tu perdorur ne interes te zhvillimit te shoqerise.

Fitimet e shoqerise nuk mund te caktohen per shperblime, apo perfitime te tjera te personelit, per sponsorizime, apo dhurime dhe as per ndonje qellim qe ka natyre shpenzimi dhe hyn ne koston e aktivitetit te shoqerise.

Shoqeria eshte e detyruar te krijoje edhe rezervat e detyrueshme te sigurimeve ne perputhje me ligjin nr 8081 dt 7.3.1996 " Per veprimtarite e sigurimeve dhe risigurimeve", si dhe akteve te tjera te dala nga Komisioni I Mbikqyrjes se Sigurimeve.

NENI 44
Fitimi I shperndashem- Dividentet

Fitimi I shperndashem si divident, perbehet nga fitimi neto I vitit financiar I pakesuar me humbjet e mbartura dhe me shumat e hequra per rezervat ne zbatim te ligjit dhe statutit dhe I shtuar nga fitimet e mbartura.

Fitimi I shperndashem ndahet midis te gjithe aksionereve, ne perpjestim me numerin e aksioneve qe zoteron secili prej tyre.

Shoqeria nuk mund te shperndaje dividente, neqofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin, si rrjedhoj e shperndarjes, me te vogla nga shuma e kerkuar nga ligji.

NENI 45
Humbjet dhe mbartja e tyre

Pas miratimit te gjendjeve financiare vjetore nga asambleja e pergjithshme, humbja e rezultuar ne nje vit financiar, mbartet ne vitet pasuese per tu mbuluar nga fitimet e ardheshme deri ne shuerjen e humbjes.

DEGET E SHOQERISE

NENI 46
Statusi I Deges

Dega e shoqerise eshte njesia baze organizative e saj dhe varet nga Drejtoria e Pergjithshme.

Dega e shoqerise krijohet ne baze rrethi, ose rajoni dhe ka ne vartesi agjenci dhe zyra te shoqerise.

NENI 47
Drejtimi I Deges se shoqerise

Drejtimi dhe administrimi I deges ushtrohet nga drejtori I saj, I cili pergjigjet per gjith veprimtarin e Deges, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi qe veprojne ne fushen e sigurimeve, Udhezimet e Drejtorise se Pergjithshme dhe dispozitat e ketij statuti.

Drejtori I Deges ne perputhje me strukturen organizative dhe numerin e punonjeseve te miratuar, emeron e shkarkon punonjesit dhe percakton pagat e tyre mujore, ne perputhje me tabelen e pagave te miratuar nga Keshilli Mbikqyres.

NENI 48
Raportimet e Deges

Dega I dergon Drejtorise se pergjithshme, ne afatet e caktuara prej saj, bilancin me relacionin shoqerues dhe evidencat e tjera statistikore, si dhe cdo informacion tjeter qe I kerkohet.

KUJDESTARI DHE LIKUJDIMI

NENI 49
Dispozitat e zbatueshme

Per kujdestarine, si dhe per likujdimin e shoqerise ne raste prishje, ose falimentimi, zbatohen dispozitat e ligjit " Per veprimtarite e sigurimeve dhe te risigurimeve",ne ligjen "Per shoqerite tregtare" si dhe rregullat e percaktuara per kete qellim nga Komisioni I Mbikqyrjes se Sigurimeve, si dhe te akteve te tjera ligjore qe rregullojne keto gjendje.

AKSIONERET

1.Shyqyri Duraku
2.Llazar Angjeli
3.Avni Ponari
4.Alessandro Shtylla

REPUBLIKA E SHQIPERISE
N O T E R I A
Nr. 612 Rep.
Nr. 241 Kol.

V E R T E T I M

Sot ne daten 17.02.1999, para meje "noteres Myrvete Permeti, noterе ne Tirane, me Seli ne Rrugen e Durresit, u paraqiten personalisht ortaket e Shoqererise "SIGAL"SHA;Shyqyri Duraku, i biri i Alushit, lindur ne Kukes me 8 dhjetor 1954, banues ne Tirane, rruga Kavajes Nr.58, me numer pasaporte 06087763, Llazar Angjeli, i bir i Sotirit, lindur ne 5.02.1940, banues ne Tirane, rruga "Durresit"Pall.124/2-15, me numer pasaporte 09401407;Avni Ponari, i biri i Rexhepit, lindur ne Tropoje me 1957, banues ne Tirane, Rruga "Irfan Tomini"pall.C-4/7, me numer pasaporte 0000666 si dhe Alesandro Shtylla, i biri i Tahirit dhe i MNires, lindur ne Rome me 1940, perfaqesuar me prokure nga Besnik Shtylla, lindur ne 1952, banues ne Tirane, rruga "Bulvevardi Bajram Curri"pallatet Agimi Nr.1, Prokure me numer 2613 date 11.02.1999, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet neenshkruan kete Statut konform vullnetit te tyre. Me noteri pasi i gjeta konform ligjes e vertetova si me poshte.

N O T E R

PULLE TAKSE

NOTERE

BANKA e TIRANES

Banka e Tiranes SH.A.
Dëshmorët e Kombit 55/1
Tirane, Shqiperi
Tel.: (00355 42) 33 441 - 47
Fax: (00355 42) 33 417

VERTETIM

Vertetojme se per Shoqerine Sigurimeve "SIGAL" Sh.A. jane depozituar ne Nr.e llog.002203 shumat e meposhteme:

1-LEK- 9,000,000.00
2-USD-43,500 x 138 = 6,003,000.00 leke

Gjithsejt shuma 15,003,000.00 leke

Keto shuma jane derdhur si kapital themeltar I Shoqerise –" SIGAL" Sh.A.
Kursi llogarites i dites date 18.02.99 eshte USD=138LEK

Ky vertetim leshohet me kerkesen e Aksionereve te kesaj Shoqerie ,per t'u paraqitur ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe ne Komisionin e Mbikqyrjes se Sigurmeve.

Tirane me, 18/02/1999

BANKA e TIRANES SH.A.

Fatos Ahaj
Drejyues i Departamentit te Depozitave

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE SE SIGURIMEVE

" SIGURACIONI SHQIPETAR" sh.a.
(***"SIGAL"*** sh.a.)

Ne te nenshkruarit:

1. Shyqyri Duraku I biri I Alushit lindur ne Kukes me 8 Dhjetor 1954 dhe me banim ne Rruga e Kavajes Nr 58,Tirane me numer pasaporte 06087763.

2.Llazar Angjeli I biri I Sotirit ,lindur me 5.02.1940 dhe me banim ne, Rruga e Durresit Pallati 124/2-15 me Nr pasaporte 09401407.

3. Avni Ponari I biri I Rexhepit, lindur ne Tropoje me 28 Korrik 1957 dhe me banim ne Tirane, Rruga "Irfan Tomini" Pallati C-4/7 me numer pasaporte 0000666.

4 -Alessandro Shtylla I biri Tahirit dhe Mires,lindur ne Rome me 15.05.1940, banues ne Rruga Nr 42,00198, Rome-Itali, me Nr pasaporte 717451N. Te mbledhur sot me 10.1.1999, vendosem te themelojme shoqerin anonime sipas percaktimeve ne kete akt themelimi dhe statutit. Per kete arsye ne vendosem sa me poshte:

1.Te themelojme shoqerin anonime me emrin "SIGURACIONI SHQIPETAR" sh.a e cila do te kete dhe emrin e shkurtuar ***"SIGAL"*** sh.a.

2.Ne te gjtitha aktet qe do te nxjerre shoqeria kundrejte te treteve , si dhe ne te gjitha aktet e saje do te shenohet detyrimishte emri sh.a dhe shuma e kapitalit themeltare te saj.

3. Shoqeria do te kete si objekte te veprimtarise se saje sigurimin *nga demet si dhe risigurimet bazuar kjo ne ligjen 8081* "Per veprimtarit e sigurimit dhe te risigurimit" dhe ne legjislacionin ne fuqi mbi shoqerit tregtare dhe gjith dispozitat ligjore qe rregullojne aktivitetin sigurues dhe risigurues.

4. Shoqeria do te kete selin e saje ne qendren " Veve" bulevardi "Deshmoret e Kombit" Tirane, si dhe deget e saje ne rrethe, selia e shoqerise edhe munde te ndryshoj sipas nevojave te shoqerise dhe me pelqimin e ortakeve.

5. Kapitali themeltare I shoqerise do te jete 30.000.000 (tridhjete milion) leke. Ai eshte I ndare ne 30.000 (tridhjete mije) aksione nominative te themelueseve te shoqerise , te cilat jane te se njejtes kategori me vlere nominale prej 1.000 (njemije) lek per cdo aksion. Aksionet jane te numeruara nga nje deri ne 30.000 perfshire numerin e fundit te aksionit. Perberja e kapitalit themeltar te shoqerise eshte si me poshte:

Emri mbiemri	perqindja	nr I aksioneve	vlera ne leke
1- Shyqyri Duraku	26 %	78 00	7800000
2- Llazar Angjeli	26 %	7800	7800000
3- Avni Ponari	33%	9900	9900000
4- Alessandro Shtylla	15%	4500	4500000

6. Shoqeria do te kete dhe keto organe drejtuese:

- Keshilli Mbikqyres
- Drejtori I Pergjithshem

7- Kshilli Mbikqyres I shoqrise perbehet nga pese veta, te cilet jane caktuar si me poshte nga mbledhja themeluese e shoqerise:

1-Shyqyri Duraku	Kryetar
2- Llazar Angjeli	Antar
3- Besnik Mustafaj	Antar
4- Besnik Shtylla	Antar
5-Spartak Gjini	Antar

8- Ky keshill do te ushtroj veprimtarine e tij sipas afatit dhe percaktimeve te bera ne Statutin e shoqerise.

9- Drejtor I pergjithshem I Shoqerise I caktuar ne mbledhjen e pare themeluese te saj do te jete Avni Ponari.

10-Funksionet dhe kompetencat e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise do te percaktohen ne Statut.

11-Shoqeria autorizon Drejtorin e Pergjithshem qe te kryej te gjitha procedurat per regjistrimin ne Gjykate si dhe per te komunikuar me Komisjonin e Mbikqyrjes se Sigurimeve gjate fazes se licensimit.

12-Kapitali themeltar I aksioneve do te derdhet ne Tirana Bank dhe ngarkohet Drejtori I Pergjithshem te vertetoj derdhjet e kapitalit nga secili aksioner,si dhe tu jape veretetime secilit per shumat e derdhura. Kapitali themeltar ne momentin e nenshkrimit te akteve te themelimit te shoqerise eshte sa nje e dyta e tij dhe vertetohet se ai eshte derdhur rregullisht nga aksioneret sipas dokumentacionit bashkangjitur ketij akti themelimi.

13-Shoqeria do te ushtroje veprimtarine per nje afat kohor te pa caktuar.Ne raste se Komisioni I Mbikqyrjes se Sigurimeve refuzon dhenien e autorizimit zyrtar per te filluar aktivitetin, atehere njoftohen aksioneret nga Drejtori I Pergjithshem dhe kryhen veprimet perkatese per shperndarjen e shumave perkatese te derdhura nga aksioneret.

14- Dispozita te detajuara do te percaktohen ne Statutin e Shoqerise.

AKSIONERET

1- Shyqyri Duraku
2-Lazar Angjeli
3-Avni Ponari
4-Alessandro Shtylla

REPUBLIKA E SHQIPERISE
N O T E R I A
Nr.613 Rep.
Nr.242 Kol.

V E R T E T I M

Sot ne daten 17.02.1999,para meje noteres Myrvete Permeti, notere ne Tirane, me Seli ne Rrugen e Durresit, u paraqiten personalisht ortaket e Shoqerise "SIGAL"SHA;Shyqyri Duraku,i biri i Alushit,lindur ne Kukes me 8 dhjetor 1954, banues ne Tirane, rruga Kavajes Nr.58,me numer pasaporte 06087763,Llazar Angjeli, i bir i Sotirit, lindur ne 5.02.1940, banues ne Tirane, rruga "Durresit"Pall.124/2-15, me numer pasaporte 09401407;Avni Ponari, i biri i Rexhepit,lindur ne Tropoje me 1957, banues ne Tirane, Rruga "Irfan Tomini"pall.C-4/7, me numer pasaporte 0000666 si dhe Alesandro Shtylla, i biri i Tahirit dhe i MNires,lindur ne Rome me 1940, perfaqesuar me prokure nga Besnik Shtylla,lindur ne 1952,banues ne Tirane, rruga "Bulwevardi Bajram Curri"pallatet Agimi Nr.1,Prokure me numer 2613 date 11.02.1999,madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet neenshkruan kete Akt Themelimi konform vullnetit te tyre.Une noteri pasi i gjeta konform ligjes e vertetova si me poshte.

PULLE TAKSE
100 LEKE
RSHQIPERISE

N O T E R
MYRVETE PERMETI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 2863 vendimi

VENDIM
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, me date 22.02.1999 une gjyqtare e GJYKATES SE RRETHIT TIRANE, mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Avni Ponari , i cili kerkon te regjistroje si person juridik shoqerine SIGURACIONI SHQIPTAR (SIGAL) SHA dhe ;

KONSTATOVA;

Se kerkuesi kerkon te regjistroje si person juridik shoqerine anonime SIGURACIONI SHQIPTAR SHA, shkurt (SIGAL) sh.a , me objekt te aktivitetit te saj : Sigurimin ndaj demeve dhe risigurimeve kjo mbeshtetuir ne ligjen 8081, date 07.03.1996 "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit".

Kapitali i shoqerise do te jete 30.000.000 (tridhjetmilion) leke.

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, ne qendren "VEVE" bulevardi "Deshmoret e Kombit".

Kryetar i pare i Keshillit Mbikqyres eshte zoti Shyqyri Duraku.

Drejtor i pare i Pergjithshem eshte zoti Avni Ponari.

Me aksionere Shyqyri Duraku, Llazar Angjeli , Avni Ponari dhe Alessandro Shtylla.

Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE ;

Ne baze te liugjit 7638, 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", ligji 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin Tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te. si dhe ligjit 8081, date 07.03.1996 "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit".

VENDOSA;

Regjistrimin si person juridik te shoqerise anonime SIGURACIONI SHQIPTAR SHA, shkurt (SIGAL) sh.a, me objekt te aktivitetit te saj : Sigurimin ndaj demeve dhe risigurimeve kjo mbeshtetuir ne ligjen 8081, date 07.03.1996 "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit".

Kapitali i shoqerise do te jete 30.000.000 (tridhjetmilion) leke.

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, ne qendren "VEVE" bulevardi "Deshmoret e Kombit".

Kryetar i pare i Keshillit Mbikqyres eshte zoti Shyqyri Duraku.

Drejtor i pare i Pergjithshem eshte zoti Avni Ponari.

Me aksionere Shyqyri Duraku, Llazar Angjeli , Avni Ponari dhe Alessandro Shtylla.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

GJYQTARE

Pb 263/2

16.05.2001

g A Copo
11.05.2001

MAE 2001

K E R K E S E

Perpara: GJYKATES SE RRETHIT

(Seksionit tregtare)

T I R A N E

Z. Gjyqetare;

Duke qene me detyren e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise "Sigal" sh.a bazuar ne ligjin "Per shoqerite tregtare" me kete kerkese ju drejtohemi ju qe konforme procedures ligjore te miratoni vendimet e mesiperme te marra nga aksioneret e shoqerise sone, pra vendimet date 18.4.1999 dhe 20.12.2000 qe kane te bejne me ndryshimet perkatese ne statutin e shoqerise "Sigal" sh.a

Bashkengjitur me kerkesen jane dhe vendimet e asamblese se aksionerve dhe dokumentat e tjera te nevojshme.

K E R K U E S I

Shoqeria " SIGAL" sh.a

Avni PONARI

Drejtor i Pergjithshem

V E N D I M
I Asamblese se pergjithshme te zakoneshme

Tirane sot me date 18.4.1999, ne seline e shoqerise "Sigal" sh.a u mblodhen aksioneret e kesaj shoqerie, perkatesishte Z. Llazar Angjeli, Z. Shyqyri Duraku, Z.Avni Ponari, te cilet ne perfundim te mbledhjes

V E R E J T E N

Se; gjate themelimit te shoqerise "Sigal" sh.a eshte marre vendimi qe eksperte kontabel i shoqerise "Sigal" sh.a te jete z. Perparim Como, por gjate procedurave te metejshme u konstatua se z.Perparim nuk ishte i licensuar nga Organi perkates ne profesionin e ekspertit kontabel te autorizuar, detyrim ligjore ky per kandidatin qe do te mbaje kete detyre ne shoqerin tone.Per kete detyre u propozua z. Jorgji Bollano si person i autorizuar nga Organet perkatese, ne keto kushte me voten e plote te te gjithe aksionereve te pranishem u

V E N D O S I

-Zevendesimi i z. Perparim Como me z. Jorgji Bollano ne detyren e ekspertit kontabel te autorizuar prane shoqerise "Sigal" sh.a.

-Te behen ndryshimet perkatese ne dokumentat e shoqerise.

Aksioneret e shoqerise "Sigal" sh.a

Shyqyri Duraku Llazar Angjeli Avni Ponari

REPUBLIKA E SHQIPERISE
FATMIR C. ZALOSHNJA
NOTER
TIRANE

V E N D I M

I asamblese se pergjithshme te jashtezakoneshme.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme e aksionereve te shoqerise "Sigal" sh.a e mbledhur sot me date 20.3.2000, prane selise se saje Pall i Diplomateve, Tirane, me pjesmarrjen e z Shyqyri Duraku, z. Llazar Angjeli dhe Avni Ponari.

VEREJTEN

Se, Z. Aleksandro Shtylla si aksioner i shoqerise "Sigal" sh.a me 15% te kuotave te kapitalit, meqense megjithe kohen e vene ne dispozicion nga aksioneret nuk ka bere derdhjet per nenshkrimin e kapitalit themeltare, si dhe duke u bazuar ne deklaratene tije noterjale date 129.2.2000, se ka hequr dore nga nenshkrimi i ketyre kuotave dhe se largohet nga qenja ortak i shoqerise . Duke pare gjithashtu se Z.Aleksando Shtylla nuk ka detyrime te tjera karshi shoqerise dhe te treteve qe lidhen me shoqerine. Ne mbeshtetje te ligjes " Per shoqerite tregtare" statutit te shoqerise dhe me pelqimin e te gjithe ortakeve 15 % i ketyre kuotave u nenshkrua si me poshte;
Z. Shyqyri Duraku 4% qe i perkete 1200 aksione, Llazar Angjeli 4 % qe i perkete 1200 aksione, Edvin Hoxhaj 7 % qe i perkete 2100 aksione.
Ne perfundim ,

V E N D O S E

- **Miratimi i dorheqjes se Z. Aleksando Shtylla si aksioner i shoqerise "Sigal" sh.a**
- **Ndryshimin e nenit 6 te statutit te shoqerise "Sigal" sh.a persa u perkete zoterimit te kuotave te kapitalit themeltare nga aksioneret duke qene si me poshte.**

Z. Shyqyri Duraku 30 % = 9000 numeri i aksioneve.
Z. Llazar Angjeli 30 % = 9000 numeri i aksioneve.
Z. Avni Ponari 33% = 9900 numeri i aksioneve.
Z. Edvin Hoxhaj 7% = 2100 numeri i aksioneve.

Ngarkohet Drejtori i Pergjithshem z.Avni Ponari per te bere legalizimet e nevojshme prane Rregjistrit tregtare Tirane.
Per asamblene e pergjithshme te jashtezakonshme te shoq "Sigal" sh.a

Shyqyri Duraku **Llazar Angjeli** **Avni Ponari** **Edvin Hoxhaj**

Edvin Hoxhaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. rep 764
Nr. kol 168

DEKLARATË NOTERIALE

Sot, më datë 18.02. 2000 (dymijë), ditë e Enjtë, në Dhomën e Noterisë Tiranë, përpara meje Noterit Publik A. Robo me adresë Rr. J. Bendi, 2711, u paraqit:

Alessandro SHTYLLA, i biri i Tahirit, lindur më 1940 në Romë, Itali dhe banues po aty, në adresën: rruga nr. 42 00198, Romë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identiteti i të cilit m'u bë i njohur në bazë të pasaportës së tij personale me nr. 06087763, i cili deklaroi se:

Në themelimin e shoqërisë "Siguracioni Shqiptar" SIGAL sh.a., të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë si person juridik me Vendimin nr. 20863, datë 22.02.1999, kam marrë pjesë me cilësinë e aksionerit duke patur 15% të kapitalit që i përkisnin 4 500 aksione nominative, që i vlerësuar në lekë kap vlerën 4 500 000 lekë (kjo e pasqyruar në Nenin 6 të Statutit të Shoqërisë).
Kjo pjesë e aksioneve, megjithëse e nënshkruar, nuk është shlyer nga ana ime. Bazuar në nenin 11 – 13 të Statutit të Shoqërisë dhe neneve 198 dhe 203 të Ligji nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", deklaroj se heq dorë nga e drejta e pronësisë mbi këto aksione si edhe cdo e drejtë dhe detyrim që kam pasur në këtë shoqëri.

Kështu këto aksione i kthehen shoqërisë dhe unë si ish-aksioner ju jap të drejtë të plotë organeve drejtuese të Shoqërisë SIGAL sh.a. që të rregullojnë sipas dispozitave ligjore dhe parashikimeve në Statut ndryshimet e nevojshme juridike për mënyrën e shpërndarjes apo zotërimit të këtyre aksioneve nga vetë ortakët apo persona të tjerë.

Me këtë deklaratë unë personalisht jam i cliruar nga të gjithë tagret juridike që kam mbajtur në shoqërinë SIGAL sh.a.
Këtë deklaratë e lëshoj me vullnetin tim të lirë e të plotë dhe e nënshkruaj para noterit.
Sa më sipër u muar prej meje noterit kjo deklaratë, e cila ju lexua deklaruesit në prezencë të përkthyesit, u deklarua prej tij që kuptoi përmbajtjen dhe e nënshkroi atë para meje noterit.
Unë sipas nenit 39, germa "H" të Ligjit nr 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterin", e vërtetova atë rregullisht.

DEKLARUESI

Alessandro Shtylla

NOTERI PUBLIK

Agim Robo

NOTER AGIM ROBO Rr. I. Qemali P.27/1 TIRANE TEL. 43340

PULLE TAKSE

100 LEKE

Nj. B. Musa
dt. 20.06.2007

20863/14

20 QIU. 2007

KERKESE PER DEPOZITIMIN E AKTEVE TE SHOQERISE "SIGURACIONI SHQIPTAR - SIGAL SH.A.

Kerkues: **Z. Avni PONARI**, i biri i Rexhepit, lindur me 28.07.1957, ne Tropoje, Shqiperi, banues ne Tirane, Shqiperi ne adresen Rruga "Marsel Kashen", Pallatet e Aviacionit, mbajtes i Pasaportes Nr. Z1252170, ne cilesine e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise "SIGAL" SH.A.

Objekti: Depozitim ne Regjistrin Tregtar te akteve te Shoqerise SIGAL SH.A. per transferimin e aksioneve te shoqerise dhe ndryshimet perkatese ne Statut.

Baza ligjore: Ligji Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligji Nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

Gj. depozitohet kerkesa dhe aktet dt. 27.06.07

Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane
Seksioni i Regjistrit Tregtar

Shoqeria SIGAL SH.A, eshte shoqeri e te drejtes shqiptare e regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane me vendimin Nr. 20863, dt.22.02.1999

Me date 17.04.2007 eshte mbledhur Asambleja e Jashtezakonshme e Shoqerise e cila ka vendosur nder te tjera:

- Miratimin e transferimit nepermjet shitjes te gjithe aksioneve qe aksionaret kane ne shoqerine Sigal Sh.A. te Shoqeria Sigal Holding Sh.A.
- Miratimi i draft Kontrates se Transferimit te Aksioneve date 17/04/2007 per ndryshimin e struktures aksionere te shoqerise
- Ndryshimi i **Nenit 6 te Statutit** te shoqerise si pasoje e transferimit nepermjet shitjes se aksioneve.

Neni 6 i Statutit pas ndryshimeve behet:

"Kapitali themeltar i shoqerise eshte 400.000.000 Leke.
Ai eshte i ndare ne 121.212(njeqind e njezete e nje mije e dyqind e dymbedhjete) aksione nominative. Vlera e nje aksioni eshte 3.300Leke.
Perberja e kapitalit themeltar te shoqerise eshte si vijon:
Shoqeria SIGAL HOLDING Sh.a zoteron 121.212 aksione, me vlere 400.000.000 Leke ose 100% te kapitalit te shoqerise "SIGAL" Sh.A."

Per sa me siper, duke u mbeshtetur ne Nenin 33 te Ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtar", ne Ligjin

Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", sot me date 18.04.2007, une Drejtori i Pergjithshem i shoqerise "SIGAL HOLDING" SH.A, si dhe ne Vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te Shoqerise "SIGAL HOLDING" SH.A. date 17.04.2007, kerkoj:

1. Pranimin e kesaj Kerkese.
2. Depozitimin e Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise date 17.04.2007 e cila ka vendosur (i)pranimin e transferimit nepermjet shitjes te gjithe aksioneve te Aksionareve te shoqerise SIGAL SH.A. ne shoqerine SIGAL HOLDING SH.A.
3. Kontratat e Transferimit te Aksioneve date 17/04/2007 si dhe te pasqyroje (ii) ndryshimet qe pasojne ne Nenin 6 te Statutit te Shoqerise.

Bashkengjitur:

- Vendimi i Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise Sigal Sh.A date 17/04/2007
- Vendimi i Asamblese se Jashtezakonshme te Shoqerise Sigal Holding Sh.A date 17/04/2007
- Kontrata e Transferimit te Aksioneve date 17/04/2007 e nenshkruar ndermjet SIGAL - HOLDING sh.a. dhe aksionereve te SIGAL Sh.A.
- Vendim nr. 2 date 10.05.2007 i Autoritetit te Mbikeqyrjes Financiare per miratimin e transfermit te aksioneve te Shoqerise tek Sigal Holding Sh.A. dhe ndryshimin e nenit 6 te Statutit te Shoqerise Sigal Sh.A.

KERKUES

SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A.

Avni Ponari

Drejtori i Pergjithshem

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 4007 **Rep.**

VERTETIM NOTERIAL

Sot, me daten 19.06.2007 (dymijeeshtate), para meje Arjana Mallkuci notere ne qytetin e Tiranes me seli ne Rruga Vaso Pasha si me siper, u paraqiten personalisht:

Avni PONARI, i biri i Rexhepit, lindur me 28.07.1957 dhe banues ne Tirane, Rr. "Marsel Kashen", Pall.e Aviacionit, identifikuar nga Pasaporta Nr. Z1252170 madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili me deklaroi se ***Kerkesen e Shoqerise "SIGAL" SHA*** te bashkangjitur e ka hartuar dhe nenshkruar me vullnet te lire. Une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

Arjana Mallkuci

VENDIM I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË SIGURACIONI SHQIPTAR - SIGAL SH.A

Në Tiranë, sot më datë 17/04/2007, në selinë e shoqerisë ne adresen Bulevardi "Zogu I" Nr. 1 Tiranë, u mblodhen ne nje mbledhje te jashtezakonshme aksionarët e Shoqërisë SIGURACIONI SHQIPTAR – SIGAL SH.A., shoqëri anonime sigurimesh e së drejtës Shqiptare, e regjistruar si person juridik në bazë të Vendimit Nr. 20863, datë 22.02.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e pajisur me Autorizimin nr. 2, datë 23.06.1996 dhe Vendimin Nr. 6 date 03.02.2006 te lëshuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes se Sigurimeve.

Pjesemarres ne mbledhje ishin aksionaret e meposhtem:

- **Z. Avni PONARI zoterues i 55,078 te aksioneve te shoqerise ose 45,44% te kapitalit fillestar te shoqerise.**
- **Z.Llazar ANGJELI, zoterues i 32,000 te aksioneve te shoqerise ose 26,40 te kapitalit fillestar te shoqerise;**
- **Z. Shyqyri DURAKU, zoterues i 12,122 te aksioneve te shoqerise ose 10,40% te kapitalit fillestar te shoqerise;**
- **Z. Edvin HOXHAJ, zoterues i 7,467 te aksioneve te shoqerise ose 6,16% te kapitalit fillestar te shoqerise;**
- **Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve "AAEF" përfaqësuar nga Z. Jeffrey T. Griffin në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, zoterues i 21,600 te aksioneve te shoqerise ose 12% te kapitalit fillestar te shoqerise.**

te gjithe se bashku zoterues të 100% të aksioneve të shoqërise, te cilet duke formuar quorumin e nevojshëm, moren ne shqyrtim si me poshte:

PIKAT E RENDIT TE DITES

1. Miratimin e transferimit nepermjet shitjes te gjithe aksioneve qe akionaret kane ne Shoqërine SIGAL SH.A. tek shoqëria SIGAL HOLDING SH.A. nje shoqëri anonime e regjistruar si person juridik në bazë të Vendimit Nr. 37818, datë 21.03.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me seli në adresen Bulevardi "Zogu I", Pallati i Diplomateve, nr. 57, Tiranë, Shqipëri.
2. Miratimin e draft Kontrates se Transferimit te Aksioneve qe do te lidhet ndermjet Aksionareve te Shoqerise dhe shoqerise Sigal Holding Sh.A..
3. Ndryshimi i Statutit te Shoqerise, perkatesisht Nenit 6 per te pasqyruar ndryshimin e skemes aksionare te Shoqerise si pasoje e transferimit te aksioneve nga pese aksionaret aktuale ne aksionarin e vetem SIGAL Holding Sh.A.. i cili behet zoterues 100% i kapitalit te Shoqerise SIGAL SH.A. Neni 6 i Statutit pas ndryshimeve eshte si me poshte:

   "Kapitali themeltar i shoqerise eshte 400.000.000leke.
   Ai eshte i ndare ne 121.212(njeqind e njezete e nje mije e dyqind e dymbedhjete) aksione nominative. Vlera e nje aksioni eshte 3.300Leke.
   Perberja e kapitalit themeltar te shoqerise eshte si vijon:
   Shoqeria SIGAL HOLDING Sh.a zoteron 121.212 aksione, me vlere 400.000.000leke ose 100% te kapitalit te shoqerise "SIGAL" Sh.A."

4. Të ndryshme.

Pasi u diskutuan plotësisht të gjitha pikat e rendit të ditës, aksionarët e Shoqërisë SIGAL [redacted] SH.A.,

VENDOSËN UNANIMISHT:

1. Miratimin e transferimit nepermjet shitjes te gjithe aksioneve qe akionaret kane ne Shoqërine SIGAL SH.A. tek shoqëria SIGAL Holding SH.A. nje shoqëri anonime e regjistruar si person juridik në bazë të Vendimit Nr. 37818, datë 21.03.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me seli në adresen Bulevardi "Zog I", Pallati i Diplomateve, nr. 57, Tiranë, Shqipëri.
2. Miratimin e draft Kontrates se Transferimit te Aksioneve qe do te lidhet ndermjet Aksionareve te Shoqerise dhe shoqerise Sigal Holding Sh.A..
3. Ndryshimi i Statutit te Shoqerise, perkatesisht Neni 6 i saj per te pasqyruar ndryshimin e skemes aksionare te Shoqerise si pasoje e transferimit te aksioneve nga pese aksionaret aktuale ne aksionarin e vetem SIGAL Holding Sh.A.. i cili behet zoterues 100% i kapitalit te Shoqerise SIGAL SH.A
   Neni 6 i Statutit pas ndryshimeve eshte si me poshte:

   "Kapitali themeltar i shoqerise eshte 400.000.000leke.
   Ai eshte i ndare ne 121.212(njeqind e njezete e nje mije e dyqind e dymbedhjete) aksione nominative. Vlera e nje aksioni eshte 3.300Leke.
   Perberja e kapitalit themeltar te shoqerise eshte si vijon:
   Shoqeria SIGAL HOLDING Sh.a zoteron 121.212 aksione, me vlere 400.000.000leke ose 100% te kapitalit te shoqerise "SIGAL" Sh.A."

4. Ngarkohet Drejtori i Pergjithshem i Shoqerise Z. Avni PONARI të ndjekë procedurat e nevojshme të parashikuara nga legjislacioni shqiptar për regjistrimin e ketij Vendimi Asambleje ne lidhje me transferimin e aksioneve te Shoqerise SIGAL SH.A. te shoqeria Sigal Holding Sh.A. si dhe ndryshimin e Statutit te Shoqërisë në Regjistrin Tregtar te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

AKSIONARET
SIGURACIONI SHQIPTAR – SIGAL SH.A.

Avni PONARI

Llazar ANGJELI

Shyqyri DURAKU

Edvin HOXHAJ

Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndërmarrjeve

Jeffrey T. Griffin

FONDI SHQIPTARO AMERIKAN I NDERMARJEVE TIRANE ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 1682 REP.
NR. 1317 KOL.

VËRTETIM

Sot më datë 17.04.2007 para meje Robert KOLI, noter i Dhomës së Notereve Tiranë, me seli ne Rr. Urani Pano, pall. 11katesh, u paraqitën personalisht:

1. **Shyqyri DURAKU**, shtetas shqiptar, lindur më 8 Dhjetor 1954, në Kukës, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr.D0000994, lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme.
2. **Llazar ANGJELI**, shtetas shqiptar, lindur më 5 Shkurt 1940, në Sarandë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr. Z0085140, lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme më datë 12 Qershor 2002, e vlefshme deri më datë 11 Qershor 2012.
3. **Avni PONARI**, shtetas shqiptar, lindur më 28 Korrik 1957, në Tropojë, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr. Z1252170, lëshuar nga Ministria e Rendit Publik, më datë 8 Nëntor 2004, e vlefshme deri më datë 7 Nëntor 2014.
4. **Edvin HOXHAJ**, shtetas shqiptar, lindur më 30 Prill 1966, në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr. Z1383889, lëshuar nga Ministria e Rendit Publik, më datë 12 Mars 2005, e vlefshme deri më datë 11 Mars 2015.
5. **Jeffrey T. GRIFFIN**, shtetas amerikan, lindur më Georgia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 14 Qershor 1944, rezident në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Amerikane Nr. 10333338, lëshuar më 12 Korrik 2003, e vlefshme deri më 17 Korrik 2013, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm te Fondit Shqiptaro Amerikan te Ndermarrjeve, Aksioner i SIGAL sh.a;

të cilët në cilësinë e Aksionarëve të shoqërisë SIGAL SH.A më paraqitën këtë Vendim Asambleje të përpiluar me vullnetin e tyre të lirë dhe pasi e nënshkruan atë rregullisht para meje ne prani te perkthyeses se gjuhes angleze Sofika Rapi, unë noteri e vërtetoj nënshkrimin e tye sipas ligjit.

NOTER
Robert KOLI

Deklhen: Sofika Rapi

VENDIM I KESHILLIT MBIKQYRES

DATE 17 / 04 / 2007

TE SHOQERISE SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A.

Keshilli Mbikqyres i Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A. (SIGAL SH.A.), u thirr nga Kryetari Shyqyri Duraku, ne seline e Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A., ne adresen "Qendra VEVE", Tirane, per te marre ne shqyrtim çeshtjet me rendin e dites si me poshte:

- Miratimin e transferimit te pronesise se aksioneve nga aksioneret e Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A. (SIGAL SH.A.) tek Shoqeria SIGAL HOLDING SH.A., ne perputhje me kerkesat e paragrafit te I te Nenit 11 te Statutit te Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A.

- Te tjera.

Meqenese ne mbledhje ishin te pranishem te gjithe antaret e Keshillit Mbikqyres, te cilet degjuan Kryetarin e Keshillit Mbikqyres dhe u njohen me Vendimin e Asamblese se Aksionereve te Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A., date 17 Prill 2007, ne unanimitet

V E N D O S E N:

1. Te miratojne transferimin e pronesise se aksioneve nepermjet shitjes nga aksioneret e Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A. tek Shoqeria SIGAL HOLDING SH.A. Kontrata e Shitjes te hartohet ne perputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara ne legjislacionin civil shqiptar.

2. Te autorizoje Drejtorin e Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SH.A., Z. Avni Ponari te ndjeke te gjitha procedurat ligjore ne vijim te realizimit te transferimit te aksioneve perpara institucioneve publike dhe gjykates.

3. Ky Vendim hyn ne fuqi menjehere.

ANETARE

LLAZAR ANGJELI

SPARTAK GJINI

HAKI SHEHU

EDVIN HOXHAJ

FONDI SHQIPTAR AMERIKAN I NDERMARRJEVE
PERFAQESUAR NGA JEFFREY T. GRIFFIN

F O N D I
SHQIPTARO AMERIKAN
I NDERMARJEVE
TIRANE ALBANIA

KRYETARI

SHYQYRI DURAKU

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Noter:Robert Koli
Studio:Rr.Urani Pano,Pallati 11.Katesh
Nr. 8866 Rep.
Nr. 2045 Kol.

TULLE TAKSE 100 LEKE SHQIPERISE

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, me daten 26 / 06 /2007 (dymijeeshtate), diten e Marte para meje Robert KOLI, noter ne qytetin e Tiranes, me Seli si me siper, u paraqit personalisht:

Shyqyri DURAKU, i biri i Alushit, lindur me 08.10.1954 dhe banues ne Tirane, Rr. "Kavajes", Nr.58, identifikuar nga Pasaporta Nr.06087763, me cilesine e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres se Shoqerise "SICURACIONI SHQIPTAR" sh.a.
Edvin HOXHAJ, i biri i Skenderit, lindur me 30.04.1966 dhe banues ne Tirane, Rr. "Irfan Tomini", identifikuar nga Pasaporta Nr. 1247470
Llazar ANGJELI, i biri i Sotirit, lindur me 05.02.1940 dhe banues ne Tirane, Rr. "Durresit", Pall.124/2-15, identifikuar nga Pasaporta Nr.09401407, **Spartak GJINI dhe Haki SHEHU,** te njohur personalisht prej meje, si dhe
Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve, me seli ne SHBA, me zyre perfaqesimi ne Green Tower Complex, Kulla 2, Kati 12, Tirane, Shqiperi, perfaqesuar nga Z. ***Jeffrey T. GRIFFIN***, me cilesine e Presidentit dhe te Drejtorit Ekzekutiv (CEO) i AAEF, shtetas amerikan, lindur me 14.06.1944 dhe banues ne Tirane. me pasaporte Nr. Z. 8236285.
te gjithe madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet ne pranine e perkthyesit te gjuhes Angleze Znj. Zamira ZENELI me deklaruan se ***Vendimin I Keshillit Mbikqyres te shoqerise "SIGURAZIONI SHQIPTAR" sh.a. date 17.04.2007*** te bashkangjitur e kane hartuar dhe nenshkruar me vullnet te lire.
Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

PERKTHYES
Zamira ZENELI

NOTER
Robert KOLI

VENDIM I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË SIGAL HOLDING SH.A.

Në Tiranë, sot më datë 17/04/2007, në selinë e shoqerisë "SIGAL HOLDING" SH.A., nje shoqëri anonime e regjistruar si person juridik në bazë të Vendimit Nr. 37818, datë 21.03.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me seli në adresen Bulevardi "Zogu I", Pallati i Diplomateve, nr. 57, Tiranë, Shqipëri me kerkese te Drejtorit te Shoqerise Z. Avni Ponari, u thirr Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionarëve te Shoqërisë.

Pjesemarres ne mbledhje ishin aksionaret e meposhtem:

- **Avni PONARI qe zoteron 45.01% te kapitalit te shoqerise SIGAL HOLDING SH.A. ose 9,002.00 aksione me vlere 900,200.00 Leke.**
- **Llazar ANGJELI qe zoteron 26.01% te kapitalit te shoqerise SIGAL HOLDING SH.A ose 5,202.00 aksione me vlere 520,200.00 Leke.**
- **Shyqyri DURAKU qe zoteron 9.61% te kapitalit te shoqerise SIGAL HOLDING SH.A ose 1,922.00 aksione me vlere 192,200.00 Leke**
- **Edvin HOXHAJ qe zoteron 6.07% te kapitalit te shoqerise SIGAL HOLDING SH.A ose 1,214.00 aksione me vlere 121,400.00 Leke.**
- **Fondi –Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve qe zoteron 13.30 % te kapitalit te shoqerise SIGAL HOLDING SH.A ose 2,660.00 aksione me vlere 266,000.00 Leke.**

te gjithe se bashku zoterues të 100% të aksioneve të shoqërise, te cilet duke formuar quorumin e nevojshëm, moren ne shqyrtim si me poshte:

RENDI I DITES

1. Miratimi i Kontrates te Shitjes se Aksioneve, qe do te lidhet midis aksionereve te Shoqerise SIGAL LIFE Sh.A. dhe Shoqerise SIGAL HOLDING SH.A., ne perputhje me Nenit 6 te Statutit te SIGAL HOLDING SH.A.;
2. Miratimi i Kontrates te Shitjes se Aksioneve, qe do te lidhet midis aksionereve te Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR Sh.A. dhe Shoqerise SIGAL

HOLDING SH.A., ne perputhje me Nenin 6 te Statutit te SIGAL HOLDING SH.A.;

3. Te ndryshme.

Pasi u diskutuan plotësisht të gjitha pikat e rendit të ditës, aksionarët e pranishem te Shoqërisë SIGAL LIFE SH.A. unanimisht,

V E N D O S EN:

1. Miratimin e Kontrates te Shitjes se Aksioneve, qe do te lidhet midis aksionereve te Shoqerise SIGAL LIFE Sh.A. dhe Shoqerise SIGAL HOLDING SH.A., ne perputhje me Nenin 6 te Statutit te SIGAL HOLDING SH.A.;

2. Miratimin e Kontrates te Shitjes se Aksioneve, qe do te lidhet midis aksionereve te Shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR Sh.A. dhe Shoqerise SIGAL HOLDING SH.A., ne perputhje me Neninkr 6 te Statutit te SIGAL HOLDING SH.A.;

3. Te autorizoje Drejtorin e Shoqerise SIGAL HOLDING SH.A., Z. Avni Ponari te nenshkruaje ne emer dhe per llogari te Shoqerise SIGAL HOLDING SH.A. dy kontratat e siperpermendura, si dhe te kryeje depozitimin e ketij Vendimi te Asamblese se Aksionereve dhe dy kontratave te shitjes se aksioneve ne Zyren e Rregjistrit Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

SIGAL HOLDING SH. A.

Avni PONARI

Llazar ANGJELI

Edvin HOXHAJ

Shyqyri DURAKU

Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndërmarrjeve

Jeffrey T. Griffin

F O N D I
SHQIPTARO AMERIKAN
I NDERMARJEVE
TIRANE ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 5681 REP.
NR. 1316 KOL.

PULLE TAKSE

VËRTETIM

Sot më datë 17.05.2007 para meje Robert KOLI, noter i Dhomës së Notereve Tiranë, me seli ne Rr. Urani Pano, pall. 11 - katesh, u paraqitën personalisht:

1. **Shyqyri DURAKU**, shtetas shqiptar, lindur më 8 Dhjetor 1954, në Kukës, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr.D0000994, lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme.
2. **Llazar ANGJELI**, shtetas shqiptar, lindur më 5 Shkurt 1940, në Sarandë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr. Z0085140, lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme më datë 12 Qershor 2002, e vlefshme deri më datë 11 Qershor 2012.
3. **Avni PONARI**, shtetas shqiptar, lindur më 28 Korrik 1957, në Tropojë, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr. Z1252170, lëshuar nga Ministria e Rendit Publik, më datë 8 Nëntor 2004, e vlefshme deri më datë 7 Nëntor 2014.
4. **Edvin HOXHAJ**, shtetas shqiptar, lindur më 30 Prill 1966, në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr. Z1383889, lëshuar nga Ministria e Rendit Publik, më datë 12 Mars 2005, e vlefshme deri më datë 11 Mars 2015.
5. **Jeffrey T. GRIFFIN**, shtetas amerikan, lindur më Georgia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 14 Qershor 1944, rezident në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Amerikane Nr. 10333338, lëshuar më 12 Korrik 2003, e vlefshme deri më 17 Korrik 2013, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm te Fondit Shqiptaro Amerikan te Ndermarrjeve, Aksioner i SIGAL HOLDING SH.A.;

të cilët në cilësinë e Aksionarëve të shoqërisë SIGAL HOLDING SH.A dhe ne prani te Perkthyesit te gjuhes angleze Zamira Zenelaj, më paraqitën këtë Vendim Asambleje të përpiluar me vullnetin e tyre të lirë dhe pasi e gjeten ate ne perputhje me deklarimet e tyre e nënshkruan atë rregullisht para meje, unë noteri e vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

PERKTHYES

Zamira ZENELAJ

Zamira Zenelaj

NOTER

Robert KOLI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
ZYRA E REGJISTRIT TREGTAR

Tirane, me 26.06.2007

VERTETIM

"SIGAL HOLDING" SH.A

Me vendimin Nr.37818 date 21.03.2007 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria "SIGAL HOLDING" sh.a; me seli ne Tirane, Bulevardi Zogu I, pallati diplomateve, nr. 57; me kapital themeltar 2.000.000 leke; me afat mbi 10 vjet; me ortak themelues z.Shyqyri Duraku, Llazar Angjeli, Avni Ponari, Edvin Hoxhaj, shoqeria "Albanian – American Enterprise Fund" "AAEF"; me drejtor te pergjitheshem z.Avni Ponari;me Keshill Mbikqyres te perbere: z. Jeffrey T. Griffing, Edvin Hoxhaj, Llazar Angjeli; me objekt veprimtarie ne fushen e mbajtjes se biznesit, bashkerendimi dhe menaxhimi I te gjithe interesave te aksionerve te shoqerise ne shoqerite e meposhteme te sigurmit Sigal, ku aksionert kane paketa aksionare: Siguracioni Shqiptar – Sigal sh.a perfshire dhe Sigal sha. Drini ne Prishtine,Sigal – Life sh.a, Sigal A.D Shkuo. Shoqeria do te permbushe qellimin e saj duke perfruar politikat dhe marre vendime menaxheriale ne emer te shoqerise te Sigurimit Sigal ku do te kete pjesemarrje ne te ardhmen etj.

Ndryshime te metejshme nuk ka.

SEKRETARE E REGJISTRIT TREGTAR

Besa KORBECI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I MBIKEQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr.2 Datë 10.05.2007

PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË SHOQËRISË "SIGAL HOLDING SH.A" AKSIONER I VETËM I SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL SH.A", SI REZULTAT I TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "SIGAL SH.A."

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", dhe nenit 56 dhe 57 të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Departamentit te Liçensimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit te Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. **Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të shoqërisë "Sigal Holding sh.a" aksioner i vetëm i shoqërisë së sigurimit "Sigal sh.a.", si rezultat i transferimit të aksioneve.**
2. **Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të z.Avni Ponari si aksioner jo i drejtpërdrejtë por nëpërmjet shoqërisë "Sigal Holding sh.a", si rezultat i zotërimit të aksioneve nga 29% në 45%, në shoqërinë e sigurimit "Sigal sh.a".**
3. **Miratimin e ndryshimit të statutit të shoqërisë së sigurimit " Sigal sh.a.", si reflektim të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.**

4. **Ngarkohen shoqëria e sigurimit "Sigal sh.a." dhe Sektori i Licensimit në AMF, për zbatimin e këtij vendimi.**
5. **Ky vendim i bëhet i njohur drejtorisë së shoqërisë "Sigal sh.a".**

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit.

KRYETARI
Elisabeta GJONI

NËNKRYETARI
Ermela GUXHOLLI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI MBIKEQYRJES FINANCIARE
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. Rep. [...] 2478
Nr. Kol. [...] 1011

KONTRATE TRANSFERIMI AKSIONESH

Sot me date 25.04.2007, ne Tirane perpara meje Arjana Mallkuci, Notere e Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

Nga njera ane:

1. **Shyqyri DURAKU**, shtetas shqiptar, lindur më 8 Dhjetor 1954, në Kukës, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Shqiptare Nr.0012023, lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme më datë 27 Nëntor 2001, e vlefshme deri më datë 27 Nëntor 2006.
